

VËLLIMI XXXII /JANAR-MARS/ 2026

VENDIMET E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS 2026

BULETINI ZYRTAR



PËRMBAJTJA

Nr.1252, Datë 14.01.2026.....	7
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TË PLOTA, M-ONE ALBANIA SHPK, NGA SHOQËRITË BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK DHE MILŠPED DOO BEOGRAD”	
Nr.1253, Datë 14.01.2026.....	10
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË EUROPCAR MOBILITY GROUP S.A. NGA SHOQËRIA VOLKSWAGEN FINANCE LUKSEMBURG S.A., NËPËRMJET SHOQËRISË GREEN MOBILITY HOLDING S.A..”	
Nr.1254, Datë 14.01.2026.....	15
“PËR PËRJASHTIMIN NGA NDALIMI TË MARRËVESHJES SË LIDHUR NDËRMJET SHOQËRIVE PHILIP MORRIS PRODUCTS S.A DHE BRITISH AMERICAN TOBACCO EXPORTS LIMITED”	
Nr.1255, Datë 12.02.2026.....	20
“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E IMPORTIT, PËRPUNIMIT DHE TREGTIMIT TË KAFESË”	
Nr.1256, Datë 12.02.2026.....	23
“PËR RRËZIMIN E KËRKESËS SË NDËRMARRJES NEDRETE ARAPI PF PËR RISHQYRTIMIN E VKK NR. 1237, DATË 26.11.2025, “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E GRUMBULLIMIT DHE SHITJES ME SHUMICË TË FRUTA-PERIMEVE NË QARKUN TIRANË, ELBASAN, BERAT, FIER, KORÇË DHE GJOBITJEN E NDËRMARRJES NEDRETE ARAPI PF PËR SHKELJE TË KONKURRENCËS”	
Nr.1257, Datë 12.02.2026.....	26
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË DISA ASETJEVE QË LIDHEN ME BIZNESIN DOCKERS EU NGA SHOQËRIA ORBICO SPORTSTYLE S.R.L.”	
Nr.1258, Datë 12.02.2026.....	29
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË FACEKOM KORLÁTOLT FELELŐSSÉGŰ TÁRSASÁG NGA SHOQËRIA 4IG INFORMATIKAI ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ	

RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”

Nr.1259, Datë 12.02.2026.....33

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË MOBIL ADAT TÁVKÖZLÉSI ÉS INFORMATIKAI SZOLGÁLTATÓ KORLÁTOLT FELELŐSSÉGŰ TÁRSASÁG NGA SHOQËRIA 4IG INFORMATIKAI ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”

Nr.1260, Datë 12.02.2026.....37

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRIVE N7 DEFENCE HOLDING ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG, VAB KORLÁTOLT FELELŐSSÉGŰ TÁRSASÁG, HIRTENBERGER DEFENCE SYSTEMS VÉDELMI IPARI KORLÁTOLT FELELŐSSÉGŰ TÁRSASÁG NGA SHOQËRIA 4IG ŰR ÉS VÉDELMI TECHNOLOGIÁK ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”

Nr.1261, Datë 20.02.2026.....42

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË BANKËN E BASHKUAR TË SHQIPËRISË (UBA)”

Nr.1262, Datë 20.02.2026.....52

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES UNION BANK SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË BANKËN UNION DHE NDAJ NDËRMARRJES E-BUSINESS SOLUTIONS SHPK NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË BANKËN UNION, KU NDËRMJETËSIMIN E USHTRON NDËRMARRJA E-BUSINESS SOLUTIONS SHPK”

Nr.1263, Datë 20.02.2026.....64

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES BANKA E PARË E INVESTIMEVE SHA NË TREGUN E KREDIDHËNIES ME SIGURIM E JETE PËR KREDITË QË JEPEN BRENDA BANKËS BANKA E PARË E INVESTIMEVE”

Nr.1264, Datë 20.02.2026.....73

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES CREDINS BANK SHA NË

TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË BANKËN CREDINS”

Nr.1265, Datë 20.02.2026.....**86**

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES PROCREDIT SHA NË TREGUN E KREDIDHËNIES ME SIGURIM E JETE PËR KREDITË QË JEPEN BRENDA BANKËS PROCREDIT”

Nr.1266, Datë 20.02.2026.....**95**

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË BANKËN ABI DHE NDAJ NDËRMARRJES ABI BROKER SIGURIMESH SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË BANKËN ABI, KU NDËRMJETËSIMIN E USHTRON NDËRMARRJA ABI BROKER SIGURIMESH SHA”

Nr.1267, Datë 20.02.2026.....**108**

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES OTP BANK ALBANIA SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË OTP BANK ALBANIA”

Nr.1268, Datë 20.02.2026.....**119**

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES RAIFFEISEN BANK SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË RAIFFEISEN”

Nr.1269, Datë 20.02.2026.....**132**

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES BANKA KOMBËTARE TREGTARE SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË BANKËN KOMBËTARE TREGTARE”

Nr.1270, Datë 20.02.2026.....**143**

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES TIRANA BANK SHA NË

TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË TIRANA BANK

Nr.1271, Datë 25.02.2026.....**153**

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E PËRPUNIMIT DHE TREGTIMIT TË SHEQERIT”

Nr.1272, Datë 25.02.2026.....**156**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË WARNER BROS. DISCOVERY, INC. NGA SHOQËRIA NETFLIX, INC.”

Nr.1273, Datë 25.02.2026.....**160**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË DISA ASETVE QË LIDHEN ME BIZNESIN ESTEE LAUDER BULGARIA EOOD NGA SHOQËRIA ORBICO BULGARIA EOOD”

Nr.1274, Datë 25.02.2026.....**165**

“PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR PËRJASHTIMIN NË BLLOK TË KATEGORIVE TË MARRËVESHJEVE VERTIKALE DHE PRAKTIKAVE TË BASHKËRENDUARA”

Nr.1275, Datë 25.02.2026.....**167**

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E TRANSPORTIT DETAR NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVË NË PORTIN E DURRËSIT DHE VLORËS ME DISA DETYRIME PËR NDËRMARRJET QË OPEROJNË NË TREG DHE DISA REKOMANDIMEVE PËR MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË”

Nr.1276, Datë 25.02.2026.....**177**

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË BANKËN INTESA SANPAOLO”

Nr.1278, Datë 09.03.2026.....**190**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË THE BRIDGE S.R.L. NGA SHOQËRIA AMBIENTA SGR SPA”

Nr.1279, Datë 09.03.2026.....**194**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E

KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË PRIMORSKI SKLADI, D.O.O. NGA SHOQËRITË OTP ALAPKEZELŐ ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG DHE OTP BANKA D.D.”

Nr.1280, Datë 25.02.2026.....**198**

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPAK NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË CIGAREVE”

Nr.1281, Datë 27.03.2026.....**202**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË HELICONTROL KORLÁTOLT FELELŐSSÉGŰ TÁRSASÁG NGA SHOQËRIA 4IG ŰR ÉS VÉDELMI TECHNOLÓGIÁK ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”

Nr.1282, Datë 27.03.2026.....**206**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT INDIREKT TË SHOQËRISË SWIXX BIOPHARMA HOLDING AG NGA SHOQËRIA SK CAPITAL PARTNERS, LP, NËPËRMJET SHOQËRISË SKES INVESTMENT 17 S.À.R.L.”

Nr.1283, Datë 27.03.2026.....**211**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË ČESKÉ AEROLINIE A.S. DHE GRUPIT SMARTWINGS NGA SHOQËRIA PEGASUS HAVA TAŞIMACILIĞI ANONİM ŞİRKETİ”

VENDIM

Nr. 1252, Datë 14.01.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TË PLOTA, M-ONE ALBANIA SHPK, NGA SHOQËRITË BALFIN – BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK DHE MILŠPED DOO BEOGRAD”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.01.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, M-ONE Albania SHPK, nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe MILŠPED DOO BEOGRAD.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, M-ONE Albania SHPK, nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe MILŠPED DOO BEOGRAD”,

VËREN SE :

I.Palët në transaksion dhe procedura

1. [_____].
2. [_____]
3. [_____]
4. [_____]
5. [_____]

6. []
7. []
 - a. []
 - b. []
8. []

II. Përqendrimi

9. []
10. []
11. []
12. []

III. Analiza e konkurrencës

13. []
14. []
15. []
16. []
17. []
18. []
19. []
20. []
21. []
22. []
- []

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, M-ONE Albania SHPK, nga shoqëritë Balfin – Balkan Finance Investment Group SHPK dhe MILŠPED DOO BEOGRAD.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr.1253, Datë 14.01.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË EUROPCAR MOBILITY GROUP S.A. NGA SHOQËRIA VOLKSWAGEN FINANCE LUKSEMBURG S.A., NËPËRMJET SHOQËRISË GREEN MOBILITY HOLDING S.A..”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.01.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përftimin e kontrollit të shoqërisë Europcar Mobility Group S.A. nga shoqëria Volkswagen Finance Luksemburg S.A., nëpërmjet shoqërisë Green Mobility Holding S.A..

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përftimit të kontrollit të shoqërisë Europcar Mobility Group S.A. nga shoqëria Volkswagen Finance Luksemburg S.A., nëpërmjet shoqërisë Green Mobility Holding S.A..”,

VËREN SE :

I.Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar për përftimin e kontrollit të shoqërisë Europcar Mobility Group S.A. nga shoqëria Volkswagen Finance Luksemburg S.A., nëpërmjet shoqërisë Green Mobility Holding S.A..
2. Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

3. **Pala 1: Volkswagen Finance Luksemburg S.A. (Volkswagen)** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Luksemburgut, me objekt aktiviteti: pjesëmarrje në shoqëri vendase dhe të huaja, ose në shoqëri të çfarëdo lloji, si dhe të menaxhojë këto pjesëmarrje, të marrë pjesë në krijimin, zhvillimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e çdo shoqërie ose ndërmarrje, etj. Volkswagen Finance Luksemburg S.A., zotërohet tërësisht nga Volkswagen Aktiengesellschaft dhe është në pronësi të plotë të Grupit Volkswagen.
4. **Volkswagen Aktiengesellschaft** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt veprimtarie: prodhimi dhe shitja e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, pjesëve të tyre si dhe të gjitha sistemeve, makinerive, veglave dhe produkteve të tjera teknike. Shoqëria gjithashtu mund të krijojë degë brenda dhe jashtë vendit, të themelojë ose të blejë shoqëri të tjera ose të marrë pjesë/ investojë në shoqëri të tilla. Volkswagen Aktiengesellschaft është shoqëria mëmë e Volkswagen Group.
5. Grupi Volkswagen është aktiv në të gjithë botën në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve, autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë. Grupi Volkswagen gjithashtu angazhohet dhe në shpërndarjen e automjeteve.
6. Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes 2 filialeve të mëposhtme:
 - a. *Porsche Leasing SHPK*, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.
 - b. *Porsche Albania SHPK*, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesoreve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesoreve, etj.
7. **Pala 2: Gilpin Investments Designated Activity (Attestor)** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Irlandës, me aktivitet të përcaktuar në përputhje me ligjin irlandez “Për Shoqëritë Tregtare”. Kjo shoqëri administrohet nga Attestor Limited, themeluar sipas ligjeve të Anglisë dhe Uellsit.
8. **Pala 3: Pon Holdings B.V.** është një shoqëri e themeluar, sipas legjislacionit Holandez. Pon Holdings B.V. është një konglomerat shumëkombësh holandez në pronësi familjare me seli në Amsterdam, që vepron si grupi më i madh i lëvizshmërisë në Holandë dhe përqendrohet në zgjidhje të qëndrueshme transporti për biçikleta, makina luksoze, dhe me performancë të lartë, si dhe pajisje industriale.

9. **Pala 4: Pon Europe B.V.** është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Holandez dhe regjistruar në regjistrin tregtar holandez.
10. **Target: Europcar Mobility Group S.A.** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të francez, me objekt aktiviteti: Çdo pjesëmarrje ose interesa për të gjithë personat juridikë francezë ose të huaj, si dhe të gjitha aktivitetet që mund të ushtrohen nga një shoqëri holding – pjesëmarrja e shoqërisë, me të gjitha mjetet, me të gjitha operacionet që mund të lidhen me objektin e saj ose me anë të krijimit të shoqërive të reja, etj., në kuptim të nenit L 511-7 i njohur si Kodi Monetar dhe Financiar. Europcar Mobility Group S.A. kontrollohet tërësisht nga Green Mobility Holding S.A.
11. **Green Mobility Holding S.A.** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Luksemburgut, me objekt aktiviteti: pjesëmarrëse në shoqëri vendase dhe të huaja, ose në shoqëri të çfarëdo lloji, si dhe të menaxhojë këto pjesëmarrje. Shoqëria mund të blejë aksione, kuota dhe tituj të tjerë, obligacione të pasiguruara, certifikata depozite dhe instrumente të tjera borxhi përmes nënshkrimit, blerjes, këmbimit, dhe në përgjithësi të gjithë titujt dhe instrumentet financiare që emetohen nga subjekte ligjore publike ose private, etj. Shoqëria zotërohet nga Volkswagen Finance Luksemburg S.A.; Gilpin Investments Designated Activity dhe Pon Holdings B.V..
12. Grupi Europcar Mobility nuk ka filial të regjistruar në Shqipëri.

II.Përqendrimi

13. Ndërmjet palëve Volkswagen Finance Luxemburg S.A., Gilpin Investments Designated Activity, Pon Holdings B.V., Pon Europe B.V., Attestor Value Master Fund LP(Garantuesi i Attestor) dhe Green Mobility Holding (Shoqëria), është lidhur “Marrëveshje e Aksionarëve” më datë [_____] dhe (i) Njoftim për Ushtrimin e Opsionit të Shitjes A/V, të lëshuar nga Gilpin më datë [_____] , në përputhje me nenet 9.1 dhe 9.3 të Marrëveshjes së Aksionarëve.(ii) Deklaratë që konfirmon datën e marrjes së Njoftimit për Ushtrimin e Opsionit të Shitjes A/V, të lëshuar nga Volkswagen Aktiengesellschaft më datë[_____].
14. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 847, datë 16 nëntor 2021 “Mbi përfitim të kontrollit të shoqërisë Europcar Mobility Group S.A. nga shoqëria Volkswagen Finance Luxemburg S.A. dhe Trinity Investments Designated Activity Company”, ka autorizuar përqendrimin e njoftuar.
15. Referuar këtij vendimi ndërmjet shoqërive Volkswagen Finance Luxemburg S.A., Trinity Investments Designated Activity Company, Pon Holdings B.V., Green Mobility Holding dhe shoqërisë Attestor Value Master Fund LP, është lidhur “Kontratë Kuadër Transaksioni”, më datë 28 korrik 2021, dhe sipas kësaj Marrëveshje, palët dëshirojnë të blejnë të gjitha aksionet e Europcar Mobility Group dhe dëshirojnë të kryejnë transaksionin e propozuar përmes një

oferte blerjeje vullnetare të dorëzuar përmes shoqërisë Green Mobility Holding, të përcaktuar në këtë kontratë.

16. Sipas marrëveshjes parashikohet që Trinity Investments Designated Activity Company dhe Pon Holdings B.V. të blejnë secili pjesë në shoqërinë Green Mobility Holding S.A. (Bid Co), ku Volkswagen Finance Luxemburg S.A do zotërojë XX% të aksioneve, Trinity Investments Designated Activity Company do të zotërojë XX% të aksioneve dhe Pon Holdings B.V. do të zotërojë X% të aksioneve. Shoqëria do të kontrollohet bashkërisht nga Volkswagen Finance Luxemburg S.A. dhe Trinity Investments Designated Activity Company (ndryshuar emri në Gilpin Investments Designated Activity).
17. Në kuadër të përfuturit të kontrollit të përbashkët, Trinity përfitoi një të drejtë opsioni shitje (*put option right*), që i jepte mundësinë të kërkonte shoqërisë Volkswagen, blerjen e aksioneve në vlerën XX% në Europcar. Kjo e drejtë ju transferua Gilpin pas transferimit të aksioneve. Gilpin tashmë e ka ushtruar këtë të drejtë opsioni shitje, duke kërkuar që Volkswagen të blejë të gjitha aksionet që Gilpin zotëron në Green Mobility Holding S.A..
18. Ky opsion është formalizuar me Njoftimin për Ushtrimin e Opsionit të Shitjes A/V, të lëshuar nga Gilpin më datë [____], në përputhje me nenin 9.1, ku Attestor ka të drejtë të kërkojë që Volkswagen të blejë aksionet e shoqërisë Green Mobility Holding S.A. të mbajtura nga Attestor (tërësisht dhe jo pjesërisht).
19. Pas përfundimit të blerjes së aksioneve të Gilpin Investments Designated Activity, sipas ushtrimit të opsionit Opsionit të Shitjes A/V, Volkswagen do të zotërojë kontrollin e vetëm të drejtpërdrejtë mbi shoqërinë Green Mobility Holding S.A. (indirekt nga Volkswagen Aktiengesellschaft) dhe rrjedhimisht mbi shoqërinë Europcar Mobility Group S.A
20. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfuturin e kontrollit të shoqërisë Europcar Mobility Group S.A. nga shoqëria Volkswagen Finance Luksemburg S.A., nëpërmjet shoqërisë Green Mobility Holding S.A., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

21. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i dhënies me qira të automjeteve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
22. Transaksioni është vijim i zbatimit të opsionit të shitjes mes shoqërive, që i jepte mundësinë shoqërisë Gilpin Investments Designated Activity (Attestor) të kërkonte shoqërisë

Volkswagen, blerjen e aksioneve në vlerën XX% kapitalit në Europcar dhe për pasojë përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë target nga Volkswagen Finance Luksemburg S.A.

23. Grupi Volkswagen drejtohet nga shoqëria mëmë Volkswagen Aktiengesellschaft (Volkswagen AG), e cila operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK, përkatësisht në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të automjeteve; dhe në tregun e qerasë financiare dhe shërbimin e sigurimeve të lidhura me shitjet e automjeteve.
24. Europcar nuk ka filial të regjistruar në Shqipëri, por ka realizuar të ardhura në Shqipëri gjatë vitit 2024 nëpërmjet palëve të treta.
25. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshime në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përftimin e kontrollit të shoqërisë Europcar Mobility Group S.A. nga shoqëria Volkswagen Finance Luksemburg S.A., nëpërmjet shoqërisë Green Mobility Holding S.A..
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1254, Datë 14.01.2026

**“PËR PËRJASHTIMIN NGA NDALIMI TË MARRËVESHJES SË LIDHUR
NDËRMJET SHOQËRIVE PHILIP MORRIS PRODUCTS S.A DHE BRITISH
AMERICAN TOBACCO EXPORTS LIMITED”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.01.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe British American Tobacco Exports Limited.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 5, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe nenet 48-52 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve”, Udhëzimi “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur ndërmjet shoqërive Philip Morris Products S.A dhe British American Tobacco Exports Limited,

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës nëpërmjet shkresës nr. 911 prot., datë 14.10.2025, “Njoftim për përjashtimin e marrëveshjes ndërmjet Philip Morris Products S.A dhe British American Tabacoo Exports Limted”, është depozituar kërkesa për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet palëve Philip Morris Products S.A dhe British American Tobacco Exports Limited.
2. Palët njoftuese kanë depozituar dokumentacion e kërkuar në zbatim të nenit 49 të Ligjit nr. 9121/2003 dhe Udhëzimit “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve”.

3. Referuar marrëveshjes së nënshkruar në datë 31 korrik 2025, palët në marrëveshje janë:
- i. ***British American Tobacco Exports Limited (BAT)***, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe ushtron aktivitetin e saj tregtar në prodhimin e produkteve të duhanit
 - BAT është prezente në Shqipëri XXX.
 - XXX.
 - ii. ***Philip Morris Products S.A (PMI)***, është një shoqëri anonime dhe ushtron aktivitetin e saj tregtar në lidhje me prodhimin dhe shitjen e produkteve të duhanit, të gjitha produkteve që përmbajnë nikotinë dhe i pajisjeve dhe aksesoreve që lidhen me to; ofrimi i të gjitha shërbimeve që lidhen veçanërisht me organizimin dhe drejtimin e ndërmarrjeve.
 - Philip Morris Products S.A është prezente në Shqipëri XXX.
 - XXX
 - iii. ***Ndërmarrja e përbashkët: XXX.***

II. Marrëveshja

4. Më datë 16 dhjetor 2024, palët Philip Morris Products S.A. (PM) dhe British American Tobacco Exports Limited (BAT) kanë rënë dakord për kushtet kryesore të krijimit të një ndërmarrjeje të përbashkët (joint venture – JV).
5. XXX
6. XXX.
7. XXX, ndërsa Palët do të vijojnë të ushtrojnë aktivitetin e tyre në mënyrë plotësisht të pavarur nga njëra-tjetra, pa koordinim të sjelljes së tyre konkurruese përmes JV-së.
8. Konstatohet se Ndërmarrja e Përbashkët, XXX, (JV) XXX dhe për këtë arsye transaksioni i krijimit të një ndërmarrjeje të përbashkët, nuk përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe për këto arsye, nuk do të nënshtrohet procedurave të kontrollit të përqendrimeve të parashikuara në nenet 53-64 të ligjit dhe nuk është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Baza ligjore

9. Marrëveshjet e Përfjashtimit vlerësohen në zbatim të nenit 5 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në të cilin parashikohet përfjashtimin individual i marrëveshjeve nga zbatimi i nenit 4 të tij.
10. Neni 4 i ligjit ndalon të gjitha marrëveshjet të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg.
11. Marrëveshjet përfjashtohen nga ndalimet e nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003 në rastet kur kontribuojnë në përmirësimin e prodhimit ose të shpërndarjes së mallrave ose në nxitjen e progresit teknologjik apo ekonomik nëse një pjesë e mjaftueshme e këtyre përfitimeve shkon në favor të klientëve dhe të konsumatorëve dhe kur:
 - i. Nuk përmban kufizime të veprimtarive të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, që nuk janë të domosdoshme për të arritur objektivat e sipërpërmendur;
 - ii. Nuk kufizon, në mënyrë të ndjeshme, konkurrencën në lidhje me produktet apo shërbimet, objekt i këtyre marrëveshjeve.
12. Procedurat e përfjashtimit të një marrëveshje nga ndalimi janë parashikuar në Seksionin II të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (nenet 48-52), të cilat përcaktojnë kompetencat e Komisionit të Konkurrencës për shqyrtimin, vlerësimin dhe miratimin e kërkesave për përfjashtim. Ndërkohë që aktet nënligjore përfshijnë: Udhëzimin “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve” dhe Udhëzimin “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”.
13. Në këtë kuadër ligjor, marrëveshja e njoftuar ndërmjet Philip Morris Products S.A. dhe British American Tobacco Exports Limited vlerësohet si një marrëveshje horizontale bashkëpunimi, e cila ka për objekt krijimin e një ndërmarrjeje të përbashkët jo me funksione të plota, që ofron shërbime mbështetëse të lidhura me prodhimin, dhe për rrjedhojë i nënshtrohet vlerësimit sipas nenit 5 të Ligjit nr. 9121/2003 për dhënien e përfjashtimit individual nga ndalimi.
14. Palët, besojnë se marrëveshja nuk çon në parandalimin, kufizimin dhe shtrembërimin e konkurrencës në tregun përkatës duke mos qenë një marrëveshje kufizuese sipas nenit 4, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Sipas këtij vetëvlerësimi marrëveshja është në përputhshmëri të plotë me Ligjin nr. 9121/2003, Udhëzimin “Për formën e njoftimit të marrëveshjeve”, dhe Udhëzimin “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”.
15. Bazuar në shpjegimet dhe informacionin e paraqitur në këtë Kërkesë, Palët propozojnë që Autoriteti, pas vlerësimit të kësaj kërkeje: Të japë një përfjashtim individual mbi bazën e nenit 5 të Ligjit për një periudhë 5-vjeçare, pra deri më 31 dhjetor 2030.

IV. Analiza e konkurrencës

16. Në bazë të nenit 3, pika 7 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe Udhëzimit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës përbëhet nga tregut përkatës i produktit dhe tregu përkatës gjeografik. Përcaktimi i tregut përkatës, si në atë të produktit dhe në atë gjeografik, ka një ndikim vendimtar në vlerësimin e strukturës së tregut dhe sjelljes së konkurrentëve në treg.
17. Marrëveshja e njoftuar ndërmjet British American Tobacco Exports Limited (BATEL) dhe Philip Morris Products S.A. (PM) lidhet me krijimin e një ndërmarrjeje të përbashkët (JV), e cila do t’u ofrojë Palëve XXX.
18. XXX.
19. Si rrjedhojë, tregjet përkatëse potencialisht të prekura nga marrëveshja janë tregjet ku Palët ushtrojnë aktivitetin e tyre në mënyrë të pavarur, XXX, ndërsa tregu përkatës gjeografik përcaktohet si territori i Republikës së Shqipërisë.
20. Referuar të dhënave për vitin 2024, XXX në Shqipëri karakterizohet nga prania e disa operatorëve të rëndësishëm ndërkombëtarë dhe nuk paraqet një nivel përqendrimi që të krijojë rrezik për eliminimin e konkurrencës. Në këtë kontekst, ndërmarrja e përbashkët nuk ndryshon strukturën e tregut, nuk konsolidon pjesët e tregut të Palëve dhe nuk ndikon në pavarësinë e tyre vendimmarrëse.
21. JV-ja do të veprojë XXX.
22. Nga perspektiva e konkurrencës, marrëveshja nuk parashikon bashkërendim të sjelljes konkurruese të Palëve në tregjet përkatëse të shitjes së produkteve që përmbajnë nikotinë. Palët do të vijojnë të ushtrojnë në mënyrë të pavarur aktivitetin e tyre tregtar, përfshirë prodhimin, marketingun, vendosjen e çmimeve, shpërndarjen dhe shitjen e produkteve të veta.
23. Marrëveshja synon rritjen e eficiencës ekonomike përmes optimizimit të shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese ekzistuese të Palëve, duke kontribuar në përmirësimin e fleksibilitetit operacional dhe në realizimin e përfitimeve ekonomike, pa sjellë eliminimin ose kufizimin e konkurrencës aktuale apo potenciale në tregjet përkatëse.
24. Marrëveshja e Nënshkrimit të Aksioneve përbën një marrëveshje horizontale bashkëpunimi ndërmjet ndërmarrjeve konkurrense. XXX, marrëveshja nuk prodhon efekte strukturore në tregun shqiptar.

25. Në përfundim të vlerësimit të marrëveshjes së njoftuar, konstatohet se ajo nuk sjell efekte kufizuese mbi konkurrencën dhe përmbush kushtet për përjashtim nga ndalimi, në përputhje me nenin 5 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 5, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenet 48-52 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Të përjashtojë nga ndalimi Marrëveshjen e Nënshkrimit të Aksioneve, së bashku me Marrëveshjen e Aksionarëve, Marrëveshjen e Shërbimeve dhe Marrëveshjen e Prodhimit, ndërmjet palëve Philip Morris Products S.A dhe British American Tobacco Exports Limited.
- II. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, nga marrja e këtij vendimi.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1255, Datë 12.02.2026

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E
IMPORTIT, PËRPUNIMIT DHE TREGTIMIT TË KAFESË”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimin e kërkesës së Sekretariatit për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, përpunimit dhe tregtimit të kafesë.

Baza Ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42 pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të: Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi monitorimin e tregut të importit, përpunimit dhe tregtimit të kafesë. ”

VËREN SE :

Sekretari i Përgjithshëm, bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me anë të Urdhrit nr. 123, datë 17.12.2025 “Për ngritjen e grupit të punës “Për monitorimin e e produkteve të shportës ushqimore”, ngriti grupin e punës për monitorimin e produkteve të shportës ushqimore. Nisur nga ky monitorim si dhe nga artikujt në median e shkruar, në lidhje me rritjen e çmimit të produktit kafe, grupi i punës u fokusua në monitorimin e këtij produkti.

Për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për realizimin e kësaj procedure, në zbatim të nenit 34 të ligjit nr. 9121/2003, me anë të shkresës sonë nr. 1088/2, datë 23.12.2025 “Kërkesë për informacion”, është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbi importet e realizuara për produktet e shportës sipas subjekteve importuese, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2025. Në përgjigje të kësaj kërkesë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka depozituar informacionin e kërkuar nëpërmjet e-malit zyrtar.

Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u vërejt se kafja kokërr e

papjekur, produkt i cili përbën inputin thelbësor për funksionimin e tregut të përpunimit dhe tregtimit të kafesë në Shqipëri, zë rreth 60-70% të sasisë totale të kafesë së importuar në vendin tonë për vitet 2023-2025.

Ky segment tregu është plotësisht i varur nga importi pasi në Shqipëri nuk prodhohet kafe kokërr. Në sasinë e importuar të kafesë kokërr të papjekur janë rreth 30 importues për periudhën në monitorim janar 2023 – dhjetor 2024

Për vitin 2023 janë 5 importues të cilët zotërojnë rreth 70% të tregut, konkretisht ndërmarrja GP 2 Shpk, me _____ të tregut në sasinë e importuar të kafesë së papjekur, ndërmarrja Deli – Coffee Shpk me _____ të tregut, ndërmarrja Mulliri i Vjetër Shpk me _____ të tregut, Alb-Erk Shpk me _____ të tregut dhe New Century Shpk me _____ të tregut.

Për vitin 2024, ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut mbetet GP 2 Shpk me _____ e ndjekur nga ndërmarrja Deli Coffee Shpk me _____ të sasisë së importuar të kafesë së papjekur si dhe Mulliri i Vjetër shpk me _____. Ndërmarrje të tjera me pjesë relativisht të larta tregu për vitin 2024 janë Alb – Erk dhe Valtelina me pjesë tregu përkatësisht _____ dhe _____. Ndërmarrja Coffeehouse Shpk për këtë periudhë zotëron _____ të tregut.

Për vitin 2025, ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut mbetet përsëri GP2 Shpk me rreth _____ të tregut sipas sasisë së kafesë së papjekur kokërr, pjesë tregu e cila është në rritje me rreth _____ krahasuar me vitin 2024. Në të njëjtin pozicion përgjatë gjithë periudhës mbeten të njëjtat ndërmarrje, Deli Coffee dhe Mulliri i Vjetër.

Segmenti tjetër tregu është përpunimi dhe ambalazhimi i kafesë, treg i cili mund të jetë i integruar vertikalisht me tregun e importit, pra kafeja kokërr përpunohet nga ndërmarrje të cilat zotërohen nga importuesit e kafesë kokërr, e cila konsiderohet si lëndë e parë në fabrikat në vend. Në këtë segment tregu bëjnë pjesë edhe ndërmarrjet të cilat importojnë kafe kokërr të pjekur ose të bluar, të gatshme për konsum.

Në përfundim, duke qënë se tregu i importit të kafesë karakterizohet nga:

- Një numër i kufizuar ndërmarrjesh që kontrollojnë shumicën e importeve të kafesë, ndërsa pjesa tjetër e ndërmarrjeve zotëron pjesë shumë të vogla tregu, pa ushtruar presion real konkurrues mbi ndërmarrjet kryesore.
- Pjesët e tregut të ndërmarrjeve kryesore paraqiten të qëndrueshme dhe me trend rritës, duke sinjalizuar ekzistencën e barrierave të larta hyrjeje dhe mungesë të konkurrencës potenciale efektive.
- Kafeja kokërr e papjekur përbën input thelbësor për tregun e përpunimit, pjekjes dhe tregtimit të kafesë dhe përqendrimi i këtij inputi në duart e pak ndërmarrjeve rrit rrezikun e kufizimit të aksesit në treg për ndërmarrjet më të vogla.
- Prania e ndërmarrjeve të integruara vertikalisht (import–përpunim–tregtim) krijon rrezik për efekte përjashtuese, përfshirë favorizimin e njërive të veta dhe mbylljen graduale të tregut për konkurrentët e pavarur.

— Struktura e tregut, niveli i përqendrimit dhe transparenca e lartë krijojnë kushte strukturore që favorizojnë sjellje të bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve.

Në përfundim, duke vlerësuar se këto elemente krijojnë rrezik për caktim çmimesh, kushte tregtare të pabarabarta dhe diskriminim midis klientëve, me efekte të mundshme negative në tregjet e integruara vertikalisht, lind dyshimi i arsyeshëm që sjellja e ndërmarrjeve në treg, mund të përbëjë pengim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në kuptim të neneve 4 dhe 9 të ligjit 9121, datë 28.07.2013 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 4, nenit 9, nenit 24, shkronja d), si dhe nenit 42 pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, përpunimit dhe tregtimit të kafesë;
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janar 2025 deri në 31 Dhjetor 2025;
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1256, Datë 12.02.2026

“PËR RRËZIMIN E KËRKESËS SË NDËRMARRJES NEDRETE ARAPI PF PËR RISHQYRTIMIN E VKK NR. 1237, DATË 26.11.2025, “PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E GRUMBULLIMIT DHE SHITJES ME SHUMICË TË FRUTA-PERIMEVE NË QARKUN TIRANË, ELBASAN, BERAT, FIER, KORÇË DHE GJOBITJEN E NDËRMARRJES NEDRETE ARAPI PF PËR SHKELJE TË KONKURRENCËS”, ”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.02.2026 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes Nedrete Arapi PF për rishqyrtimin e VKK nr. 1237, datë 26.11.2025.

Bazë ligjore: Neni 24, shkronja d), neni 26, neni 46, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të kërkesës së ndërmarrjes Nedrete Arapi PF për rishqyrtimin e VKK nr. 1237, datë 26.11.2025 të Komisionit të Konkurrencës, si dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Ndërmarrja Nedrete Arapi PF me anë të shkresës nr.59/52 prot., AK, datë 30.12.2025, me lëndë “Kërkesë për rishqyrtim”, kërkon nga ana e Komisionit të Konkurrencës rishqyrtimin/shfuqizimin e VKK nr. 1237, datë 26.11.2025 të KK, pasi kjo ndërmarrja bazuar në KprA, si dhe nenin 46, pika c), të ligjit nr.9121/2003, gjykon se ky vendim është marrë në shkelje të procedurave administrative. .

2. Bazuar në nenin 32 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti, në ushtrimin e funksionit të tij, zbaton Kodin e Procedurave Administrative, përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.
3. Në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, procedura administrative e hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë është mbyllur duke u shprehur me anë të VKK nr. 1237, datë 26.11.2025 lidhur me subjektin Nedrete Arapi PF.
4. Procedura e revokimit të një vendimi të Komisionit të Konkurrencës parashikohet në ligjin e posaçëm, konkretisht në nenin 46 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit revokimi i këtij Vendimi mund të kryhet nga Komisioni i Konkurrencës vetëm kur përmbush të paktën njërin nga 3 kriteret e përcaktuara në këtë nen.
5. Në respektim të këtij neni Komisioni mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën kur:
 - a) Njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit kanë ndryshuar;
 - b) Palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
 - c) Vendimi është bazuar në të dhëna jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.
6. Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjes Nedrete Arapi PF dhe i argumenteve të dhëna nga kjo ndërmarrje, konstatohet se nuk ndodhemi përpara kushteve të përcaktuara në ligjin e posaçëm. Pra, në kuptim të nenit 46 të ligjit nr. 9121, datë 28.09.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kërkesa e ndërmarrjes Nedrete Arapi PF nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në këtë nen.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), dhe nenin 46 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes Nedrete Arapi PF për rishqyrtimin e Vendimit nr. 1237, datë 26.11.2025 të Komisionit të Konkurrencës.
- II. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 1237, datë 26.11.2025 të Komisionit të Konkurrencës.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi ndërmarrjes Nedrete Arapi PF .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr.1257, Datë 12.02.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË DISA ASETEVE QË LIDHEN ME BIZNESIN DOCKERS EU NGA SHOQËRIA ORBICO SPORTSTYLE S.R.L. ”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim e kontrollit të disa aseteve që lidhen me biznesin Dockers EU nga shoqëria ORBICO SPORTSTYLE S.r.l.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitimit të kontrollit të disa aseteve që lidhen me biznesin Dockers EU nga shoqëria ORBICO SPORTSTYLE S.r.l.”,

VËREN SE :

I.Palët në transaksion dhe procedura

23. [_____]

24. [_____]

25. [_____]

26. [_____]

27. [_____]

28. [_____]

29. [_____]

30. [_____]

31. [_____]

32. [_____]

33.

II.Përqendrimi

21. [_____]

22. [_____].

23. [_____]

24. [_____]

25. [_____]

26. [_____]

27. [_____]

28. [_____]

III.Analiza e konkurrencës

26. [_____]

27. [_____]

28. [_____]

29. [_____]

30. [_____]

31. [_____]

34. [_____]

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit të disa aseteve që lidhen me biznesin Dockers EU nga shoqëria ORBICO SPORTSTYLE S.r.l.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1258, Datë 12.02.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË FACEKOM KORLÁTOLT FELELŐSSÉGŰ TÁRSASÁG NGA SHOQËRIA 4IG INFORMATIKAI ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përftimin e kontrollit të shoqërisë FaceKom Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përftimit të kontrollit të shoqërisë FaceKom Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përftimin e kontrollit të shoqërisë FaceKom Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

2. Referuar dokumentit “Kontratë shitblerjeje e pjesës së aksioneve të biznesit”, palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság (4iG Informatikai Zrt.)** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, e cila fokusohet në teknologjinë e informacionit dhe integrimin e sistemeve për klientët. Ajo ofron dizajnin e sistemeve IT, zgjidhje të plotë për infrastrukturën digjitale, zhvillim të softuerëve kompleks, mbështetje për shërbimet IT dhe mbështetje për iniciativa të transformimit digjital.
4. Kjo shoqëri është pjesë e grupit 4iG, i cili është prezent në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë ONE ALBANIA SHA, shoqëri aksionare, me objekt aktiviteti: ndërtimin, zotërimin, operimin dhe ofrimin e rrjetit publik të telefonisë së lëvizshme të standardit GSM dhe telefoni fikse, komunikimi bazë i telefonisë celulare në rrjetin lokal bazuar në kanalet radio, komunikim bazë në rrjetin ndërqytetas që lidhen me transmetimin radio, komunikim ndërkombëtar të çdo lloj transmetimi dhe vale, komunikimi i të dhënave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, komunikim multimedia dhe ISDN, komunikim teleteks dhe videotekst, etj.
5. **Shitësi: Central European Opportunity Magántókealap** është një fond kapitali privat, i regjistruar pranë Bankës Kombëtare të Hungarisë.
6. **Shoqëria Target: FaceKom Korlátolt Felelősségű Társaság (FaceKom Kft.)** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, veprimtaria kryesore e së cilës përfshin identifikimin digjital të klientëve, të realizuar në distancë nëpërmjet teknologjisë video dhe njohjes së fytyrës, si dhe shërbime të lidhura me pranimin e klientëve dhe shërbime virtuale call-center. FaceKom Kft. është në pronësi të plotë të Central European Opportunity Magántókealap.
7. FaceKom Kft. zotëron plotësisht filialin e saj FaceKom Services Zártkörűen Működő Részvénytársaság, shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, e cila operon si një ofrues i shërbimeve të besueshme për nënshkrimet elektronike.
8. Shoqëria target nuk operon dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.

II. Përqendrimi

9. Më datë [____], ndërmjet shoqërisë 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság (në cilësinë e blerësit) dhe shoqërisë Central European Opportunity Magántókealap (në cilësinë e shitësit), është nënshkruar “Kontratë shitblerjeje e pjesës së aksioneve të biznesit” për shitblerjen e pjesës së kuotës që përfaqëson X% të kapitalit themeltar të shoqërisë FaceKom Korlátolt Felelősségű Társaság.
10. Sipas Marrëveshjes, Shitësi synon të shesë dhe t’i transferojë Blerësit, pjesën e kuotës që përfaqëson X% të kapitalit themeltar të shoqërisë target FaceKom Kft., ndërsa blerësi synon të blejë dhe të pranojë pjesën e kuotës, në përputhje me kushtet e parashikuara në kontratë.

11. Pas përmbylljes të transaksionit, 4iG Informatikai Zrt. do të zotërojë plotësisht shoqërinë FaceKom Kft. dhe gjithashtu kontrollin mbi shoqërinë filial FaceKom Services Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
12. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë FaceKom Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

13. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i ofrimit të zgjidhjeve të sigurta për verifikimin dhe autentifikimin digjital të identitetit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
14. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë FaceKom Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
15. Shoqëria 4iG Informatikai Zrt. është një shoqëri aktive në sektorin e IT-së, duke u fokusuar në teknologjinë e informacionit dhe integrimin e sistemeve për klientët, pjesë e Grupit 4iG.
16. Grupi 4iG është prezent në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë ONE ALBANIA SHA, një shoqëri aktive në tregun e komunikimeve elektronike.
17. Shoqëria FaceKom Kft. është një shoqëri aktive në ofrimin e identifikimit digjital të klientëve në distancë, bazuar në njohjen e fytyrës përmes video, si dhe shërbimeve të lidhura për onboarding të klientëve dhe qendra virtuale të thirrjeve.
18. Target nuk operon dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.
19. Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim e kontrollit të shoqërisë FaceKom Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1259, Datë 12.02.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË MOBIL ADAT TÁVKÖZLÉSI ÉS INFORMATIKAI SZOLGÁLTATÓ KORLÁTOLT FELELŐSSÉGŰ TÁRSASÁG NGA SHOQËRIA 4IG INFORMATIKAI ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim e kontrollit të shoqërisë Mobil Adat Távközlési és Informatikai Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitimit të kontrollit të shoqërisë Mobil Adat Távközlési és Informatikai Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar për blerjen e 90% të aksioneve të shoqërisë Mobil Adat Távközlési és Informatikai Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

2. Referuar dokumentit “Kontratë shitblerje e pjesës së aksioneve të Biznesit”, palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság/ 4iG Informatikai Zrt.** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, dhe me seli në Budapest. 4iG Informatikai Zrt, fokusohet në teknologjinë e informacionit dhe integrimin e sistemeve për klientët. Ajo ofron dizajnin e sistemeve IT, zgjidhje të plotë për infrastrukturën digjitale, zhvillim të softuerëve kompleks, mbështetje për shërbimet IT dhe mbështetje për iniciativa të transformimit digjital.
4. Kjo shoqëri është pjesë e grupit 4iG. Grupi 4iG është prezent në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë ONE ALBANIA SHA.
5. ONE ALBANIA SHA është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me NUIS [____], me objekt aktiviteti: ndërtim, zotërim, operim dhe ofrimin e rrjetit publik të telefonisë së lëvizshme të standardit GSM dhe telefoni fikse, komunikimi bazë i telefonisë celulare në rrjetin lokal bazuar në kanalet radio, komunikim bazë në rrjetin ndërqytetas që lidhen me transmetimin radio, komunikim ndërkombëtar të çdo lloj transmetimi dhe vale, komunikimi i të dhënave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, komunikim multimedia dhe ISDN, komunikim teleteks dhe videotekst, etj.
6. **Shitësi 1: Mobil Adat Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság**, është një shoqëri aksionare e mbyllur, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, me seli në Budapest.
7. **Shitësi 2: SHOAL Vagyonkezelő Zártkörűen Működő Részvénytársaság**, është një shoqëri aksionare e mbyllur, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, me seli në Budapest.
8. **Shoqëria Target : Mobil Adat Távközlési és Informatikai Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság/ Mobil Adat Kft.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë. Aktiviteti kryesor i shoqërisë është: ofrimi i shërbimeve të komunikimit të specializuar për kasat fiskale online, pajisje M2M dhe IoT, SIM cards me roaming, dhe platformë menaxhimi.
9. Kapitali aksionar i shoqërisë target aktualisht zotërohet nga shoqëria Mobil Adat Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság dhe nga SHOAL Vagyonkezelő Zártkörűen Működő Részvénytársaság me nga respektivisht 45% të kapitalit, dhe pjesa e mbetur e minorancës zotërohet nga dy individë.

II.Përqendrimi

10. Më datë [____], ndërmjet shoqërisë 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság (blerësi) dhe shoqërive Mobil Adat Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság (shitësi 1) dhe SHOAL Vagyonkezelő Zártkörűen Működő Részvénytársaság, (shitësi 2) është nënshkruar “Kontratë shitblerje e pjesës së aksioneve të Biznesit” në lidhje me blerjen e X%

të kapitalit të aksioneve të Mobil Adat Távközlési és Informatikai Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság.

11. Në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje shitësit zotërojnë gjithsej X% të kapitalit të shoqërisë target. Shitësit duan të shesin aksionet dhe t'i transferojnë ato tek blerësi, i cili dëshiron ti blejë sipas kushteve të kësaj kontrate.
12. Sipas deklaramentit të palës njoftuese, pas përmbylljes së transaksionit, shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság, do të fitojë kontroll të vetëm mbi shoqërinë target.
13. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Mobil Adat Távközlési és Informatikai Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III. Analiza e konkurrencës

14. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu për shërbimet e menaxhuara të të dhënave celulare dhe për lidhjet M2M, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
15. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Mobil Adat Távközlési és Informatikai Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
16. Shoqëria 4iG Informatikai Zrt. është një shoqëri aktive në sektorin e IT-së, duke u fokusuar në teknologjinë e informacionit dhe integrimin e sistemeve për klientët, pjesë e Grupit 4iG.
17. Grupi 4iG është prezent në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë ONE ALBANIA SHA, një shoqëri aktive në tregun e komunikimeve elektronike.
18. Shoqëria Mobil Adat Kft. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit hungarez, e cila ofron një gamë të gjerë shërbimesh IT, integrimi i sistemeve, shërbime cloud dhe shërbime të sigurisë kibernetike.
19. Shoqëria target nuk është aktive në asnjë treg në Shqipëri.
20. Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim e kontrollit të shoqërisë Mobil Adat Távközlési és Informatikai Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Informatikai Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1260, Datë 12.02.2026

“MBIAUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRIVE N7 DEFENCE HOLDING ZÁRTKÖRÜEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG, VAB KORLÁTOLT FELELŐSSÉGŰ TÁRSASÁG, HIRTENBERGER DEFENCE SYSTEMS VÉDELMI IPARI KORLÁTOLT FELELŐSSÉGŰ TÁRSASÁG NGA SHOQËRIA 4IG ŰR ÉS VÉDELMI TECHNOLÓGIÁK ZÁRTKÖRÜEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim të kontrollit të shoqërive N7 Defence Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság, VAB Korlátolt Felelősségű Társaság, Hirtenberger Defence Systems Védelmi Ipari Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të shoqërive N7 Defence Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság, VAB Korlátolt Felelősségű Társaság, Hirtenberger Defence Systems Védelmi Ipari Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim të kontrollit të shoqërive N7 Defence Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság, VAB Korlátolt Felelősségű Társaság, Hirtenberger Defence Systems Védelmi Ipari Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
2. Referuar 3(tre) dokumenteve “Marrëveshje për blerje kuotash”, palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság /4iG Űr és Védelmi Zrt. (4iG SDT)**, është një shoqëri aksionare e mbyllur, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, dhe me objekt kryesor aktiviteti: Menaxhimi i aseteve (mbajtjes). 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság, është aktive në sektorin e mbrojtjes dhe të teknologjisë së lartë, duke u fokusuar në zhvillimin dhe prodhimin e sistemeve mbrojtëse, teknologjive ushtarake dhe zgjidhjeve për teknologjinë hapësinore. Gjithashtu, shoqëria është e angazhuar në shërbime të teknologjisë së informacionit dhe telekomunikacionit, si dhe në investime strategjike në industri të teknologjisë së lartë dhe të lidhura me mbrojtjen. Kjo shoqëri është pjesë e grupit 4iG.
4. Grupi 4iG është prezent në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë ONE ALBANIA SHA. ONE ALBANIA SHA është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me NUIS [____], me objekt aktiviteti: Ndërtim, zotërim, operim dhe ofrimin e rrjetit publik të telefonisë së lëvizshme të standardit GSM dhe telefoni fikse, komunikimi bazë i telefonisë celulare në rrjetin lokal bazuar në kanalet radio, komunikim bazë në rrjetin ndërqytetas që lidhen me transmetimin radio, komunikim ndërkombëtar të çdo lloj transmetimi dhe vale, komunikimi i të dhënave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, komunikim multimedia dhe ISDN, komunikim teleteks dhe videotekst, etj.
5. **Shitësi: N7 HOLDING NEMZETI VÉDELMI IPARI INNOVÁCIÓS Zártkörűen Működő Részvénytársaság/ N7 HOLDING**, është një shoqëri aksionare e mbyllur, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë.
6. **Shoqëria Target 1: N7 Defence Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság / N7 Defence Holding Zrt.** është një shoqëri aksionare e mbyllur, kombëtare, për inovacionin në industrinë e mbrojtjes, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë. Shoqëria është një shoqëri tregtare me qëllim fitimi, e cila ka për mision zbatimin e strategjisë së industrisë së mbrojtjes dhe administrimin e elementeve të pasurisë që lidhen me industrinë mbrojtëse. Veprimtaria e saj kryesore është Administrimi i pasurisë(holding) dhe menaxhim biznesi, këshillim në menaxhim dhe konsulenca të tjera administrative.

7. **Shoqëria Target 2: VAB Korlátolt Felelősségű Társaság** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë. Shoqëria ka si veprimtari kryesore organizimin e projekteve të ndërtimit të objekteve.
8. **Shoqëria Target 3: Hirtenberger Defence Systems Védelmi Ipari Korlátolt Felelősségű Társaság/ Hirtenberger Defence Systems Kft** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë. Shoqëria ka si veprimtari kryesore menaxhimin e biznesit dhe aktivitete të tjera si: prodhim armësh dhe municionesh, konsulencë në menaxhimin e biznesit dhe menaxhim të përgjithshëm, veprimtari inxhinierike dhe konsulencë teknike dhe maredhënie me publikun.
9. Shoqëritë target kontrollohen plotësisht nga aksioneri i vetëm, shoqëria N7 HOLDING NEMZETI VÉDELMI IPARI INNOVÁCIÓS Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

II. Përqendrimi

10. [____], ndërmjet shoqërisë 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság (blerësi) dhe shoqërisë N7 HOLDING NEMZETI VÉDELMI IPARI INNOVÁCIÓS Zártkörűen Működő Részvénytársaság (shitësi), është nënshkruar “Kontratë për shitjen e aksioneve” në lidhje me pjesën e kapitalit në shoqërinë N7 Defence Holding Zrt. që përfaqëson XX% + X të drejtë vote në kapitalin themeltar të saj.
11. Referuar kësaj Marrëveshje, blerësi do të bëhet pronar (aksionar) i aksioneve të zakonshme që përfaqësojnë XX% + X të drejtave të votës në shoqërinë target, në kohën e përcaktuar në Marrëveshje.
12. [____], ndërmjet shoqërisë 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság (blerësi) dhe shoqërisë N7 HOLDING NEMZETI VÉDELMI IPARI INNOVÁCIÓS Zártkörűen Működő Részvénytársaság (shitësi), është nënshkruar “Kontratë për shitblerjen e pjesës së kapitalit të shoqërisë ” në lidhje me pjesën e kapitalit në shoqërinë VAB Korlátolt Felelősségű Társaság që përfaqëson XX% + X të drejtë vote në kapitalin themeltar të saj.
13. Pas përfundimit të transaksionit 4iG SDT do të blejë XX% + X të drejtave të votës në kapitalin e shoqërisë VAB Korlátolt Felelősségű Társaság, e cila mban XX% të pjesëmarrjes së shoqërisë N7 HOLDING në Rheinmetall Hungary Zrt.
14. [____], ndërmjet shoqërisë 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság (blerësi) dhe shoqërisë N7 HOLDING NEMZETI VÉDELMI IPARI INNOVÁCIÓS Zártkörűen Működő Részvénytársaság (shitësi), është nënshkruar “Kontratë për shitblerjen e pjesës së kapitalit të shoqërisë ”, mbi blerjen X% të pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë Hirtenberger Defence Systems Védelmi Ipari Korlátolt Felelősségű Társaság.

15. Pas përfundimit të transaksionit 4iG SDT do të blejë X% të kapitalit të shoqërisë Hirtenberger Defence Systems Védelmi Ipari Korlátolt Felelősségű Társaság.
16. Sipas deklaramentit të palës njoftuese, në përfundim, 4iG SDT do të fitojë shumicën e kontrollit në shoqërinë N7 Defence Zrt. dhe VAB Korlátolt Felelősségű Társaság si dhe kontroll të plotë mbi shoqërinë Hirtenberger Defence Systems Védelmi Ipari Korlátolt Felelősségű Társaság.
17. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërive N7 Defence Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság, VAB Korlátolt Felelősségű Társaság, Hirtenberger Defence Systems Védelmi Ipari Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Úr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

18. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe zhvillimit të mjeteve dhe pajisjeve ushtarake, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
19. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërive N7 Defence Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság, VAB Korlátolt Felelősségű Társaság, Hirtenberger Defence Systems Védelmi Ipari Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Úr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
20. 4iG Úr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság (4iG SDT) është një shoqëri aktive në sektorin e mbrojtjes dhe të teknologjisë së lartë, duke u fokusuar në zhvillimin dhe prodhimin e sistemeve mbrojtëse, teknologjive ushtarake dhe zgjidhjeve për teknologjinë hapësinore, pjesë e Grupit 4iG.
21. Grupi 4iG është prezent në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë ONE ALBANIA SHA, një shoqëri aktive në tregun e komunikimeve elektronike.
22. Shoqëritë target nuk janë aktive në asnjë treg në Shqipëri.
23. Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim e kontrollit të shoqërive N7 Defence Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság, VAB Korlátolt Felelősségű Társaság, Hirtenberger Defence Systems Védelmi Ipari Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1261, Datë 20.02.2026

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË BANKËN E BASHKUAR TË SHQIPËRISË (UBA)”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar dhe dhënia e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë (UBA).

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 26, neni 43, pika 5 dhe neni 45 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e

jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.”;

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur

1. Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të një ankese të depozituar më datë 30 korrik 2024, mbi dyshimin për pengim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në tregun e sigurimit të jetës për kredi, në zbatim të nenit 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, aktivizoi procedurën e monitorimit të këtij tregu.
2. Bankat¹ janë institucione financiare, që ushtrojnë veprimtarinë bankare të pranimit të depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimin e tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të tyre si dhe veprimtari të tjera të natyrës financiare, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Aktualisht në Shqipëri operojnë 11 banka tregtare, me kapital të huaj dhe vendas.
3. Sigurimi i Jetës për Kredi është një produkt që u ofrohet individëve kredimarrës, duke shërbyer ndër të tjera edhe si garanci për bankën, por dhe për kredimarrësin, i cili mbrohet si person i siguruar.
4. Nga analiza e informacionit të mbledhur gjatë fazës së monitorimit u konstatua se, pavarësisht shpjegimeve të dërguara me shkresë nga bankat, përqindjet e tregut total të sigurimit të jetës, të raportuara nga AMF për vitin 2023, nuk reflektohen në ndarjen e portofolit të sigurimit të jetës për kredi, që shitet përmes bankave. Kjo mospërputhje e dukshme ngriti shqetësime mbi funksionimin e konkurrencës në këtë segment të tregut.
5. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1130, datë 07.11.2024, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi për periudhën nga 7 nëntor 2021 deri në 7 nëntor 2024, vendim në të cilin përfshiu edhe ndërmarrjen Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA. Afati i përfundimit të hetimit paraprak, më pas, me Vendimin nr. 1159, datë 13.02.2025 u zgjat deri në 3 mars 2025.
6. Pas përfundimit të hetimit paraprak, u konkludua ndër të tjera se, sjellja e ndërmarrjes Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA mund të përbënte shkelje të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe me Vendimin nr. 1171, datë 26.03.2025 Komisioni i

¹ https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Subjekte_te_licencuara/Banka/

Konkurrencës i hapi rrugë procedurës së hetimit të thelluar në përputhje me parashikimet ligjore për periudhën 7 nëntor 2021 – 26 Mars 2025. Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të hetimit.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

7. Sigurimi është një formë e manaxhimit të riskut që vjen nga një situatë e panjohur, një kontratë në bazë të së cilës një person/kompani, transferon rrezikun e mundshëm të një dëmi/humbje financiare tek një kompani sigurimi, përkundrejt pagesës së një shume që quhet prim sigurimi.
8. Sigurimi i Jetës për Kredi ofrohet për personat që marrin kredi në bankë dhe i mbron ata dhe familjarët nga rreziku i mos shlyerjes së hua-së si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit. Ky sigurim është një garanci financiare si për bankën (nga rreziku i mos shlyerjes së huasë si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit) ashtu edhe për kredimarrësin, personin e siguruar, duke çliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur.
9. Tregu i sigurimeve të jetës në Republikën e Shqipërisë funksionon në zbatim të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.
10. Ligji nr. 52/2014 parashikon si lloje të ndërmjetësimit, veprimtarinë e agentit dhe brokerit, duke përcaktuar se edhe bankat e nivelit të dytë mund të pajisen me licencë për të ushtruar këtë veprimtari. Konkretisht, neni 194, pika 4 parashikon se “Veprimtaria e agentit mund të kryhet edhe nga bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, si dhe subjekte të tjera, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti” ndërsa neni 204 pika 5 parashikon se “Veprimtaria e brokerimit mund të kryhet edhe nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti”.
11. Në bazë të nenit 194 të Ligjit nr. 52/2014, veprimtaria e agentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari. Veprimtaria e agentit në sigurime mund të kryhet edhe në emër të disa shoqërive të sigurimit, nëse shoqëritë e sigurimit kanë rënë dakord me marrëveshje të shkruar midis tyre.

12. Lidhur me veprimtarinë e brokerimit, në bazë të nenit 202 të Ligjit nr. 52/2014, përfshin të gjitha ato veprimtari, si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij. Gjithashtu, përfshin edhe asistencën për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, veçanërisht zgjidhjen e kërkesave për dëmshpërblim nga shoqëria e sigurimit, në emër dhe për llogari të konsumatorit. Brokëri/shoqëria e brokerimit ndërmjetëson për lidhjen e kontratave të sigurimit vetëm me shoqëritë e sigurimit të licencuara.
13. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo brokër pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa më shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.
14. Referuar sa më sipër, AMF në Republikën e Shqipërisë ka A licensuar 4 banka si broker në sigurime për klasat e jetës dhe 1 bankë si agjent në sigurime të kësaj kategorie. Bankat e licencuara si broker në sigurime për klasat e jetës janë: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Tirana Bank dhe OTP Bank. Si agjent për klasat e jetës është licencuar Credins Bank. Gjithashtu, ndërmarrja E-Business Solutions është licencuar si agjent në sigurime për klasat e jetës, ndërsa ABI Broker Sigurimesh është licencuar si broker në sigurimet e jetës dhe jo-jetës. Disa banka, edhe pse jo të licencuara, kanë lidhur marrëveshje me shoqëri sigurimi për klasat e jetës, duke marrë automatikisht rolin e ndërmjetësuesit.
15. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
16. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”², bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
17. Në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”³, neni 7, informacioni kontraktor që duhet të japin bankat për klientët duhet të përmbajë veç të tjerave edhe, “garancitë

² Miratuar me Vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

³ Miratuar me Vendimin nr. 48 datë 01.07.2015, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

e vendosura për të siguruar ekzekutimin e kontratës së kredisë, mënyrën e vënies së tyre në ekzekutim, dhe kontratat e sigurimit të jetës ose të pronës (kur janë të aplikueshme).

18. Mbi bazën e këtij detyrimi, klientët njihen në momentin e nënshkrimit të një kontrate kredie konsumatorë apo hipotekare me detyrimin e sigurimit të jetës, aty ku është e aplikueshme, për gjithë periudhën e mbajtjes së detyrimit. Nëpërmjet këtij detyrimi, banka sigurohet që në rast ndodhje të një ngjarjeje ndaj kredimarrësit, detyrimi i tij të mbulohet nga shoqëritë e sigurimit.
19. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës kur ka vlerësuar tregun përkatës ka marrë parasysh sjelljen e konsumatorit kredimarrës. Çfarë është më e rëndësishme për kredimarrësin, kredia (banka) apo kosto e sigurimit të jetës për kredi (primi)? Kredimarrësi kur zgjedh bankën ku do të marrë kredinë e zgjedh për arsye si: reputacioni i bankës, eksperiencia e mëparshme (llogari page apo kredi të mëparshme), norma e interesit, shpejtësia e miratimit dhe disbursimit, etj. Pra, para se të trajtohet primi i sigurimit të jetës për kredi, konsumatori e ka vendosur bankën ku do të marrë financimin.
20. Në raportin e CMA (Competition & Market Authority) të Mbretërisë së Bashkuar, “Market investigation into payment protection insurance”⁴ (paragrafi 5.89-5.91), **“pika e shitjes”** shpjegohet në mënyrë të përmblodhur: “... Avantazhi në pikën e shitjes është përfitimi që shpërndarësit gëzojnë nga fakti që kanë qasje të vetme tek klientët në momentin kur ata po marrin kredinë e tyre.”
21. Krahasimisht, vlerësohet se një situatë e ngjashme me atë të përshkruar në raportin e CMA ekziston edhe në rastin e kredive që kërkojnë sigurim jete, pasi vendimi i konsumatorit për t’u financuar nga një bankë e caktuar merret përpara zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit. Për rrjedhojë, banka gëzon një avantazh në “pikën e shitjes”, duke qenë se ka akses të privilegjuar ndaj klientit në momentin kur ai ndodhet në procesin e marrjes së kredisë.
22. Pavarësisht se banka, nëpërmjet informacionit para-kontraktor vë në dijeni kredimarrësin për nevojën e një sigurimi jete, vendimmarrja për shoqërinë e sigurimit, marrja e ofertave nga shoqëritë e ndryshme dhe krahasimi i primeve ndodh pas aprovimit të kredisë. Në këtë mënyrë banka siguron një akses të privilegjuar tek kredimarrësi, për të zgjedhur policën e sigurimit më të preferuar për bankën.
23. Për sa më sipër, tregu përkatës i produktit është: tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën UBA.

⁴ https://webarchive.nationalarchives.gov.uk/ukgwa/20140403003432mp_/http://www.competition-commission.org.uk/assets/competitioncommission/docs/pdf/non-inquiry/rep_pub/reports/2009/fulltext/542.pdf

24. Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse, produkti i sigurimit të jetës është i detyrueshëm të blihet në momentin që banka aprovon kredinë që klienti dëshiron të marrë, atëherë si treg gjeografik do të konsiderohet vetëm territori i bankës së nivelit të dytë që ka aprovuar atë kredi. Për këtë arsye, tregu gjeografik për bankën e Bashkuar të Shqipërisë do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Banka e Bashkuar e Shqipërisë.

III. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

25. Pjesët e tregut janë një tregues i rëndësishëm në lidhje me strukturën e tregut dhe rëndësinë e ndërmarrjeve të ndryshme në treg. Megjithatë, Autoriteti interpreton pjesët e tregut në këndvështrimin e kushteve të tregut përkatës dhe në veçanti të dinamikës së tregut dhe të diferencimit të produkteve. Tendenca ose zhvillimi i pjesëve të tregut me kalimin e kohës, mund të merret në konsideratë për tregjet e paqëndrueshme ose për tregjet ofertues.
26. Praktikant më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrjet zotërojnë një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës.⁵
27. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndërmarrja Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën e Bashkuar të Shqipërisë, ka pozitë dominuese.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes në tregun përkatës

28. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo broker pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa më shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.

⁵ Komunikim nga Komisioni Udhëzim mbi sjelljet përjashtuese, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 82 -Guidance on the Commission's enforcement priorities in applying Article 82 of the EC Treaty to abusive exclusionary conduct by dominant.

29. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
30. Neni 194 pika 1 e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” shprehet se, veprimtaria e agjentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari. Gjithashtu neni 198 pika 3 e po këtij ligji, shprehet se agjenti apo shoqëria e agjentëve në sigurime kryen vetëm ato veprimtari, për të cilat është miratuar apo licencuar.
31. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
32. Sipas nenit 102 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasja e një pozite dominuese në treg nuk është e ndaluar në vetvete. Megjithatë, kur një ndërmarrje me pozitë dominuese përdor fuqinë e saj për të kufizuar konkurrencën në mënyrë të padrejtë, ajo mund të përbëjë një abuzim, i cili është i ndaluar me ligj.
33. Neni 102 TFEU liston kategoritë tipike të sjelljeve abuzive, por këto sjellje abuzive klasifikohen zakonisht në dy kategori kryesore: Abuzime përjashtuese (exclusionary abuses) dhe Abuzime shfrytëzuese (exploitative abuses)⁶.
- Abuzime përjashtuese (Exclusionary abuse) i referohet sjelljeve të ndërmarrjeve me pozitë dominuese që synojnë të përjashtojnë konkurrentët nga tregu, ose të pengojnë hyrjen ose zhvillimin e tyre, jo thjesht të konkurrojnë lirshëm me to, por të kufizojnë konkurrencën në mënyrë aktive. Këto sjellje dëmtojnë strukturën konkurruese dhe, rrjedhimisht, edhe interesat afatgjata të konsumatorëve
 - Abuzime shfrytëzuese (Exploitative abuse) përfshin ato abuzime kur ndërmarrja me pozitë dominuese shfrytëzon pozicionin e saj për të përfituar në mënyrë të padrejtë, zakonisht përmes çmimeve të larta apo kushteve tregtare të padrejta, pa ndikuar drejtpërdrejt mbi konkurrentët.

⁶ <https://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=a940ed59-46d6-4932-a2cc-2fb52618f387>

34. Sipas nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit mbi zbatueshmërinë e neneve 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003, një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të abuzojë me këtë pozitë nëpërmjet shitjeve të lidhura (tying) ose kushtëzimeve të padrejta, kur klientit i kërkohet që, për të marrë një produkt (në këtë rast kredinë), të blejë një produkt tjetër (sigurimin e jetës) në kushte të përcaktuara nga vetë banka.
35. Vendimi i klientit për bankën ku do të marrë kredinë merret përpara se ai të shqyrtojë ofertat për sigurimin e jetës për kredi. Kjo do të thotë se banka kontrollon pikën e shitjes (momentin vendimtar të nënshkrimit të kontratës), pra zotëron një pozitë të dominuese ndaj klientit.
36. Procesi i zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit ndodh pas miratimit të kredisë, në ambientet e bankës, ku kredimarrësi është tashmë i varur nga vendimi i bankës për disbursimin e fondeve. Kjo situatë i jep bankës fuqi të njëanshme tregu, duke i mundësuar të “shtyjë” një produkt sigurimi të caktuar nga një shoqëri sigurimi.
37. Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në nenin 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka analizuar sjelljen e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë SHA (UBA) duke shqyrtuar nëse banka, duke e bërë sigurimin e jetës kusht për dhënien e kredive hipotekare dhe të kredive konsumatore mbi një vlerë të caktuar, si dhe duke pasur marrëveshje aktive vetëm me një shoqëri të vetme sigurimi jete, ka krijuar në praktikë një situatë ekskluziviteti në ofrimin e këtij produkti. Konkretisht, është analizuar nëse struktura kontraktore e bankës, ofrimi i sigurimit të jetës vetëm nëpërmjet një shoqërie të vetme dhe përqendrimi XXX% i policave pranë saj, mund të përbëjnë praktikë lidhëse (tying) ose formë tjetër të kufizimit të konkurrencës, duke reduktuar zgjedhjen efektive të kredimarrësve brenda këtij tregu përkatës.
38. Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA), nuk është e përfshirë nga AMF⁷ në listën zyrtare të agjentëve apo brokerave të sigurimit në faqen e saj zyrtare.
39. Kjo bankë shprehet se, sigurimi i jetës për klientët e saj është bërë i detyrueshëm si për kreditë hipotekare po ashtu edhe për ato konsumatore (për shumat mbi 150,000 lekë) duke filluar nga data 27 maj 2024. Përpara kësaj date kreditë merreshin pothuajse gjithmonë me bashkë kredimarrës. Sigurimi i jetës aplikohet vetëm në rastet kur kredimarrësi ishte i vetëm. Në momentin e aplikimit klientëve u paraqitet informacioni parakontrator, nëpërmjet të cilit informohen mbi kushtet e përgjithshme të financimit (kredisë) për të cilin ata po aplikojnë si dhe kostot e këtij financimi, përfshirë sigurimin e jetës.

⁷ https://amf.gov.al/ts_abs_banka_agjent.asp dhe https://amf.gov.al/ts_abs_banka_broker.asp.

40. UBA Bank SHA ka 2 (dy) kontrata aktive për ofrimin e sigurimit të jetës për financime konsumatore dhe hipotekare vetëm me shoqërinë Insig Jetë SHA dhe kjo e fundit zë XXX% të totalit të policave të prera.
41. UBA Bank SHA shprehet se, në momentin e aplikimit klientëve u paraqitet informacioni parakontraktor, nëpërmjet të cilit informohen mbi kushtet e përgjithshme të financimit (kredisë) për të cilin ata po aplikojnë si dhe kostot e këtij financimi, përfshirë sigurimin e jetës. Dega përcjell informacionin paraprakisht të “Insig Jetë” në rrugë elektronike. Klienti informohet për përzgjedhjen e kompanisë nga banka paraprakisht. Ky i fundit mund të përzgjedhë në një nga tre kompanitë e sigurimit të jetës.
42. Nga të dhënat për periudhën hetimore rezulton se të gjitha policat e sigurimit të jetës për kredi të prera gjatë periudhës hetimore janë pranë Insig Jetë SHA, duke përbërë XXX% të numrit total të policave të prera nga kredimarrësit në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë, si në lekë, ashtu edhe në euro.
43. Pavarësisht se Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA ka marrëveshje vetëm me shoqërinë Insig Jetë SHA dhe të gjitha policat e sigurimit të jetës për kredi të prera gjatë periudhës hetimore i përkasin kësaj shoqërie, nga analiza e të dhënave nuk rezultojnë prova të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë se banka ka abuzuar me pozitën e saj dominuese. Vlerësimi është që kredimarrësit duke qënë të interesuar për të marrë kredi pranë një banke që dihet që ka të njëjtët aksionerë me ndërmarrjen e sigurimit, vlerësojnë që shanset e tyre për sukses në marrjen e kredisë shtohen (pavarësisht se Banka nuk i orienton drejt kësaj sjelljeje e as është provuar një rast i tillë) nëse bëjnë sigurimin e jetës pranë shoqërisë Insig SHA. Në veçanti, nuk rezulton të jetë provuar se orientimi i klientëve ka qënë rezultat i një detyrimi *de facto* të imponuar nga banka, apo se efektet e konstatuara përbëjnë kufizim të provuar dhe të drejtpërdrejtë të konkurrencës në shkallë të tillë sa të konsiderohet shkelje e nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003. Ajo që evidentohet qartë, është nevoja për një rregullim më të mirë procedural, më të saktë dhe më transparent në lidhje me mënyrën sesi bëhet përzgjedhja e shoqërisë së sigurimit nga kredimarrësi duke limituar në maksimum hapësirat për sjellje antikonkurrese.
44. Sa më sipër, me gjithë ekzistencën e dyshimeve, nuk ka prova të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë që në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën UBA të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 26, nenin 43, pika 5 dhe nenin 45, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankës së Bashkuar të Shqipërisë SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë SHA.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA që brenda 3 muajve, të shfuqizojë marrëveshjet e sigurimit të jetës me shoqërinë e sigurimit Insig Jetë SHA, për aq kohë sa banka nuk është e licencuar si broker ose agjent në sigurime si dhe të ndërmarrë çdo veprim të nevojshëm për rregullimin e kësaj situate, në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe Bankën e Shqipërisë.
- III. Detyrimin e ndërmarrjes Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA që brenda 30 ditëve, në kuadër të informacionit parakontraktor të dorëzuar çdo kredimarrësi, të përfshijë një njoftim të qartë, të shkruar dhe të plotë mbi përpunimin e të dhënave personale për qëllimet e vlerësimit dhe verifikimit të sjelljes së bankës në treg, përfshirë dhe aksesin dhe përpunimin e të dhënave nga Autoriteti i Konkurrencës, në rast monitorimi, hetimi paraprak apo hetimi të thelluar ndaj bankës.
- IV. Detyrimin e ndërmarrjes Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA të raportojë në çdo kohë që do kërkohej, pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi mënyrën e zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi duke paraqitur çdo dokument që konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti i Konkurrencës për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi.
- V. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.
- VI. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për një periudhë 1 vjeçare.
- VII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr.1262, Datë 20.02.2026

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES UNION BANK SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË BANKËN UNION DHE NDAJ NDËRMARRJES E-BUSINESS SOLUTIONS SHPK NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË BANKËN UNION, KU NDËRMJETËSIMIN E USHTRON NDËRMARRJA E-BUSINESS SOLUTIONS SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar dhe dhënia e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Union Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Union dhe ndaj ndërmarrjes E-Business Solutions SHPK në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Union, ku ndërmjetësimin e ushtron ndërmarrja E-Business Solutions SHPK.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 26, neni 43, pika 5 dhe neni 45 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.;

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.”;

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur

1. Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të një ankese të depozituar më datë 30 korrik 2024, mbi dyshimin për pengim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në tregun e sigurimit të jetës për kredi, në zbatim të nenit 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, aktivizoi procedurën e monitorimit të këtij tregu.
2. Bankat⁸ janë institucione financiare, që ushtrojnë veprimtarinë bankare të pranimi të depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimin e tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të tyre si dhe veprimtari të tjera të natyrës financiare, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Aktualisht në Shqipëri operojnë 11 banka tregtare, me kapital të huaj dhe vendas.
3. Sigurimi i Jetës për Kredi është një produkt që u ofrohet individëve kredimarrës, duke shërbyer ndër të tjera edhe si garanci për bankën, por dhe për kredimarrësin, i cili mbrohet si person i siguruar.
4. Nga analiza e informacionit të mbledhur gjatë fazës së monitorimit u konstatua se, pavarësisht shpjegimeve të dërguara me shkresë nga bankat, përqindjet e tregut total të sigurimit të jetës, të raportuara nga AMF për vitin 2023, nuk reflektohen në ndarjen e portofolit të sigurimit të jetës për kredi, që shitet përmes bankave. Kjo mospërputhje e dukshme ngriti shqetësime mbi funksionimin e konkurrencës në këtë segment të tregut.
5. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1130, datë 07.11.2024, vendosi hapjen e procedurës

⁸ https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Subjekte_te_licencuara/Banka/

së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi për periudhën nga 7 nëntor 2021 deri në 7 nëntor 2024, vendim në të cilin përfshiu edhe ndërmarrjet Union Bank SHA dhe E-Business Solutions SHPK. Afati i përfundimit të hetimit paraprak, më pas, me Vendimin nr. 1159, datë 13.02.2025 u zgjat deri në 3 mars 2025.

6. Pas përfundimit të hetimit paraprak, u konkludua ndër të tjera se, sjellja e ndërmarrjeve Union Bank SHA dhe E-Business Solutions SHPK mund të përbënte shkelje të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe me Vendimin nr. 1171, datë 26.03.2025 Komisioni i Konkurrencës i hapi rrugë procedurës së hetimit të thelluar në përputhje me parashikimet ligjore për periudhën 7 nëntor 2021 – 26 Mars 2025. Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të hetimit.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

7. Sigurimi është një formë e manaxhimit të riskut që vjen nga një situatë e panjohur, një kontratë në bazë të së cilës një person/kompani, transferon rrezikun e mundshëm të një dëmi/humbje financiare tek një kompani sigurimi, përkundrejt pagesës së një shume që quhet prim sigurimi.
8. Sigurimi i Jetës për Kredi ofrohet për personat që marrin kredi në bankë dhe i mbron ata dhe familjarët nga rreziku i mos shlyerjes së hua-së si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit. Ky sigurim është një garanci financiare si për bankën (nga rreziku i mos shlyerjes së huasë si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit) ashtu edhe për kredimarrësin, personin e siguruar, duke çliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur.
9. Tregu i sigurimeve të jetës në Republikën e Shqipërisë funksionon në zbatim të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.
10. Ligji nr. 52/2014 parashikon si lloje të ndërmjetësimit, veprimtarinë e agjentit dhe brokerit, duke përcaktuar se edhe bankat e nivelit të dytë mund të pajisen me licencë për të ushtruar këtë veprimtari. Konkretisht, neni 194, pika 4 parashikon se “Veprimtaria e agjentit mund të kryhet edhe nga bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, si dhe subjekte të tjera, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti” ndërsa neni 204 pika 5 parashikon se “Veprimtaria e brokerimit mund të kryhet

edhe nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti”.

11. Në bazë të nenit 194 të Ligjit nr. 52/2014, veprimtaria e agentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari. Veprimtaria e agentit në sigurime mund të kryhet edhe në emër të disa shoqërive të sigurimit, nëse shoqëritë e sigurimit kanë rënë dakord me marrëveshje të shkruar midis tyre.
12. Lidhur me veprimtarinë e brokerimit, në bazë të nenit 202 të Ligjit nr. 52/2014, përfshin të gjitha ato veprimtari, si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij. Gjithashtu, përfshin edhe asistencën për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, veçanërisht zgjidhjen e kërkesave për dëmshpërblim nga shoqëria e sigurimit, në emër dhe për llogari të konsumatorit. Brokëri/shoqëria e brokerimit ndërmjetëson për lidhjen e kontratave të sigurimit vetëm me shoqëritë e sigurimit të licencuara.
13. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agentë apo brokër pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa më shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.
14. Referuar sa më sipër, AMF në Republikën e Shqipërisë ka A licensuar 4 banka si broker në sigurime për klasat e jetës dhe 1 bankë si agent në sigurime të kësaj kategorie. Bankat e licencuara si broker në sigurime për klasat e jetës janë: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Tirana Bank dhe OTP Bank. Si agent për klasat e jetës është licensuar Credins Bank. Gjithashtu, ndërmarrja E-Business Solutions është licensuar si agent në sigurime për klasat e jetës, ndërsa ABI Broker Sigurimesh është licensuar si broker në sigurimet e jetës dhe jo-jetës. Disa banka, edhe pse jo të licencuara, kanë lidhur marrëveshje me shoqëri sigurimi për klasat e jetës, duke marrë automatikisht rolin e ndërmjetësuesit.
15. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.

16. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”⁹, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
17. Në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”¹⁰, neni 7, informacioni kontraktor që duhet të japin bankat për klientët duhet të përmbajë veç të tjerave edhe, “garancitë e vendosura për të siguruar ekzekutimin e kontratës së kredisë, mënyrën e vënies së tyre në ekzekutim, dhe kontratat e sigurimit të jetës ose të pronës (kur janë të aplikueshme).
18. Mbi bazën e këtij detyrimi, klientët njihen në momentin e nënshkrimit të një kontrate kredie konsumatore apo hipotekare me detyrimin e sigurimit të jetës, aty ku është e aplikueshme, për gjithë periudhën e mbajtjes së detyrimit. Nëpërmjet këtij detyrimi, banka sigurohet që në rast ndodhje të një ngjarjeje ndaj kredimarrësit, detyrimi i tij të mbulohet nga shoqëritë e sigurimit.
19. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës kur ka vlerësuar tregun përkatës ka marrë parasysh sjelljen e konsumatorit kredimarrës. Çfarë është më e rëndësishme për kredimarrësin, kredia (banka) apo kosto e sigurimit të jetës për kredi (primi)? Kredimarrësi kur zgjedh bankën ku do të marrë kredinë e zgjedh për arsye si: reputacioni i bankës, eksperiencia e mëparshme (llogari page apo kredi të mëparshme), norma e interesit, shpejtësia e miratimit dhe disbursimit, etj. Pra, para se të trajtohet primi i sigurimit të jetës për kredi, konsumatori e ka vendosur bankën ku do të marrë financimin. Nga sa më lart, primi është më shumë një kosto sekondare se sa një faktor vendimmarrës në vendimmarrjen për kredi.
20. Në raportin e CMA (Competition & Market Authority) të Mbretërisë së Bashkuar, “Market investigation into payment protection insurance”¹¹ (paragrafi 5.89-5.91), “**pika e shitjes**” shpjegohet në mënyrë të përmbledhur: “... Avantazhi në pikën e shitjes është përfitimi që shpërndarësit gëzojnë nga fakti që kanë qasje të vetme tek klientët në momentin kur ata po marrin kredinë e tyre.”
21. Krahësimisht, vlerësohet se një situatë e ngjashme me atë të përshkruar në raportin e CMA ekziston edhe në rastin e kredive që kërkojnë sigurim jete, pasi vendimi i konsumatorit për t’u financuar nga një bankë e caktuar merret përpara zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit. Për rrjedhojë, banka gëzon një avantazh në “pikën e shitjes”, duke qenë se ka akses të privilegjuar ndaj klientit në momentin kur ai ndodhet në procesin e marrjes së kredisë.

⁹ Miratuar me Vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

¹⁰ Miratuar me Vendimin nr. 48 datë 01.07.2015, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

¹¹ https://webarchive.nationalarchives.gov.uk/ukgwa/20140403003432mp_/http://www.competition-commission.org.uk/assets/competitioncommission/docs/pdf/non-inquiry/rep_pub/reports/2009/fulltext/542.pdf

22. Pavarësisht se banka, nëpërmjet informacionit para-kontraktor vë në dijeni kredimarrësin për nevojën e një sigurimi jete, vendimmarrja për shoqërinë e sigurimit, marrja e ofertave nga shoqëritë e ndryshme dhe krahasimi i primeve ndodh pas aprovimit të kredisë. Në këtë mënyrë banka siguron një akses të privilegjuar tek kredimarrësi, për të zgjedhur policën e sigurimit më të preferuar për bankën.
23. Për sa më sipër, tregu përkatës i produktit është:
- i. tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Union;
 - ii. tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Union, ku ndërmjetësimin e ushtron ndërmarrja E-Business Solutions SHPK.
24. Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse, produkti i sigurimit të jetës është i detyrueshëm të blihet në momentin që banka aprovon kredinë që klienti dëshiron të marrë, atëherë si treg gjeografik do të konsiderohet vetëm territori i bankës së nivelit të dytë që ka aprovuar atë kredi. Për këtë arsye tregu gjeografik:
- i. për bankën Union do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Union Bank;
 - ii. për ndërmarrjen E-Business Solutions do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Union Bank.

III. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

25. Pjesët e tregut janë një tregues i rëndësishëm në lidhje me strukturën e tregut dhe rëndësinë e ndërmarrjeve të ndryshme në treg. Megjithatë, Autoriteti interpreton pjesët e tregut në këndvështrimin e kushteve të tregut përkatës dhe në veçanti të dinamikës së tregut dhe të diferencimit të produkteve. Tendenca ose zhvillimi i pjesëve të tregut me kalimin e kohës, mund të merret në konsideratë për tregjet e paqëndrueshme ose për tregjet ofertues.
26. Praktikrat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrjet zotërojnë një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës.¹²
27. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe

¹² Komunikim nga Komisioni Udhëzim mbi sjelljet përjashtuese, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 82 -Guidance on the Commission's enforcement priorities in applying Article 82 of the EC Treaty to abusive exclusionary conduct by dominant.

nenit 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” ndërmarrja:

- i. Union Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Union Bank, ka pozitë dominuese;
- ii. E-Business Solutions SHPK, në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Union, ka pozitë dominuese.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

28. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo broker pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa me shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.
29. Neni 194 pika 1 e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” shprehet se, veprimtaria e agjentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari. Gjithashtu neni 198 pika 3 e po këtij ligji, shprehet se agjenti apo shoqëria e agjentëve në sigurime kryen vetëm ato veprimtari, për të cilat është miratuar apo licencuar.
30. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
31. Sipas nenit 102 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasja e një pozite dominuese në treg nuk është e ndaluar në vetvete. Megjithatë, kur një ndërmarrje me pozitë dominuese përdor fuqinë e saj për të kufizuar konkurrencën në mënyrë të padrejtë, ajo mund të përbëjë një abuzim, i cili është i ndaluar me ligj.
32. Neni 102 TFEU liston kategoritë tipike të sjelljeve abuzive, por këto sjellje abuzive klasifikohen zakonisht në dy kategori kryesore: Abuzime përjashtuese (exclusionary abuses) dhe Abuzime shfrytëzuese (exploitative abuses)¹³.

¹³ <https://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=a940ed59-46d6-4932-a2cc-2fb52618f387>

- Abuzime përjashtuese (Exclusionary abuse) i referohet sjelljeve të ndërmarrjeve me pozitë dominuese që synojnë të përjashtojnë konkurrentët nga tregu, ose të pengojnë hyrjen ose zhvillimin e tyre, jo thjesht të konkurrojnë lirshëm me to, por të kufizojnë konkurrencën në mënyrë aktive. Këto sjellje dëmtojnë strukturën konkurruese dhe, rrjedhimisht, edhe interesat afatgjata të konsumatorëve
- Abuzime shfrytëzuese (Exploitative abuse) përfshin ato abuzime kur ndërmarrja me pozitë dominuese shfrytëzon pozicionin e saj për të përfituar në mënyrë të padrejtë, zakonisht përmes çmimeve të larta apo kushteve tregtare të padrejta, pa ndikuar drejtpërdrejt mbi konkurrentët.

33. Sipas nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit mbi zbatueshmërinë e neneve 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003, një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të abuzojë me këtë pozitë nëpërmjet shitjeve të lidhura (tying) ose kushtëzimeve të padrejta, kur klientit i kërkohet që, për të marrë një produkt (në këtë rast kredinë), të blejë një produkt tjetër (sigurimin e jetës) në kushte të përcaktuara nga vetë banka.
34. Vendimi i klientit për bankën ku do të marrë kredinë merret përpara se ai të shqyrtojë ofertat për sigurimin e jetës për kredi. Kjo do të thotë se banka kontrollon pikën e shitjes (momentin vendimtar të nënshkrimit të kontratës), pra zotëron një pozitë të dominuese ndaj klientit.
35. Procesi i zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit ndodh pas miratimit të kredisë, në ambientet e bankës, ku kredimarrësi është tashmë i varur nga vendimi i bankës për disbursimin e fondeve. Kjo situatë i jep bankës fuqi të njëanshme tregu, duke i mundësuar të “shtyjë” një produkt sigurimi të caktuar nga një shoqëri sigurimi.
36. Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në nenin 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka analizuar sjelljen e Union Bank SHA dhe të ndërmarrjes E-Business Solutions SHPK duke shqyrtuar nëse, përmes strukturës së marrëdhënies Bankë–Agjent–Shoqëri Sigurimi dhe rolit të secilës palë në procesin e sigurimit të jetës për kredi, këto ndërmarrje kanë përdorur pozitën e bankës në procesin e kreditimit për të ndikuar, orientuar apo kufizuar zgjedhjen e kredimarrësve në përzgjedhjen e shoqërisë së sigurimit të jetës. Konkretisht, është analizuar nëse, pavarësisht ekzistencës së marrëveshjeve trepalëshe me disa shoqëri sigurimi jete, mënyra e organizimit dhe administrimit të procesit të sigurimit, komunikimi me klientin dhe mekanizmi i ndërmjetësimit i ushtruar nga E-Business Solutions SHPK, mund të kenë krijuar një orientim de facto të kërkesës drejt një ose disa shoqërive të caktuara sigurimi, duke rezultuar në përqendrim të lartë të policave pranë tyre dhe në kufizim të mundshëm të konkurrencës brenda këtij tregu përkatës.
37. Union Bank SHA nuk është e përfshirë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në listën zyrtare të agjentëve apo brokerave të sigurimit të jetës në faqen e saj zyrtare.

38. Banka bashkëvepron me klientin, agjentin/ndërmjetësin në sigurime për të lehtësuar procesin e përzgjedhjes së kompanisë së sigurimit të jetës. Ajo ka nënshkruar marrëveshje tre-palëshe me ndërmjetësit në sigurime/shoqëritë e sigurimit, marrëveshje që kanë objekt rregullimin e procesit të sigurimit dhe pajisjes së klientit me policë. Si në çdo marrëdhënie kontraktore, palët përcaktojnë lirisht kushtet e kontratave/marrëdhënies, duke përfshirë këtu dhe kushtet e sigurimit të jetës. Në çdo rast kushti i vetëm i Bankës për pranimin e policës së sigurimit në kuadër të procesit të kreditimit, është që kjo e fundit të jetë përfituese e shumës së pagueshme si rezultat i dëmit që mund të pësojë i siguruari.
39. Banka nuk ka kontrata të drejtpërdrejta me Shoqëritë e Sigurimit, por operon në bazë të Marrëveshjeve Trepalëshe të nënshkruara ndërmjet Bankës, Shoqërive të Sigurimit dhe Agjentit E-Business Solutions SHPK.
40. Për efekt të lehtësimit të procesit të sigurimit në kuadër të kreditimit, stafi që menaxhon marrëdhënien me klientin, referon këtë të fundit tek subjekti i përzgjedhur si agjent në sigurime. Nga agjenti në sigurime, klientit i jepet informacion mbi shoqëritë e sigurimit që ofrojnë shërbimin e sigurimit të jetës, kushtet që ofron secili operator i kësaj fushe në treg, përfitimet dhe kostot e policave të disponueshme, duke i lënë klientit lirinë për të përzgjedhur/refuzuar lidhjen e kontratës së sigurimit të jetës (policës) nëpërmjet agjentit apo duke kontaktuar vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë me shoqëritë e sigurimit.
41. Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit, në formë shkresore, rezultoi se Union Bank SHA nuk ka kontrata të drejtpërdrejta me Albsig Jetë SHA, Sigal Life SHA dhe Insig Jetë SHA, por operon në bazë të Marrëveshjeve Trepalëshe të nënshkruara ndërmjet Bankës, Shoqërive të Sigurimit dhe Agjentit.
42. Ndërmarrja E-Business Solutions SHPK në vitin 2020, në përputhje me Ligjin nr. 52/2014, "Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit" shton në aktivitetin e saj edhe ndërmjetësimin në sigurime duke u licensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me licencën nr. 1500, datë 31.08.2020 si agjent në sigurime (kategoria subjekte të tjera agjent në sigurime) në klasën Jetë për llogari të kompanisë Insig Jetë.
43. Ndërmarrja E-Business Solutions SHPK në vitin 2021, shton licencën e saj duke u aprovuar nga AMF si agjent edhe për kompaninë Albsig Jetë me licencën nr. 1586, datë 28.04.2021.
44. Si dhe në vitin 2024 ndërmarrja E-Business Solutions SHPK lidh marrëveshje edhe me dy shoqëri të tjera, Sigal Life dhe Sicred për të cilat licencohet gjithashtu me AMF me licencën nr. 2128, datë 30.10.2024 duke e çuar numrin e kompanive për të cilat vepron si agjent në katër të

tilla, praktikisht me të gjitha kompanitë e Sigurimit të Jetës që operojnë në vend.

45. Marrëdhënia me Union Bank dhe E-Business Solutions SHPK për ndërmjetësimin në lëshimin e policave jetë debitori, rregullohet nëpërmjet kontratave 3 palëshe Bankë – Agjent – Kompani Sigurimi. Këto kontrata 3 palëshe janë lidhur me të 4 (katër) shoqëritë e lartpërmendura, përkatësisht:
- Kontrata E-Business Solutions SHPK – Union Bank SHA – Albsig Jetë SHA;
 - Kontrata E-Business Solutions SHPK – Union Bank SHA – Sigal Life Uniq Group Austria SHA;
 - Kontrata E-Business Solutions SHPK – Union Bank SHA – Insig Jetë SHA;
 - Kontrata E-Business Solutions SHPK – Union Bank SHA – Sicred SHA.
46. Gjatë periudhës hetimore, rezulton se klientët kredimarrës pranë bankës Union kanë prerë policat e sigurimit të jetës si në vijim: Albsig Jetë me XXX%, ndjekur nga Insig Jetë me XXX%, Sigal Life me XXX% dhe së fundmi Sicred me vetëm XXX%. Si dhe volumi më i madh i komisioneve të përftuara vjen nga bashkëpunimi që kryhet me shoqërinë Albsig, me XXX% të totalit të rakordimeve, XXX% në lekë dhe XXX% në euro.
47. Në acquis të BE-se, koncepti i “grupim të ndërmarrjeve” është i unifikuar dhe shfaqet si në vijim:
- Preambula 37 e Rregullores (BE) 2016/679 (GDPR): *“Një grupim ndërmarrjesh duhet të përfshijë një ndërmarrje kontrolluese dhe ndërmarrjet e kontrolluara prej saj, ku ndërmarrja kontrolluese duhet të jetë ajo ndërmarrje që mund të ushtrojë ndikim dominues mbi ndërmarrjet e tjera përmes, për shembull, pronësisë, pjesëmarrjes financiare, rregullave që e rregullojnë atë, ose fuqisë për t’i zbatuar...”*.
 - Doktrina e “Njësisë Ekonomike të Vetme” (Single Economic Entity) është e njohur gjerësisht në të drejtën e konkurrencës evropiane, dhe gjen zbatim dhe në arsyetimet e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED), lidhur me shkelje të rregullave të konkurrencës:
- i. Në *Akzo Nobel NV v Commission (C-97/08 P)*, Gjykata u shpreh se pranohet që një kompani mëmë dhe një kompani e kontrolluar plotësisht mund të trajtohen si një “njësi ekonomike e vetme” kur mëma ushtron ndikim vendimtar mbi bijën. Kjo qasje lejon që të dyja entitetet të trajtohen bashkërisht në kuptim të ligjit të konkurrencës, pa kërkuar prova të kontrollit të drejtpërdrejtë, duke supozuar se pronësia e plotë e nënkupton këtë ndikim. (para 58-61).
- ii. Në *Sumal SL v Mercedes Benz Trucks España (C-882/19)*, Gjykata vendosi se përgjegjësia për shkelje të konkurrencës mund të shtrihet brenda grupit, pavarësisht se janë juridikisht të ndara, nëse veprojnë me një qëllim të përbashkët ekonomik në treg. (para 4-44).
48. Union Bank SHA dhe E-Business Solutions SHPK lidhen përmes zotërimit të kuotave nga z. Niko Leka, i cili ka 36.77% në Union Bank SHA dhe 42.5% në E-Business Solutions SHPK,

duke siguruar kështu ndikim të përbashkët dhe kontroll potencial mbi veprimtarinë e tyre. Kjo lidhje krijon kushtet për t'i konsideruar këto dy shoqëri si pjesë të së njëjtës njësi ekonomike në kuptim të konkurrencës

49. Të dhënat tregojnë përqendrim të lartë të policave në dy shoqëri sigurimi dhe rrethana që ngrejnë dyshime mbi ndikimin e bankës dhe agentit në zgjedhjen e klientëve dhe në konkurrencën ndërmjet shoqërive të sigurimit. Megjithatë, duke marrë parasysh natyrën e marrëveshjeve trepalëshe midis bankës, shoqërive të sigurimit dhe E-Business Solutions SHPK, faktin që banka nuk është e licencuar si agent apo broker, provat e administruara nuk janë të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë të shkeljes së nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Në veçanti, nuk rezulton të jetë provuar se orientimi i klientëve ka qenë rezultat i një detyrimi de facto të imponuar nga banka, apo se efektet e konstatuara përbëjnë kufizim të provuar dhe të drejtpërdrejtë të konkurrencës në shkallë të tillë sa të konsiderohet shkelje e nenit 9 të Ligjit nr.9121/2003. Ajo që evidentohet qartë, është nevoja për një rregullim më të mirë procedural, eliminimi i ofertave financiare në mënyrë verbale nëpërmjet dokumentimit me shkrim dhe ruajtja e tyre në dosjen e kredisë duke bërë procesin sa më të saktë dhe më transparent në lidhje me mënyrën sesi bëhet përzgjedhja e shoqërisë së sigurimit nga kredi marrësi duke limituar në maksimum hapësirat për sjellje antikonkurrese.
50. Në përfundim, me gjithë ekzistencën e dyshimeve, për sa i përket Union Bank SHA, nëpërmjet aktivitetit të E-Business Solutions SHPK, mes të ciliave ka pronësi aksionare të përbashkët, nuk ka prova të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë që në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Union, të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.
51. Në përfundim sjellja e ndërmarrjes E-Business Solutions SHPK në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Union nuk përbën abuzim me pozitën dominuese në bazë të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 26, nenin 43, pika 5 dhe nenin 45, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Union Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Union.

- II. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes E-Business Solutions SHPK në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Union, ku ndërmjetësimin e ushtron ndërmarrja E-Business Solutions SHPK.
- III. Detyrimin e ndërmarrjeve Union Bank SHA dhe E-Business Solutions SHPK që brenda 60 ditëve, të hartojë dhe zbatojë, për çdo kredimarrës një formular të vetëm, në të cilin të pasqyrohen ofertat e të gjitha shoqërive të sigurimit, sipas propozimit të primit nga secila shoqëri sigurimi; formulari në fjalë duhet të ketë në faqen e parë, me shkrim të dukshëm, pa numër rendor emrin e secilës shoqëri sigurimi jete dhe në vijim të emrit, vlerën e primit sipas koeficienteve përkatës dhe përzgjedhjen e kredimarrësit. Ky formular duhet të nënshkruhet nga të dy palët, banka dhe kredimarrësi, dhe të ruhet si pjesë përbërëse e dosjes së kredisë e aksesueshme në çdo moment nga Autoriteti i Konkurrencës.
- IV. Detyrimin e ndërmarrjes Union Bank SHA që brenda 30 ditëve, në kuadër të informacionit parakontraktor të dorëzuar çdo kredimarrësi, të përfshijë një njoftim të qartë, të shkruar dhe të plotë mbi përpunimin e të dhënave personale për qëllimet e vlerësimit dhe verifikimit të sjelljes së bankës në treg, përfshirë dhe aksesin dhe përpunimin e të dhënave nga Autoriteti i Konkurrencës, në rast monitorimi, hetimi paraprak apo hetimi të thelluar ndaj bankës.
- V. Detyrimin e ndërmarrjeve Union Bank SHA dhe E-Business Solutions SHPK të raportojë në çdo kohë që do kërkohej, pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi mënyrën e zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi duke paraqitur çdo dokument që konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti i Konkurrencës për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi.
- VI. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrjet Union Bank SHA dhe E-Business Solutions SHPK, në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohen me penalitetin përkatës.
- VII. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për një periudhë 1 vjeçare.
- VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1263, Datë 20.02.2026

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES BANKA E PARË E INVESTIMEVE SHA NË TREGUN E KREDIDHËNIES ME SIGURIM E JETE PËR KREDITË QË JEPEN BRENDË BANKËS BANKA E PARË E INVESTIMEVE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar dhe dhënia e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Banka e Parë e Investimeve SHA në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Banka e Parë e Investimeve.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 26, dhe neni 43, pika 5 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

Raportit të hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.;

Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e

jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.”;

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të një ankese të depozituar më datë 30 korrik 2024, mbi dyshimin për pengim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në tregun e sigurimit të jetës për kredi, në zbatim të nenit 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, aktivizoi procedurën e monitorimit të këtij tregu.
2. Bankat¹⁴ janë institucione financiare, që ushtrojnë veprimtarinë bankare të pranimit të depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimin e tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të tyre si dhe veprimtari të tjera të natyrës financiare, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Aktualisht në Shqipëri operojnë 11 banka tregtare, me kapital të huaj dhe vendas.
3. Sigurimi i Jetës për Kredi është një produkt që u ofrohet individëve kredimarrës, duke shërbyer ndër të tjera edhe si garanci për bankën, por dhe për kredimarrësin, i cili mbrohet si person i siguruar.
4. Nga analiza e informacionit të mbledhur gjatë fazës së monitorimit u konstatua se, pavarësisht shpjegimeve të dërguara me shkresë nga bankat, përqindjet e tregut total të sigurimit të jetës, të raportuara nga AMF për vitin 2023, nuk reflektohen në ndarjen e portofolit të sigurimit të jetës për kredi, që shitet përmes bankave. Kjo mospërputhje e dukshme ngriti shqetësime mbi funksionimin e konkurrencës në këtë segment të tregut.
5. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1130, datë 07.11.2024, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi për periudhën nga 7 nëntor 2021 deri në 7 nëntor 2024, vendim në të cilin përfshiu edhe ndërmarrjen Bankës së Parë të Investimeve SHA. Afati i përfundimit të hetimit paraprak, më pas, me Vendimin nr. 1159, datë 13.02.2025 u zgjat deri në 3 mars 2025.
6. Pas përfundimit të hetimit paraprak, u konkludua ndër të tjera se, sjellja e ndërmarrjes Bankës së Parë të Investimeve SHA mund të përbënte shkelje të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe me Vendimin nr. 1171, datë 26.03.2025 Komisioni i Konkurrencës

¹⁴ https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Subjekte_te_licencuara/Banka/

i hapi rrugë procedurës së hetimit të thelluar në përputhje me parashikimet ligjore për periudhën 7 nëntor 2021 – 26 Mars 2025. Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të hetimit.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

7. Sigurimi është një formë e manaxhimit të riskut që vjen nga një situatë e panjohur, një kontratë në bazë të së cilës një person/kompani, transferon rrezikun e mundshëm të një dëmi/humbje financiare tek një kompani sigurimi, përkundrejt pagesës së një shume që quhet prim sigurimi.
8. Sigurimi i Jetës për Kredi ofrohet për personat që marrin kredi në bankë dhe i mbron ata dhe familjarët nga rreziku i mos shlyerjes së hua-së si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit. Ky sigurim është një garanci financiare si për bankën (nga rreziku i mos shlyerjes së huasë si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit) ashtu edhe për kredimarrësin, personin e siguruar, duke çliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur.
9. Tregu i sigurimeve të jetës në Republikën e Shqipërisë funksionon në zbatim të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.
10. Ligji nr. 52/2014 parashikon si lloje të ndërmjetësimit, veprimtarinë e agentit dhe brokerit, duke përcaktuar se edhe bankat e nivelit të dytë mund të pajisen me licencë për të ushtruar këtë veprimtari. Konkretisht, neni 194, pika 4 parashikon se “Veprimtaria e agentit mund të kryhet edhe nga bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, si dhe subjekte të tjera, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti” ndërsa neni 204 pika 5 parashikon se “Veprimtaria e brokerimit mund të kryhet edhe nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti”.
11. Në bazë të nenit 194 të Ligjit nr. 52/2014, veprimtaria e agentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari. Veprimtaria e agentit në sigurime mund të kryhet edhe në emër të disa shoqërive të sigurimit, nëse shoqëritë e sigurimit kanë rënë dakord me marrëveshje të shkruar midis tyre.

12. Lidhur me veprimtarinë e brokerimit, në bazë të nenit 202 të Ligjit nr. 52/2014, përfshin të gjitha ato veprimtari, si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij. Gjithashtu, përfshin edhe asistencën për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, veçanërisht zgjidhjen e kërkesave për dëmshpërblim nga shoqëria e sigurimit, në emër dhe për llogari të konsumatorit. Brokëri/shoqëria e brokerimit ndërmjetëson për lidhjen e kontratave të sigurimit vetëm me shoqëritë e sigurimit të licencuara.
13. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo brokër pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa me shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.
14. Referuar sa më sipër, AMF në Republikën e Shqipërisë ka A licensuar 4 banka si broker në sigurime për klasat e jetës dhe 1 bankë si agjent në sigurime të kësaj kategorie. Bankat e licencuara si broker në sigurime për klasat e jetës janë: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Tirana Bank dhe OTP Bank. Si agjent për klasat e jetës është licencuar Credins Bank. Gjithashtu, ndërmarrja E-Business Solutions është licencuar si agjent në sigurime për klasat e jetës, ndërsa ABI Broker Sigurimesh është licencuar si broker në sigurimet e jetës dhe jo-jetës. Disa banka, edhe pse jo të licencuara, kanë lidhur marrëveshje me shoqëri sigurimi për klasat e jetës, duke marrë automatikisht rolin e ndërmjetësuesit.
15. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
16. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”¹⁵, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
17. Në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”¹⁶, neni 7, informacioni kontraktor që duhet të japin bankat për klientët duhet të përmbajë veç të tjerave edhe, “garancitë

¹⁵ Miratuar me Vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

¹⁶ Miratuar me Vendimin nr. 48 datë 01.07.2015, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

e vendosura për të siguruar ekzekutimin e kontratës së kredisë, mënyrën e vënies së tyre në ekzekutim, dhe kontratat e sigurimit të jetës ose të pronës (kur janë të aplikueshme).

18. Mbi bazën e këtij detyrimi, klientët njihen në momentin e nënshkrimit të një kontrate kredie konsumatorë apo hipotekare me detyrimin e sigurimit të jetës, aty ku është e aplikueshme, për gjithë periudhën e mbajtjes së detyrimit. Nëpërmjet këtij detyrimi, banka sigurohet që në rast ndodhje të një ngjarjeje ndaj kredimarrësit, detyrimi i tij të mbulohet nga shoqëritë e sigurimit.
19. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës kur ka vlerësuar tregun përkatës ka marrë parasysh sjelljen e konsumatorit kredimarrës. Çfarë është më e rëndësishme për kredimarrësin, kredia (banka) apo kosto e sigurimit të jetës për kredi (primi)? Kredimarrësi kur zgjedh bankën ku do të marrë kredinë e zgjedh për arsye si: reputacioni i bankës, eksperiencia e mëparshme (llogari page apo kredi të mëparshme), norma e interesit, shpejtësia e miratimit dhe disbursimit, etj. Pra, para se të trajtohet primi i sigurimit të jetës për kredi, konsumatori e ka vendosur bankën ku do të marrë financimin. Nga sa më lart, primi është më shumë një kosto sekondare se sa një faktor vendimmarrës në vendimmarrjen për kredi.
20. Në raportin e CMA (Competition & Market Authority) të Mbretërisë së Bashkuar, Market investigation into payment protection insurance¹⁷ (paragrafi 5.89-5.91), pika e shitjes shpjegohet në mënyrë të përmbledhur si: “... Avantazhi në pikën e shitjes është përfitimi që shpërndarësit gëzojnë nga fakti që kanë qasje të vetme tek klientët në momentin kur ata po marrin kredinë e tyre.”
21. Në raportin e CMA (Competition & Market Authority) të Mbretërisë së Bashkuar, “Market investigation into payment protection insurance”¹⁸ (paragrafi 5.89-5.91), **“pika e shitjes”** shpjegohet në mënyrë të përmbledhur: “... Avantazhi në pikën e shitjes është përfitimi që shpërndarësit gëzojnë nga fakti që kanë qasje të vetme tek klientët në momentin kur ata po marrin kredinë e tyre.”
22. Krahësimisht, vlerësohet se një situatë e ngjashme me atë të përshkruar në raportin e CMA ekziston edhe në rastin e kredive që kërkojnë sigurim jete, pasi vendimi i konsumatorit për t’u financuar nga një bankë e caktuar merret përpara zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit. Për rrjedhojë, banka gëzon një avantazh në “pikën e shitjes”, duke qenë se ka akses të privilegjuar ndaj klientit në momentin kur ai ndodhet në procesin e marrjes së kredisë.

¹⁷ https://webarchive.nationalarchives.gov.uk/ukgwa/20140403003432mp_/http://www.competition-commission.org.uk/assets/competitioncommission/docs/pdf/non-inquiry/rep_pub/reports/2009/fulltext/542.pdf

¹⁸ https://webarchive.nationalarchives.gov.uk/ukgwa/20140403003432mp_/http://www.competition-commission.org.uk/assets/competitioncommission/docs/pdf/non-inquiry/rep_pub/reports/2009/fulltext/542.pdf

23. Pavarësisht se banka, nëpërmjet informacionit para-kontraktor vë në dijeni kredimarrësin për nevojën e një sigurimi jete, vendimmarrja për shoqërinë e sigurimit, marrja e ofertave nga shoqëritë e ndryshme dhe krahasimi i primeve ndodh pas aprovimit të kredisë. Në këtë mënyrë banka siguron një akses të privilegjuar tek kredimarrësi, për të zgjedhur policën e sigurimit më të preferuar për bankën.
24. Për sa më sipër, tregu përkatës i produktit për Bankën Banka e Parë e Investimeve është tregu kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Banka e Parë e Investimeve.
25. Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse, produkti i sigurimit të jetës është i detyrueshëm të blihet në momentin që banka aprovon kredinë që klienti dëshiron të marrë, atëherë si treg gjeografik do të konsiderohet vetëm territori i bankës së nivelit të dytë që ka aprovuar atë kredi. Për këtë arsye tregu gjeografik për Bankën e Parë të Investimeve do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Banka e Parë e Investimeve.

III. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

26. Pjesët e tregut janë një tregues i rëndësishëm në lidhje me strukturën e tregut dhe rëndësinë e ndërmarrjeve të ndryshme në treg. Megjithatë, Autoriteti interpreton pjesët e tregut në këndvështrimin e kushteve të tregut përkatës dhe në veçanti të dinamikës së tregut dhe të diferencimit të produkteve. Tendenca ose zhvillimi i pjesëve të tregut me kalimin e kohës, mund të merret në konsideratë për tregjet e paqëndrueshme ose për tregjet ofertues
27. Praktikrat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrjet zotërojnë një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës.¹⁹
28. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Banka e Parë e Investimeve SHA në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës së Parë të Investimeve ka pozitë dominuese.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

¹⁹ Komunikim nga Komisioni Udhëzim mbi sjelljet përjashtuese, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 82 -Guidance on the Commission's enforcement priorities in applying Article 82 of the EC Treaty to abusive exclusionary conduct by dominant.

29. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo broker pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa më shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.
30. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
31. Sipas nenit 102 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasja e një pozite dominuese në treg nuk është e ndaluar në vetvete. Megjithatë, kur një ndërmarrje me pozitë dominuese përdor fuqinë e saj për të kufizuar konkurrencën në mënyrë të padrejtë, ajo mund të përbëjë një abuzim, i cili është i ndaluar me ligj.
32. Neni 102 TFEU liston kategoritë tipike të sjelljeve abuzive, por këto sjellje abuzive klasifikohen zakonisht në dy kategori kryesore: Abuzime përjashtuese (exclusionary abuses) dhe Abuzime shfrytëzuese (exploitative abuses)²⁰.
- Abuzime përjashtuese (Exclusionary abuse) i referohet sjelljeve të ndërmarrjeve me pozitë dominuese që synojnë të përjashtojnë konkurrentët nga tregu, ose të pengojnë hyrjen ose zhvillimin e tyre, jo thjesht të konkurrojnë lirshëm me to, por të kufizojnë konkurrencën në mënyrë aktive. Këto sjellje dëmtojnë strukturën konkurruese dhe, rrjedhimisht, edhe interesat afatgjata të konsumatorëve
 - Abuzime shfrytëzuese (Exploitative abuse) përfshin ato abuzime kur ndërmarrja me pozitë dominuese shfrytëzon pozicionin e saj për të përfituar në mënyrë të padrejtë, zakonisht përmes çmimeve të larta apo kushteve tregtare të padrejta, pa ndikuar drejtpërdrejt mbi konkurrentët.
33. Sipas nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit mbi zbatueshmërinë e neneve 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003, një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të abuzojë me këtë pozitë nëpërmjet shitjeve të lidhura (tying) ose kushtëzimeve të padrejta, kur klientit i kërkohet që, për të marrë një produkt (në këtë rast kredinë), të blejë një produkt tjetër (sigurimin e jetës) në kushte të përcaktuara nga vetë banka.

²⁰ <https://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=a940ed59-46d6-4932-a2cc-2fb52618f387>

34. Vendimi i klientit për bankën ku do të marrë kredinë merret përpara se ai të shqyrtojë ofertat për sigurimin e jetës për kredi. Kjo do të thotë se banka kontrollon pikën e shitjes (momentin vendimtar të nënshkrimit të kontratës), pra zotëron një pozitë të dominuese ndaj klientit.
35. Procesi i zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit ndodh pas miratimit të kredisë, në ambientet e bankës, ku kredimarrësi është tashmë i varur nga vendimi i bankës për disbursimin e fondeve. Kjo situatë i jep bankës fuqi të njëanshme tregu, duke i mundësuar të “shtyjë” një produkt sigurimi të caktuar nga një shoqëri sigurimi.
36. Autoriteti i Konkurrencës bazuar në nenin 9 të Ligjit nr. 9121/2003, ka analizuar sjelljen e Banka e Parë e Investimeve SHA (FIB) me qëllim verifikimin nëse kjo bankë, në cilësinë e ofruesit të kredisë si produkt lidhës, ka vendosur sigurimin e jetës si kusht për financimin ose ka ndikuar në përzgjedhjen e shoqërisë së sigurimit nga kredimarrësit. Analiza është kryer për të vlerësuar nëse ekziston ndonjë element i mundshëm i praktikës lidhëse (tying) apo formë tjetër e kufizimit të konkurrencës në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.
37. Banka e Parë e Investimeve SHA (FIB) nuk është e përfshirë në listën zyrtare të agjentëve apo brokerave të sigurimit të jetës si dhe nuk ka kontrata aktive me shoqëritë e sigurimit për të ofruar produktin e sigurimit të jetës tek klientët kredimarrës.
38. FIBANK SHA nëpërmjet shkresës së dërguar pranë AK shprehet se “...në kushtet kur sigurimi i jetës nuk përbën detyrim ligjor për kredimarrësin, bazuar edhe në rregulloret e strategjinë e brendshme të Bankës së Parë të Investimeve, kjo bankë nuk aplikon sigurimin e detyruar të jetës për individët kredimarrës, përveç se në rastet kur kjo është zgjedhja apo vendimi i vetë kredimarrësit”.
39. Referuar listës së klientëve të cilët në mënyrë vullnetare kanë kryer sigurimin e jetës për kredi gjatë periudhës në hetim, janë XXX klientë në total, të vitit 2024, XXX në lekë e XXX në euro dhe të katër kredimarrësit e kanë kryer sigurimin në shoqërinë e sigurimit Albsig Jetë SHA.
40. Në përfundim, sjellja e ndërmarrjes Banka e Parë e Investimeve SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Banka e Parë e Investimeve nuk përbën abuzim me pozitën dominuese në bazë të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 5 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Banka e Parë e Investimeve SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Banka e Parë e Investimeve.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes Banka e Parë e Investimeve SHA që, për aq kohë sa nuk zotëron statusin e agjentit ose brokerit në sigurime, të mos kryejë asnjë komunikim, verbal apo me shkrim, me shoqëritë e sigurimit në lidhje me sigurimin e jetës së kredimarrësve, proces i cili duhet t'i lihet ekskluzivisht kredimarrësit.
- III. Detyrimin e ndërmarrjes Banka e Parë e Investimeve SHA që brenda 30 ditëve, në kuadër të informacionit parakontraktor të dorëzuar çdo kredimarrësi, të përfshijë një njoftim të qartë, të shkruar dhe të plotë mbi përpunimin e të dhënave personale për qëllimet e vlerësimit dhe verifikimit të sjelljes së bankës në treg, përfshirë dhe aksesin dhe përpunimin e të dhënave nga Autoriteti i Konkurrencës, në rast monitorimi, hetimi paraprak apo hetimi të thelluar ndaj bankës.
- IV. Detyrimin e ndërmarrjes Banka e Parë e Investimeve SHA të raportojë në çdo kohë që do kërkohej, pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi mënyrën e zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi duke paraqitur çdo dokument që konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti i Konkurrencës për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi.
- V. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Banka e Parë e Investimeve SHA, në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.
- VI. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për një periudhë 1 vjeçare.
- VII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1264, Datë 20.02.2026

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES CREDINS BANK SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË BANKËN CREDINS”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar dhe dhënia e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Credins Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Credins.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 26, neni 43, pika 5 dhe neni 45 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me

sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.”;

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur

1. Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të një ankese të depozituar më datë 30 korrik 2024, mbi dyshimin për pengim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në tregun e sigurimit të jetës për kredi, në zbatim të nenit 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, aktivizoi procedurën e monitorimit të këtij tregu.
2. Bankat²¹ janë institucione financiare, që ushtrojnë veprimtarinë bankare të pranimit të depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimin e tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të tyre si dhe veprimtari të tjera të natyrës financiare, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Aktualisht në Shqipëri operojnë 11 banka tregtare, me kapital të huaj dhe vendas.
3. Sigurimi i Jetës për Kredi është një produkt që u ofrohet individëve kredimarrës, duke shërbyer ndër të tjera edhe si garanci për bankën, por dhe për kredimarrësin, i cili mbrohet si person i siguruar.
4. Nga analiza e informacionit të mbledhur gjatë fazës së monitorimit u konstatua se, pavarësisht shpjegimeve të dërguara me shkresë nga bankat, përqindjet e tregut total të sigurimit të jetës, të raportuara nga AMF për vitin 2023, nuk reflektohen në ndarjen e portofolit të sigurimit të jetës për kredi, që shitet përmes bankave. Kjo mospërputhje e dukshme ngriti shqetësime mbi funksionimin e konkurrencës në këtë segment të tregut.
5. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1130, datë 07.11.2024, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi për periudhën nga 7 nëntor 2021 deri në 7 nëntor 2024, vendim në të cilin përfshiu edhe ndërmarrjen Credins Bank SHA. Afati i përfundimit të hetimit paraprak, më pas, me Vendimin nr. 1159, datë 13.02.2025 u zgjat deri në 3 mars 2025.
6. Pas përfundimit të hetimit paraprak, u konkludua ndër të tjera se, sjellja e ndërmarrjes Credins

²¹ https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Subjekte_te_licencuara/Banka/

Bank SHA mund të përbënte shkelje të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe me Vendimin nr. 1171, datë 26.03.2025 Komisioni i Konkurrencës i hapi rrugë procedurës së hetimit të thelluar në përputhje me parashikimet ligjore për periudhën 7 nëntor 2021 – 26 Mars 2025. Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të hetimit.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

7. Sigurimi është një formë e manaxhimit të riskut që vjen nga një situatë e panjohur, një kontratë në bazë të së cilës një person/kompani, transferon rrezikun e mundshëm të një dëmi/humbje financiare tek një kompani sigurimi, përkundrejt pagesës së një shume që quhet prim sigurimi.
8. Sigurimi i Jetës për Kredi ofrohet për personat që marrin kredi në bankë dhe i mbron ata dhe familjarët nga rreziku i mos shlyerjes së hua-së si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit. Ky sigurim është një garanci financiare si për bankën (nga rreziku i mos shlyerjes së huasë si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit) ashtu edhe për kredimarrësin, personin e siguruar, duke qlliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur.
9. Tregu i sigurimeve të jetës në Republikën e Shqipërisë funksionon në zbatim të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.
10. Ligji nr. 52/2014 parashikon si lloje të ndërmjetësimit, veprimtarinë e agjentit dhe brokerit, duke përcaktuar se edhe bankat e nivelit të dytë mund të pajisen me licencë për të ushtruar këtë veprimtari. Konkretisht, neni 194, pika 4 parashikon se “Veprimtaria e agjentit mund të kryhet edhe nga bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, si dhe subjekte të tjera, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti” ndërsa neni 204 pika 5 parashikon se “Veprimtaria e brokerimit mund të kryhet edhe nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti”.
11. Në bazë të nenit 194 të Ligjit nr. 52/2014, veprimtaria e agjentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari. Veprimtaria e

agjentit në sigurime mund të kryhet edhe në emër të disa shoqërive të sigurimit, nëse shoqëritë e sigurimit kanë rënë dakord me marrëveshje të shkruar midis tyre.

12. Lidhur me veprimtarinë e brokerimit, në bazë të nenit 202 të Ligjit nr. 52/2014, përfshin të gjitha ato veprimtari, si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij. Gjithashtu, përfshin edhe asistencën për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, veçanërisht zgjidhjen e kërkesave për dëmshpërblim nga shoqëria e sigurimit, në emër dhe për llogari të konsumatorit. Brokëri/shoqëria e brokerimit ndërmjetëson për lidhjen e kontratave të sigurimit vetëm me shoqëritë e sigurimit të licencuara.
13. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo brokër pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa me shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.
14. Referuar sa më sipër, AMF në Republikën e Shqipërisë ka A licensuar 4 banka si broker në sigurime për klasat e jetës dhe 1 bankë si agjent në sigurime të kësaj kategorie. Bankat e licencuara si broker në sigurime për klasat e jetës janë: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Tirana Bank dhe OTP Bank. Si agjent për klasat e jetës është licencuar Credins Bank. Gjithashtu, ndërmarrja E-Business Solutions është licencuar si agjent në sigurime për klasat e jetës, ndërsa ABI Broker Sigurimesh është licencuar si broker në sigurimet e jetës dhe jo-jetës. Disa banka, edhe pse jo të licencuara, kanë lidhur marrëveshje me shoqëri sigurimi për klasat e jetës, duke marrë automatikisht rolin e ndërmjetësuesit.
15. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
16. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”²², bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.

²² Miratuar me Vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

17. Në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”²³, neni 7, informacioni kontraktor që duhet të japin bankat për klientët duhet të përmbajë veç të tjerave edhe, “garancitë e vendosura për të siguruar ekzekutimin e kontratës së kredisë, mënyrën e vënies së tyre në ekzekutim, dhe kontratat e sigurimit të jetës ose të pronës (kur janë të aplikueshme).
18. Mbi bazën e këtij detyrimi, klientët njihen në momentin e nënshkrimit të një kontrate kredie konsumatore apo hipotekare me detyrimin e sigurimit të jetës, aty ku është e aplikueshme, për gjithë periudhën e mbajtjes së detyrimit. Nëpërmjet këtij detyrimi, banka sigurohet që në rast ndodhje të një ngjarjeje ndaj kredimarrësit, detyrimi i tij të mbulohet nga shoqëritë e sigurimit.
19. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës kur ka vlerësuar tregun përkatës ka marrë parasysh sjelljen e konsumatorit kredimarrës. Çfarë është më e rëndësishme për kredimarrësin, kredia (banka) apo kosto e sigurimit të jetës për kredi (primi)? Kredimarrësi kur zgjedh bankën ku do të marrë kredinë e zgjedh për arsye si: reputacioni i bankës, eksperiencia e mëparshme (llogari page apo kredi të mëparshme), norma e interesit, shpejtësia e miratimit dhe disbursimit, etj. Pra, para se të trajtohet primi i sigurimit të jetës për kredi, konsumatori e ka vendosur bankën ku do të marrë financimin.
20. Në raportin e CMA (Competition & Market Authority) të Mbretërisë së Bashkuar, “Market investigation into payment protection insurance”²⁴ (paragrafi 5.89-5.91), “**pika e shitjes**” shpjegohet në mënyrë të përmbledhur: “... Avantazhi në pikën e shitjes është përfitimi që shpërndarësit gëzojnë nga fakti që kanë qasje të vetme tek klientët në momentin kur ata po marrin kredinë e tyre.”
21. Krahasimisht, vlerësohet se një situatë e ngjashme me atë të përshkruar në raportin e CMA ekziston edhe në rastin e kredive që kërkojnë sigurim jete, pasi vendimi i konsumatorit për t’u financuar nga një bankë e caktuar merret përpara zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit. Për rrjedhojë, banka gëzon një avantazh në “pikën e shitjes”, duke qenë se ka akses të privilegjuar ndaj klientit në momentin kur ai ndodhet në procesin e marrjes së kredisë.
22. Pavarësisht se banka, nëpërmjet informacionit para-kontraktor vë në dijeni kredimarrësin për nevojën e një sigurimi jete, vendimmarrja për shoqërinë e sigurimit, marrja e ofertave nga shoqëritë e ndryshme dhe krahasimi i primeve ndodh pas aprovimit të kredisë. Në këtë mënyrë banka siguron një akses të privilegjuar tek kredimarrësi, për të zgjedhur policën e sigurimit më të preferuar për bankën.

²³ Miratuar me Vendimin nr. 48 datë 01.07.2015, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

²⁴ https://webarchive.nationalarchives.gov.uk/ukgwa/20140403003432mp/http://www.competition-commission.org.uk/assets/competitioncommission/docs/pdf/non-inquiry/rep_pub/reports/2009/fulltext/542.pdf

23. Për sa më sipër, tregu përkatës i produktit është: tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Credins.
24. Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse, produkti i sigurimit të jetës është i detyrueshëm të blihet në momentin që banka aprovon kredinë që klienti dëshiron të marrë, atëherë si treg gjeografik do të konsiderohet vetëm territori i bankës së nivelit të dytë që ka aprovuar atë kredi. Për këtë arsye tregu gjeografik për Credins Bank SHA do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë banka Credins.

III. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

25. Pjesët e tregut janë një tregues i rëndësishëm në lidhje me strukturën e tregut dhe rëndësinë e ndërmarrjeve të ndryshme në treg. Megjithatë, Autoriteti interpreton pjesët e tregut në këndvështrimin e kushteve të tregut përkatës dhe në veçanti të dinamikës së tregut dhe të diferencimit të produkteve. Tendenca ose zhvillimi i pjesëve të tregut me kalimin e kohës, mund të merret në konsideratë për tregjet e paqëndrueshme ose për tregjet ofertues.
26. Praktikrat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrjet zotërojnë një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës²⁵.
27. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndërmarrja Credins Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Credins, ka pozitë dominuese.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes në tregun përkatës

28. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës

²⁵ Komunikim nga Komisioni Udhëzim mbi sjelljet përjashtuese, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 82 -Guidance on the Commission's enforcement priorities in applying Article 82 of the EC Treaty to abusive exclusionary conduct by dominant.

së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo broker pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa me shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.

29. Neni 194 pika 1 e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” shprehet se, veprimtaria e agjentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari. Gjithashtu neni 198 pika 3 e po këtij ligji, shprehet se agjenti apo shoqëria e agjentëve në sigurime kryen vetëm ato veprimtari, për të cilat është miratuar apo licencuar.
30. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
31. Sipas nenit 102 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasja e një pozite dominuese në treg nuk është e ndaluar në vetvete. Megjithatë, kur një ndërmarrje me pozitë dominuese përdor fuqinë e saj për të kufizuar konkurrencën në mënyrë të padrejtë, ajo mund të përbëjë një abuzim, i cili është i ndaluar me ligj.
32. Neni 102 TFEU liston kategoritë tipike të sjelljeve abuzive, por këto sjellje abuzive klasifikohen zakonisht në dy kategori kryesore: Abuzime përjashtuese (exclusionary abuses) dhe Abuzime shfrytëzuese (exploitative abuses)²⁶.
- Abuzime përjashtuese (Exclusionary abuse) i referohet sjelljeve të ndërmarrjeve me pozitë dominuese që synojnë të përjashtojnë konkurrentët nga tregu, ose të pengojnë hyrjen ose zhvillimin e tyre, jo thjesht të konkurrojnë lirshëm me to, por të kufizojnë konkurrencën në mënyrë aktive. Këto sjellje dëmtojnë strukturën konkurruese dhe, rrjedhimisht, edhe interesat afatgjata të konsumatorëve
 - Abuzime shfrytëzuese (Exploitative abuse) përfshin ato abuzime kur ndërmarrja me pozitë dominuese shfrytëzon pozicionin e saj për të përfituar në mënyrë të padrejtë, zakonisht përmes çmimeve të larta apo kushteve tregtare të padrejta, pa ndikuar drejtpërdrejt mbi konkurrentët.

²⁶ <https://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=a940ed59-46d6-4932-a2cc-2fb52618f387>

33. Sipas nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit mbi zbatueshmërinë e neneve 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003, një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të abuzojë me këtë pozitë nëpërmjet shitjeve të lidhura (tying) ose kushtëzimeve të padrejta, kur klientit i kërkohet që, për të marrë një produkt (në këtë rast kredinë), të blejë një produkt tjetër (sigurimin e jetës) në kushte të përcaktuara nga vetë banka.
34. Vendimi i klientit për bankën ku do të marrë kredinë merret përpara se ai të shqyrtojë ofertat për sigurimin e jetës për kredi. Kjo do të thotë se banka kontrollon pikën e shitjes (momentin vendimtar të nënshkrimit të kontratës), pra zotëron një pozitë të dominuese ndaj klientit.
35. Procesi i zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit ndodh pas miratimit të kredisë, në ambientet e bankës, ku kredimarrësi është tashmë i varur nga vendimi i bankës për disbursimin e fondeve. Kjo situatë i jep bankës fuqi të njëanshme tregu, duke i mundësuar të “shtyjë” një produkt sigurimi të caktuar nga një shoqëri sigurimi.
36. Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në nenin 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka analizuar sjelljen e Banka Credins SHA duke shqyrtuar nëse banka, duke kërkuar sigurimin e jetës si kusht për financimin e klientëve dhe duke ushtruar njëkohësisht aktivitet ndërmjetësimi si agjent i licencuar për shoqërinë Sicred SHA, ka krijuar mekanizma ose incentiva që mund të kufizojnë zgjedhjen efektive të kredimarrësve në përzgjedhjen e shoqërisë së sigurimit të jetës. Konkretisht, është analizuar nëse kombinimi i rolit të bankës si huadhënëse dhe si agjente e një shoqërie të vetme sigurimi, përqendrimi i lartë i policave pranë kësaj shoqërie, si dhe formulimet kontraktuale që referojnë “shoqëri të pranuar nga Banka”, mund të përbëjnë praktikë përjashtuese ose formë tjetër të kufizimit të konkurrencës brenda këtij tregu përkatës.
37. Banka Credins, është licencuar si agjent nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Licencën nr. 1139, datë 07.05.2018, për klasat e jetës për shoqërinë Sicred SHA, për një periudhë pa afat. Kjo licencë lejon Bankën Credins të prezantojë dhe ofrojë ndërmjetësimin e policave të sigurimit të jetës së kredimarrësve të saj, si bankë e licencuar si Agjent për klasat e sigurimit të jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë Sicred SHA.
38. Banka Credins sqaron se, në përputhje me parashikimet e dokumenteve kyçe të saj “Politikat Kredituese” si dhe “Kushtet dhe termat e kredive në Bankën Credins”, kërkon sigurimin e jetës së kredimarrësve të saj (ashtu si edhe sigurimin e kolateralit) si kusht për financimin e klientëve. Përjashtime nga kërkesa e sigurimit të jetës përbëjnë kategori të veçanta financimesh si për shembull kreditë me “cash-kolateral”, kreditë me kolateral instrumente financiarë kreditë për stafin e Banka Credins dhe përgjithësisht financimet e llojit “overdraft” për individët. Gjithashtu, Credins Bank SHA bën me dije se pavarësisht rregullit të përgjithshëm, autoritetet miratuese të

bankës, në vijim të analizës së detajuar të rastit të financimit, rezervojnë të drejtën apo kanë kompetencat të vendosin të mos përfshijnë sigurimet si pjesë e garancisë për kthimin e huasë.

39. Në kontratën e kredisë subjekt interes fiks pa kolateral mikro të lidhur ndërmjet bankës dhe kredimarrësit, në nenin 10.1 të saj “Sigurimi i jetës” shprehet se: “10.1. Banka ka të drejtë t’i kërkojë kredimarrësit ose çdo personi tjetër të përcaktuar nga Banka të sigurojë/sigurojnë jetën e tij/tyre për vlerën e kredisë dhe për të gjithë kohëzgjatjen e saj, pranë një shoqërie sigurimi jete të pranuar nga Banka, me shpenzimet e tij/tyre. Përfituese në policën e sigurimit do të jetë Banka ndaj kompensimit eventual nga polica e sigurimit të Jetës për Hua do t’i kalojë Bankës për vlerën totale të të gjitha detyrimeve të papaguara nga kredimarrësi”.
40. Banka Credins ka lidhur kontratë “Për shërbimin e agentit për Sicred SHA”, nr. 31822 prot. datë 17.07.2018. Inspektorët e AK kanë administruar këtë kontratë, anekset dhe amendimet e saj (të plotë gjatë inspektimit në degën e Bankës Credins dhe të pjesshme në formë shkresore nga ndërmarrja Sicred). Kjo kontratë është me afat 1 vjeçar dhe rinovohet automatikisht, përveçse në rastin kur palët bëjnë një lajmërim paraprak për zgjidhjen e saj.
41. Klientët e kredisë në Bankën Credins, kanë prerë policat e sigurimit të jetës ku vihet re se në volum primesh, mbizotërojnë prerjet pranë ndërmarrjes Sicred me XXX% të gjithë policave të prera dhe XXX% e primeve në lekë (XXX% në euro dhe XXX% në dollarë) për periudhën. Kjo reflektohet edhe në rakordime ku XXX% e totalit të komisioneve të përfituara vjen si rrjedhojë e bashkëpunimit me Sicred.
42. Për sa i përket lirisë së klientëve për të përzgjedhur shoqërinë e sigurimit në tregun e sigurimit të jetës, Banka Credins sqaron se klientët e saj kanë të drejtë të realizojnë sigurimin e jetës për hua në çdo shoqëri sigurimi jete të licensuar dhe që vepron sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Pra, sipas Bankës Credins klientit i ofrohet liri e plotë në përzgjedhjen e shoqërisë së sigurimit të jetës, por nuk ofron shërbim ndërmjetësimi për ata klientë që nuk zgjedhin ndërmarrjen Sicred, pasi ka një kontratë aktive me këtë të fundit. Gjithashtu, Banka Credins pranon çfarëdo police sigurimi të negociuar nga vetë klienti me shoqërinë e sigurimit që ka përzgjedhur vetë ai/ajo.
43. Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit, në formë shkresore apo prova të administruara gjatë inspektimeve, rezulton se Banka Credins ka si dokument standard të kredimarrjes, dokumentin me titull “Transparenca me Klientin” ku klientit i bëhet me dije kushtet e sigurimit të jetës. Në fund të paragrafit 2.2.6 Sigurimi i jetës, klienti kredimarrës ka mundësinë të zgjedhë të procedojë me ndërmarrjen e sigurimit Sicred, për të cilën banka është agjente apo do të sigurojë në mënyrë private policën e sigurimit të jetës, për sa kohë pranohet nga banka.

44. Për të verifikuar zbatimin e lirisë së zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit të jetës për kredi nga klienti, nëpërmjet shkresës nr. 96/124 prot., datë 20.08.2025 i është kërkuar Bankës Credins të dërgojë emrin e shoqërisë së sigurimit dhe vërtetimin e pëlqimit të dhënë nga çdo kredimarrës për shoqërinë e sigurimit të zgjedhur për një listë emërore të përzgjedhur nga Autoriteti i Konkurrencës.
45. Përgjigja e Bankës Credins nëpërmjet shkresës nr. 96/126 prot., datë 04.09.2025 dhe nr. 96/138 prot., datë 04.09.2025 ku në katër e-mail janë dorëzuar pranë AK materialet e kërkuara për të gjithë 39 kredimarrësit. Ato përmbajnë vërtetimin e pëlqimit të dhënë nga klienti ose formularin “Transparenca me Klientin” të Bankës Credins dhe shoqërinë e sigurimit dërguar nga Banka Credins.
46. Referuar të dhënave të regjistrit tregtar për ndërmarrjen Sicred SHA dhe Bankën Credins SHA konstatohet se: Ndërmarrja Sicred SHA ka 10 aksionarë; Ndërmarrja Banka Credins SHA ka 73 aksionarë. Dy ndërmarrjet kanë 6 aksionarë të përbashkët ose 32.86% të kapitalit të përbashkët.
47. Edhe pse kuadri ligjor ynë nuk përmban një dispozitë të posaçme që rregullon këtë situatë për agjentët e sigurimit, nëse i referohemi praktikave më të mira dhe legjislacionit evropian, konkretisht Direktivës (BE) 2016/097 (IDD), ndërmjetësuesit kanë detyrimin të garantojnë transparencë të plotë ndaj konsumatorit, veçanërisht kur ekzistojnë lidhje pronësie me një shoqëri sigurimi. Sipas nenit 19(1) të kësaj Direktive, ndërmjetësuesi duhet të informojë klientin nëse mban, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të paktën 10% të kapitalit apo të drejtave të votës në një shoqëri sigurimi. Në këtë kuptim, duke pasur parasysh pronësinë e përbashkët ndërmjet bankës Credins dhe shoqërisë së sigurimit Sicred, do të nevojshme që ky fakt të komunikohet paraprakisht në mënyrë të qartë dhe të shkruar klientit përpara zgjedhjes së produktit të sigurimit, në përputhje me mënyrën e paraqitjes së informacionit të përcaktuar në nenin 23(1) të Direktivës.
48. Gjithashtu, në përputhje me frymën e nenit 20(3) të Direktivës (BE) 2016/097 (IDD), kur ndërmjetësuesi deklaron se ofron këshillim të drejtë dhe të personalizuar, ai ka detyrimin ta mbështesë atë në analizën e një numri të mjaftueshëm ofertash në treg, në mënyrë që të rekomandojë produktin më të përshtatshëm për nevojat e klientit. Në këtë kontekst, është në interesin më të mirë të konsumatorit, që Banka Credins të zgjerojë bashkëpunimin edhe me shoqëri tjera të sigurimit përveç Sicred. Një qasje e tillë jo vetëm që garanton një zgjedhje të lirë dhe të informuar për klientin, por është dhe në përputhje me parimet e konkurrencës së ndershme, pasi synon shmangien e praktikave kufizuese dhe përjashtuese në treg.
49. Pavarësisht se numri i lartë i policave të prera me shoqërinë Sicred SHA, jep idenë se jemi në kushtet e një tregu jo të hapur, banka ka operuar si agjent i një shoqërie sigurimi, duke përfaqësuar vetëm një shoqëri sigurimi në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 52/2014.

50. Banka Credins SHA ushtron aktivitet ndërmjetësimi në sigurimin e jetës si agent i licencuar ekskluzivisht për shoqërinë Sicred SHA, në përputhje me nenet 194 dhe 198 të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Në këtë cilësi, banka vepron në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit, dhe nuk është e detyruar të ofrojë produkte të shoqërive të tjera sigurimi, përveç asaj për të cilën është e licencuar.
51. Për këtë arsye, përqendrimi i lartë i policave të sigurimit të jetës pranë shoqërisë Sicred SHA (rreth 98% e totalit të policave) nuk përbën tregues të një sjelljeje abuzive apo përjashtuese në treg, pasi ai rrjedh natyrshëm nga marrëdhënia ligjore e përfaqësimit të bankës si agent. Për të verifikuar zbatimin e lirisë së zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit të jetës për kredi nga klienti, nëpërmjet shkresës nr. 96/124 prot., datë 20.08.2025, i është kërkuar Bankës Credins të dërgojë emrin e shoqërisë së sigurimit dhe vërtetimin e pëlqimit të dhënë nga çdo kredimarrës për shoqërinë e sigurimit të zgjedhur, për një listë emërore të përzgjedhur nga Autoriteti i Konkurrencës.
52. Përgjigja e Bankës Credins është dërguar nëpërmjet shkresës nr. 96/126 prot., datë 04.09.2025 dhe nr. 96/138 prot., datë 04.09.2025, ku në katër e-mail janë dorëzuar pranë Autoritetit të Konkurrencës materialet e kërkuara për të gjithë 39 kredimarrësit. Këto materiale përmbajnë vërtetimin e pëlqimit të dhënë nga klienti ose formularin “Transparenca me Klientin” të Bankës Credins dhe shoqërinë e sigurimit të përzgjedhur, të dërguara nga banka.
53. Dispozita e nenit 10. të kontratës së kredisë që i jep bankës të drejtën “t’i kërkojë kredimarrësit ose çdo personi tjetër të përcaktuar nga Banka të sigurojë/sigurojnë jetën e tij/tyre për vlerën e kredisë dhe për të gjithë kohëzgjatjen e saj, pranë një shoqërie sigurimi jete të pranuar nga Banka”, gabimisht krijon ndjesinë që banka mund të përdori pozitën dominuese për të imponuar kushte të padrejta kontraktuale ndaj klientëve, duke kufizuar konkurrencën ndërmjet shoqërive të sigurimit dhe duke përfituar në mënyrë të padrejtë nga pozita e saj si huadhënëse dhe agjente sigurimi njëkohësisht ndërkohë që nuk reflekton situatën/praktikën reale (atë që banka pranon çdo policë sigurimi të jashtme dhe që nuk ka asnjë rast të vetëm ku kredimarrësi të mos ketë dhënë pëlqimin paraprakisht). Në konkluzion problem nuk është sjellja praktike por formulimi kontraktual i gabuar që ka nevojë të riformulohet në mënyrë të qartë dhe të paanshme, duke garantuar shprehimisht të drejtën e kredimarrësit për të zgjedhur çdo shoqëri sigurimi ndërkohë që banka ruan të drejtën të veprojë si agent i vetëm për shoqërinë me të cilën ka marrëveshje.
54. Elementët e administruar në këtë procedurë hetimore nuk krijojnë bindjen e plotë për shkeljen e nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes Credins SHA, nuk rezulton se praktika e ndjekur ka prodhuar efekt përjashtues në treg ose një kufizim të faktuar të konkurrencës ndërmjet shoqërive të sigurimit përtej efektit që

rrjedh vetvetiu nga modeli ligjor i agjentit të licencuar.

55. Në përfundim, me gjithë ekzistencën e dyshimeve, nuk ka prova të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë që në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Credins të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 26, nenin 43, pika 5 dhe nenin 45, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Credins Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Credins.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes Credins Bank SHA që brenda 30 ditëve të ndryshojë parashikimin e nenit 10.1 në Kontratën e kredisë bankare “Sigurimi i jetës”, duke i cilësuar kredimarrësit të drejtën e këtij të fundit për të siguruar jetën në secilën nga shoqëritë e sigurimit të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
- III. Detyrimin e ndërmarrjes Credins Bank SHA të raportojë, çdo 3 muaj, pranë Autoritetit të Konkurrencës, mbi rastet kur kredimarrësit kanë zgjedhur të sigurojnë jetën në shoqëri sigurimi të tjera, të ndryshme nga shoqëria e sigurimit Sicred SHA.
- IV. Detyrimin e ndërmarrjes Credins Bank SHA që brenda 30 ditëve, në kuadër të informacionit parakontraktor të dorëzuar çdo kredimarrësi, të përfshijë një njoftim të qartë, të shkruar dhe të plotë mbi përpunimin e të dhënave personale për qëllimet e vlerësimit dhe verifikimit të sjelljes së bankës në treg, përfshirë dhe aksesin dhe përpunimin e të dhënave nga Autoriteti i Konkurrencës, në rast monitorimi, hetimi paraprak apo hetimi të thelluar ndaj bankës.
- V. Detyrimin e ndërmarrjes Credins Bank SHA të raportojë në çdo kohë që do kërkohej, pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi mënyrën e zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi duke paraqitur çdo dokument që konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti i Konkurrencës për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi.

VI. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Credins Bank SHA në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penaltitetin përkatës.

VII. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjes Credins Bank SHA për një periudhë 1 vjeçare.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1265, Datë 20.02.2026

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES PROCREDIT SHA NË TREGUN E KREDIDHËNIES ME SIGURIM E JETE PËR KREDITË QË JEPEN BRENDË BANKËS PROCREDIT”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar dhe dhënia e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes ProCredit SHA në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës ProCredit.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 26, dhe neni 43, pika 5 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.”;

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të një ankese të depozituar më datë 30 korrik 2024, mbi dyshimin për pengim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në tregun e sigurimit të jetës për kredi, në zbatim të nenit 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, aktivizoi procedurën e monitorimit të këtij tregu.
2. Bankat²⁷ janë institucione financiare, që ushtrojnë veprimtarinë bankare të pranimi të depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimin e tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të tyre si dhe veprimtari të tjera të natyrës financiare, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Aktualisht në Shqipëri operojnë 11 banka tregtare, me kapital të huaj dhe vendas.
3. Sigurimi i Jetës për Kredi është një produkt që u ofrohet individëve kredimarrës, duke shërbyer ndër të tjera edhe si garanci për bankën, por dhe për kredimarrësin, i cili mbrohet si person i siguruar.
4. Nga analiza e informacionit të mbledhur gjatë fazës së monitorimit u konstatua se, pavarësisht shpjegimeve të dërguara me shkresë nga bankat, përqindjet e tregut total të sigurimit të jetës, të raportuara nga AMF për vitin 2023, nuk reflektohen në ndarjen e portofolit të sigurimit të jetës për kredi, që shitet përmes bankave. Kjo mospërputhje e dukshme ngriti shqetësime mbi funksionimin e konkurrencës në këtë segment të tregut.
5. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1130, datë 07.11.2024, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi për periudhën nga 7 nëntor 2021 deri në 7 nëntor 2024, vendim në të cilin përfshiu edhe ndërmarrjen Banka Procredit SHA. Afati i përfundimit të hetimit paraprak, më pas, me Vendimin nr. 1159, datë 13.02.2025 u zgjat deri në 3 mars 2025.
6. Pas përfundimit të hetimit paraprak, u konkludua ndër të tjera se, sjellja e ndërmarrjes Banka Procredit SHA mund të përbënte shkelje të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe me Vendimin nr. 1171, datë 26.03.2025 Komisioni i Konkurrencës i hapi rrugë procedurës së hetimit të thelluar në përputhje me parashikimet ligjore

²⁷ https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Subjekte_te_licencuara/Banka/

për periudhën 7 nëntor 2021 – 26 Mars 2025. Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të hetimit.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

7. Sigurimi është një formë e manaxhimit të riskut që vjen nga një situatë e panjohur, një kontratë në bazë të së cilës një person/kompani, transferon rrezikun e mundshëm të një dëmi/humbje financiare tek një kompani sigurimi, përkundrejt pagesës së një shume që quhet prim sigurimi.
8. Sigurimi i Jetës për Kredi ofrohet për personat që marrin kredi në bankë dhe i mbron ata dhe familjarët nga rreziku i mos shlyerjes së hua-së si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit. Ky sigurim është një garanci financiare si për bankën (nga rreziku i mos shlyerjes së huasë si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit) ashtu edhe për kredimarrësin, personin e siguruar, duke çliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur.
9. Tregu i sigurimeve të jetës në Republikën e Shqipërisë funksionon në zbatim të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.
10. Ligji nr. 52/2014 parashikon si lloje të ndërmjetësimit, veprimtarinë e agjentit dhe brokerit, duke përcaktuar se edhe bankat e nivelit të dytë mund të pajisen me licencë për të ushtruar këtë veprimtari. Konkretisht, neni 194, pika 4 parashikon se “Veprimtaria e agjentit mund të kryhet edhe nga bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, si dhe subjekte të tjera, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti” ndërsa neni 204 pika 5 parashikon se “Veprimtaria e brokerimit mund të kryhet edhe nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti”.
11. Në bazë të nenit 194 të Ligjit nr. 52/2014, veprimtaria e agjentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari. Veprimtaria e agjentit në sigurime mund të kryhet edhe në emër të disa shoqërive të sigurimit, nëse shoqëritë e sigurimit kanë rënë dakord me marrëveshje të shkruar midis tyre.

12. Lidhur me veprimtarinë e brokerimit, në bazë të nenit 202 të Ligjit nr. 52/2014, përfshin të gjitha ato veprimtari, si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij. Gjithashtu, përfshin edhe asistencën për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, veçanërisht zgjidhjen e kërkesave për dëmshpërblim nga shoqëria e sigurimit, në emër dhe për llogari të konsumatorit. Brokeri/shoqëria e brokerimit ndërmjetëson për lidhjen e kontratave të sigurimit vetëm me shoqëritë e sigurimit të licencuara.
13. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo brokër pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa me shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.
14. Referuar sa më sipër, AMF në Republikën e Shqipërisë ka A licencuar 4 banka si broker në sigurime për klasat e jetës dhe 1 bankë si agjent në sigurime të kësaj kategorie. Bankat e licencuara si broker në sigurime për klasat e jetës janë: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Tirana Bank dhe OTP Bank. Si agjent për klasat e jetës është licencuar Credins Bank. Gjithashtu, ndërmarrja E-Business Solutions është licencuar si agjent në sigurime për klasat e jetës, ndërsa ABI Broker Sigurimesh është licencuar si broker në sigurimet e jetës dhe jo-jetës. Disa banka, edhe pse jo të licencuara, kanë lidhur marrëveshje me shoqëri sigurimi për klasat e jetës, duke marrë automatikisht rolin e ndërmjetësuesit.
15. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
16. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”²⁸, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
17. Në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”²⁹, neni 7, informacioni kontraktor që duhet të japin bankat për klientët duhet të përmbajë veç të tjerave edhe, “garancitë

²⁸ Miratuar me Vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

²⁹ Miratuar me Vendimin nr. 48 datë 01.07.2015, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

e vendosura për të siguruar ekzekutimin e kontratës së kredisë, mënyrën e vënies së tyre në ekzekutim, dhe kontratat e sigurimit të jetës ose të pronës (kur janë të aplikueshme).

18. Mbi bazën e këtij detyrimi, klientët njihen në momentin e nënshkrimit të një kontrate kredie konsumatorë apo hipotekare me detyrimin e sigurimit të jetës, aty ku është e aplikueshme, për gjithë periudhën e mbajtjes së detyrimit. Nëpërmjet këtij detyrimi, banka sigurohet që në rast ndodhje të një ngjarjeje ndaj kredimarrësit, detyrimi i tij të mbulohet nga shoqëritë e sigurimit.
19. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës kur ka vlerësuar tregun përkatës ka marrë parasysh sjelljen e konsumatorit kredimarrës. Çfarë është më e rëndësishme për kredimarrësin, kredia (banka) apo kosto e sigurimit të jetës për kredi (primi)? Kredimarrësi kur zgjedh bankën ku do të marrë kredinë e zgjedh për arsye si: reputacioni i bankës, eksperiencia e mëparshme (llogari page apo kredi të mëparshme), norma e interesit, shpejtësia e miratimit dhe disbursimit, etj. Pra, para se të trajtohet primi i sigurimit të jetës për kredi, konsumatori e ka vendosur bankën ku do të marrë financimin.
20. Në raportin e CMA (Competition & Market Authority) të Mbretërisë së Bashkuar, “Market investigation into payment protection insurance”³⁰ (paragrafi 5.89-5.91), **“pika e shitjes”** shpjegohet në mënyrë të përmblodhur: “... Avantazhi në pikën e shitjes është përfitimi që shpërndarësit gëzojnë nga fakti që kanë qasje të vetme tek klientët në momentin kur ata po marrin kredinë e tyre.”
21. Krahasimisht, vlerësohet se një situatë e ngjashme me atë të përshkruar në raportin e CMA ekziston edhe në rastin e kredive që kërkojnë sigurim jete, pasi vendimi i konsumatorit për t’u financiar nga një bankë e caktuar merret përpara zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit. Për rrjedhojë, banka gëzon një avantazh në “pikën e shitjes”, duke qenë se ka akses të privilegjuar ndaj klientit në momentin kur ai ndodhet në procesin e marrjes së kredisë.
22. Pavarësisht se banka, nëpërmjet informacionit para-kontraktor vë në dijeni kredimarrësin për nevojën e një sigurimi jete, vendimmarrja për shoqërinë e sigurimit, marrja e ofertave nga shoqëritë e ndryshme dhe krahasimi i primeve ndodh pas aprovimit të kredisë. Në këtë mënyrë banka siguron një akses të privilegjuar tek kredimarrësi, për të zgjedhur policën e sigurimit më të preferuar për bankën.
23. Për sa më sipër, tregu përkatës i produktit për bankën ProCredit është tregu kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës ProCredit.

³⁰ https://webarchive.nationalarchives.gov.uk/ukgwa/20140403003432mp_/http://www.competition-commission.org.uk/assets/competitioncommission/docs/pdf/non-inquiry/rep_pub/reports/2009/fulltext/542.pdf

24. Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse, produkti i sigurimit të jetës është i detyrueshëm të blihet në momentin që banka aprovon kredinë që klienti dëshiron të marrë, atëherë si treg gjeografik do të konsiderohet vetëm territori i bankës së nivelit të dytë që ka aprovuar atë kredi. Për këtë arsye tregu gjeografik për bankën ProCredit do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Banka ProCredit.

III. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

25. Pjesët e tregut janë një tregues i rëndësishëm në lidhje me strukturën e tregut dhe rëndësinë e ndërmarrjeve të ndryshme në treg. Megjithatë, Autoriteti interpreton pjesët e tregut në këndvështrimin e kushteve të tregut përkatës dhe në veçanti të dinamikës së tregut dhe të diferencimit të produkteve. Tendencia ose zhvillimi i pjesëve të tregut me kalimin e kohës, mund të merret në konsideratë për tregjet e paqëndrueshme ose për tregjet ofertues
26. Praktikën më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrjet zotërojnë një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës.³¹
27. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ProCredit Bank SHA në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës ProCredit, ka pozitë dominuese.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

28. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo broker pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa më shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.

³¹ Komunikim nga Komisioni Udhëzim mbi sjelljet përjashtuese, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 82 -Guidance on the Commission's enforcement priorities in applying Article 82 of the EC Treaty to abusive exclusionary conduct by dominant.

29. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
30. Sipas nenit 102 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasja e një pozite dominuese në treg nuk është e ndaluar në vetvete. Megjithatë, kur një ndërmarrje me pozitë dominuese përdor fuqinë e saj për të kufizuar konkurrencën në mënyrë të padrejtë, ajo mund të përbëjë një abuzim, i cili është i ndaluar me ligj.
31. Neni 102 TFEU liston kategoritë tipike të sjelljeve abuzive, por këto sjellje abuzive klasifikohen zakonisht në dy kategori kryesore: Abuzime përjashtuese (exclusionary abuses) dhe Abuzime shfrytëzuese (exploitative abuses)³².
- Abuzime përjashtuese (Exclusionary abuse) i referohet sjelljeve të ndërmarrjeve me pozitë dominuese që synojnë të përjashtojnë konkurrentët nga tregu, ose të pengojnë hyrjen ose zhvillimin e tyre, jo thjesht të konkurrojnë lirshëm me to, por të kufizojnë konkurrencën në mënyrë aktive. Këto sjellje dëmtojnë strukturën konkurruese dhe, rrjedhimisht, edhe interesat afatgjata të konsumatorëve
 - Abuzime shfrytëzuese (Exploitative abuse) përfshin ato abuzime kur ndërmarrja me pozitë dominuese shfrytëzon pozicionin e saj për të përfituar në mënyrë të padrejtë, zakonisht përmes çmimeve të larta apo kushteve tregtare të padrejta, pa ndikuar drejtpërdrejt mbi konkurrentët.
32. Sipas nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit mbi zbatueshmërinë e neneve 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003, një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të abuzojë me këtë pozitë nëpërmjet shitjeve të lidhura (tying) ose kushtëzimeve të padrejta, kur klientit i kërkohet që, për të marrë një produkt (në këtë rast kredinë), të blejë një produkt tjetër (sigurimin e jetës) në kushte të përcaktuara nga vetë banka.
33. Vendimi i klientit për bankën ku do të marrë kredinë merret përpara se ai të shqyrtojë ofertat për sigurimin e jetës për kredi. Kjo do të thotë se banka kontrollon pikën e shitjes (momentin vendimtar të nënshkrimit të kontratës), pra zotëron një pozitë të dominuese ndaj klientit.
34. Procesi i zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit ndodh pas miratimit të kredisë, në ambientet e bankës, ku kredimarrësi është tashmë i varur nga vendimi i bankës për disbursimin e fondeve. Kjo situatë i jep bankës fuqi të njëanshme tregu, duke i mundësuar të “shtyjë” një produkt sigurimi të caktuar nga një shoqëri sigurimi.

³² <https://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=a940ed59-46d6-4932-a2cc-2fb52618f387>

35. Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në nenin 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka analizuar sjelljen e ProCredit Bank SHA duke shqyrtuar nëse banka, duke vendosur rast pas rasti përmes komitetit të kredisë aplikimin e sigurimit të jetës si kusht për miratimin e kredisë, ka krijuar mekanizma që mund të kufizojnë zgjedhjen e kredimarrësve ose të ndikojnë në përzgjedhjen e shoqërisë së sigurimit. Analiza është përqendruar në vlerësimin nëse praktika e ndjekur nga banka në procesin e kreditimit dhe në administrimin e rasteve kur kërkohet sigurimi i jetës, mund të përbëjë praktikë lidhëse (tying) ose formë tjetër të kufizimit të konkurrencës brenda këtij tregu përkatës, në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.
36. Procredit Bank SHA nëpërmjet informacionit të dërguar pranë AK, shprehet se sigurimi i jetës për klientët e kredisë në bankë nuk kërkohet për të gjithë klientët. Ai kërkohet kur ky vendim merret nga komiteti i kredisë pas analizës financiare të aplikimit për kredi, rast pas rasti. Në këto raste komiteti i kredisë vendos në aprovimin e kredisë edhe kushtin për t’u aplikuar sigurimi i jetës së kredimarrësit.
37. ProCredit Bank SHA nuk është e përfshirë në listën zyrtare të agjentëve apo brokerave të sigurimit të jetës si dhe nuk ka kontrata aktive me shoqëritë e sigurimit për të ofruar produktin e sigurimit të jetës tek klientët kredimarrës. Në rast se komiteti i kredisë ka vendosur që ky produkt të jetë i përfshirë në kredimarrje, atëherë klienti ka liri zgjedhjeje për kompaninë e sigurimit të jetës.
38. ProCredit Bank nuk bën asnjë rakordim/raportim me shoqëritë e sigurimit të jetës për policat e prera për herë të parë, por mban kontakte për rinovimin e policave të sigurimit në afatin e tyre të maturimit.
39. Nga vlerësimi i informacionit është vënë re se produkti i sigurimit të jetës në ndërmarrjen Procredit SHA, për të gjitha rastet kur kredia është siguruar me produktin e sigurimit të jetës, është prerë kryesisht pranë të njëjtës shoqëri sigurimi.
40. Në përfundim, sjellja e ndërmarrjes ProCredit Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën ProCredit nuk përbën abuzim me pozitën dominuese në bazë të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 5 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes ProCredit Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën ProCredit.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes ProCredit Bank SHA që, për aq kohë sa nuk zotëron statusin e agjentit ose brokerit në sigurime, të mos kryejë asnjë komunikim, verbal apo me shkrim, me shoqëritë e sigurimit në lidhje me sigurimin e jetës së kredimarrësve, proces i cili duhet t'i lihet ekskluzivisht kredimarrësit.
- III. Detyrimin e ndërmarrjes ProCredit Bank SHA që brenda 30 ditëve, në kuadër të informacionit parakontraktor të dorëzuar çdo kredimarrësi, të përfshijë një njoftim të qartë, të shkruar dhe të plotë mbi përpunimin e të dhënave personale për qëllimet e vlerësimit dhe verifikimit të sjelljes së bankës në treg, përfshirë dhe aksesin dhe përpunimin e të dhënave nga Autoriteti i Konkurrencës, në rast monitorimi, hetimi paraprak apo hetimi të thelluar ndaj bankës.
- IV. Detyrimin e ndërmarrjes ProCredit Bank Albania SHA të raportojë në çdo kohë që do kërkohej, pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi mënyrën e zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi duke paraqitur çdo dokument që konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti i Konkurrencës për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi.
- V. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja ProCredit Bank SHA, në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penaltetin përkatës.
- VI. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për një periudhë 1 vjeçare.
- VII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr.1266, Datë 20.02.2026

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË BANKËN ABI DHE NDAJ NDËRMARRJES ABI BROKER SIGURIMESH SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË BANKËN ABI, KU NDËRMJETËSIMIN E USHTRON NDËRMARRJA ABI BROKER SIGURIMESH SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.02.2026,shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar dhe dhënia e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Banka Amerikane e Investimeve SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën ABI dhe ndaj ndërmarrjes ABI Broker Sigurimesh SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën ABI, ku ndërmjetësimin e ushtron ndërmarrja ABI Broker Sigurimesh SHA.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 26, neni 43, pika 5 dhe neni 45 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe

në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.;

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.”;

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të një ankese të depozituar më datë 30 korrik 2024, mbi dyshimin për pengim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në tregun e sigurimit të jetës për kredi, në zbatim të nenit 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, aktivizoi procedurën e monitorimit të këtij tregu.
2. Bankat³³ janë institucione financiare, që ushtrojnë veprimtarinë bankare të pranimi të depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimin e tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të tyre si dhe veprimtari të tjera të natyrës financiare, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Aktualisht në Shqipëri operojnë 11 banka tregtare, me kapital të huaj dhe vendas.
3. Sigurimi i Jetës për Kredi është një produkt që u ofrohet individëve kredimarrës, duke shërbyer ndër të tjera edhe si garanci për bankën, por dhe për kredimarrësin, i cili mbrohet si person i siguruar.
4. Nga analiza e informacionit të mbledhur gjatë fazës së monitorimit u konstatua se, pavarësisht shpjegimeve të dërguara me shkresë nga bankat, përqindjet e tregut total të sigurimit të jetës, të raportuara nga AMF për vitin 2023, nuk reflektohen në ndarjen e portofolit të sigurimit të jetës për kredi, që shitet përmes bankave. Kjo mospërputhje e dukshme ngriti shqetësime mbi funksionimin e konkurrencës në këtë segment të tregut.

³³ https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Subjekte_te_licencuara/Banka/

5. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1130, datë 07.11.2024, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi për periudhën nga 7 nëntor 2021 deri në 7 nëntor 2024, vendim në të cilin përfshiu edhe ndërmarrjet Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA. Afati i përfundimit të hetimit paraprak, më pas, me Vendimin nr. 1159, datë 13.02.2025 u zgjat deri në 3 mars 2025.
6. Pas përfundimit të hetimit paraprak, u konkludua ndër të tjera se, sjellja e ndërmarrjeve Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA mund të përbënte shkelje të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe me Vendimin nr. 1171, datë 26.03.2025 Komisioni i Konkurrencës i hapi rrugë procedurës së hetimit të thelluar në përputhje me parashikimet ligjore për periudhën 7 nëntor 2021 – 26 Mars 2025. Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të hetimit.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

7. Sigurimi është një formë e manaxhimit të riskut që vjen nga një situatë e panjohur, një kontratë në bazë të së cilës një person/kompani, transferon rrezikun e mundshëm të një dëmi/humbje financiare tek një kompani sigurimi, përkundrejt pagesës së një shume që quhet prim sigurimi.
8. Sigurimi i Jetës për Kredi ofrohet për personat që marrin kredi në bankë dhe i mbron ata dhe familjarët nga rreziku i mos shlyerjes së hua-së si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit. Ky sigurim është një garanci financiare si për bankën (nga rreziku i mos shlyerjes së huasë si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit) ashtu edhe për kredimarrësin, personin e siguruar, duke çliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur.
9. Tregu i sigurimeve të jetës në Republikën e Shqipërisë funksionon në zbatim të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.
10. Ligji nr. 52/2014 parashikon si lloje të ndërmjetësimit, veprimtarinë e agentit dhe brokerit, duke përcaktuar se edhe bankat e nivelit të dytë mund të pajisen me licencë për të ushtruar këtë veprimtari. Konkretisht, neni 194, pika 4 parashikon se “Veprimtaria e agentit mund të kryhet edhe nga bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, si dhe subjekte të tjera, sipas rregullave të

përcaktuara nga Autoriteti” ndërsa neni 204 pika 5 parashikon se “Veprimtaria e brokerimit mund të kryhet edhe nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti”.

11. Në bazë të nenit 194 të Ligjit nr. 52/2014, veprimtaria e agjentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari. Veprimtaria e agjentit në sigurime mund të kryhet edhe në emër të disa shoqërive të sigurimit, nëse shoqëritë e sigurimit kanë rënë dakord me marrëveshje të shkruar midis tyre.
12. Lidhur me veprimtarinë e brokerimit, në bazë të nenit 202 të Ligjit nr. 52/2014, përfshin të gjitha ato veprimtari, si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t’i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij. Gjithashtu, përfshin edhe asistencën për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, veçanërisht zgjidhjen e kërkesave për dëmshpërblim nga shoqëria e sigurimit, në emër dhe për llogari të konsumatorit. Brokeri/shoqëria e brokerimit ndërmjetëson për lidhjen e kontratave të sigurimit vetëm me shoqëritë e sigurimit të licencuara.
13. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo brokër pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa me shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.
14. Referuar sa më sipër, AMF në Republikën e Shqipërisë ka A licencuar 4 banka si broker në sigurime për klasat e jetës dhe 1 bankë si agjent në sigurime të kësaj kategorie. Bankat e licencuara si broker në sigurime për klasat e jetës janë: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Tirana Bank dhe OTP Bank. Si agjent për klasat e jetës është licencuar Credins Bank. Gjithashtu, ndërmarrja E-Business Solutions është licencuar si agjent në sigurime për klasat e jetës, ndërsa ABI Broker Sigurimesh është licencuar si broker në sigurimet e jetës dhe jo-jetës. Disa banka, edhe pse jo të licencuara, kanë lidhur marrëveshje me shoqëri sigurimi për klasat e jetës, duke marrë automatikisht rolin e ndërmjetësuesit.
15. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t’i mundësuar

nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.

16. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”³⁴, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
17. Në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”³⁵, neni 7, informacioni kontraktor që duhet të japin bankat për klientët duhet të përmbajë veç të tjerave edhe, “garancitë e vendosura për të siguruar ekzekutimin e kontratës së kredisë, mënyrën e vënies së tyre në ekzekutim, dhe kontratat e sigurimit të jetës ose të pronës (kur janë të aplikueshme).
18. Mbi bazën e këtij detyrimi, klientët njihen në momentin e nënshkrimit të një kontrate kredie konsumatorë apo hipotekare me detyrimin e sigurimit të jetës, aty ku është e aplikueshme, për gjithë periudhën e mbajtjes së detyrimit. Nëpërmjet këtij detyrimi, banka sigurohet që në rast ndodhje të një ngjarjeje ndaj kredimarrësit, detyrimi i tij të mbulohet nga shoqëritë e sigurimit.
19. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës kur ka vlerësuar tregun përkatës ka marrë parasysh sjelljen e konsumatorit kredimarrës. Çfarë është më e rëndësishme për kredimarrësin, kredia (banka) apo kosto e sigurimit të jetës për kredi (primi)? Kredimarrësi kur zgjedh bankën ku do të marrë kredinë e zgjedh për arsye si: reputacioni i bankës, eksperiencia e mëparshme (llogari page apo kredi të mëparshme), norma e interesit, shpejtësia e miratimit dhe disbursimit, etj. Pra, para se të trajtohet primi i sigurimit të jetës për kredi, konsumatori e ka vendosur bankën ku do të marrë financimin. Nga sa më lart, primi është më shumë një kosto sekondare se sa një faktor vendimmarrës në vendimmarrjen për kredi.
20. Në raportin e CMA (Competition & Market Authority) të Mbretërisë së Bashkuar, “Market investigation into payment protection insurance”³⁶ (paragrafi 5.89-5.91), “**pika e shitjes**” shpjegohet në mënyrë të përmbledhur: “... Avantazhi në pikën e shitjes është përfitimi që shpërndarësit gëzojnë nga fakti që kanë qasje të vetme tek klientët në momentin kur ata po marrin kredinë e tyre.”
21. Krahasimisht, vlerësohet se një situatë e ngjashme me atë të përshkruar në raportin e CMA ekziston edhe në rastin e kredive që kërkojnë sigurim jete, pasi vendimi i konsumatorit për t’u financuar nga një bankë e caktuar merret përpara zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit. Për rrjedhojë, banka gëzon një avantazh në “pikën e shitjes”, duke qenë se ka akses të privilegjuar

³⁴ Miratuar me Vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

³⁵ Miratuar me Vendimin nr. 48 datë 01.07.2015, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

³⁶ https://webarchive.nationalarchives.gov.uk/ukgwa/20140403003432mp_/http://www.competition-commission.org.uk/assets/competitioncommission/docs/pdf/non-inquiry/rep_pub/reports/2009/fulltext/542.pdf

ndaj klientit në momentin kur ai ndodhet në procesin e marrjes së kredisë.

22. Pavarësisht se banka, nëpërmjet informacionit para-kontraktor vë në dijeni kredimarrësin për nevojën e një sigurimi jete, vendimmarrja për shoqërinë e sigurimit, marrja e ofertave nga shoqëritë e ndryshme dhe krahasimi i primeve ndodh pas aprovimit të kredisë. Në këtë mënyrë banka siguron një akses të privilegjuar tek kredimarrësi, për të zgjedhur policën e sigurimit më të preferuar për bankën.
23. Për sa më sipër, tregu përkatës i produktit është:
- i. tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në Bankën Amerikane të Investimeve (ABI);
 - ii. tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën ABI, ku ndërmjetësimin e ushtron ndërmarrja ABI Broker Sigurimesh SHA.
24. Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse, produkti i sigurimit të jetës është i detyrueshëm të blihet në momentin që banka aprovon kredinë që klienti dëshiron të marrë, atëherë si treg gjeografik do të konsiderohet vetëm territori i bankës së nivelit të dytë që ka aprovuar atë kredi. Për këtë arsye tregu gjeografik:
- i. për Bankën Amerikane të Investimeve do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë ABI Bank;
 - ii. për ndërmarrjen ABI Broker Sigurimesh do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë ABI Bank.

III. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

25. Pjesët e tregut janë një tregues i rëndësishëm në lidhje me strukturën e tregut dhe rëndësinë e ndërmarrjeve të ndryshme në treg. Megjithatë, Autoriteti interpreton pjesët e tregut në këndvështrimin e kushteve të tregut përkatës dhe në veçanti të dinamikës së tregut dhe të diferencimit të produkteve. Tendenca ose zhvillimi i pjesëve të tregut me kalimin e kohës, mund të merret në konsideratë për tregjet e paqëndrueshme ose për tregjet ofertues
26. Praktikë më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrjet zotërojnë një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës.³⁷

³⁷ Komunikim nga Komisioni Udhëzim mbi sjelljet përjashtuese, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 82 -Guidance on the Commission's enforcement priorities in applying Article 82 of the EC Treaty to abusive exclusionary conduct by dominant.

27. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” ndërmarrja:
- i. Banka Amerikane e Investimeve SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën ABI, ka pozitë dominuese;
 - ii. ABI Broker Sigurimesh SHA, në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën ABI, ka pozitë dominuese.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

28. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo broker pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa me shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.
29. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t’i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
30. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
31. Sipas nenit 102 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasja e një pozite dominuese në treg nuk është e ndaluar në vetvete. Megjithatë, kur një ndërmarrje me pozitë dominuese përdor fuqinë e saj për të kufizuar konkurrencën në mënyrë të padrejtë, ajo mund të përbëjë një abuzim, i cili është i ndaluar me ligj.
32. Neni 102 TFEU liston kategoritë tipike të sjelljeve abuzive, por këto sjellje abuzive klasifikohen zakonisht në dy kategori kryesore: Abuzime përjashtuese (exclusionary abuses)

dhe Abuzime shfrytëzuese (exploitative abuses)³⁸.

- Abuzime përjashtuese (Exclusionary abuse) i referohet sjelljeve të ndërmarrjeve me pozitë dominuese që synojnë të përjashtojnë konkurrentët nga tregu, ose të pengojnë hyrjen ose zhvillimin e tyre, jo thjesht të konkurrojnë lirshëm me to, por të kufizojnë konkurrencën në mënyrë aktive. Këto sjellje dëmtojnë strukturën konkurruese dhe, rrjedhimisht, edhe interesat afatgjata të konsumatorëve
- Abuzime shfrytëzuese (Exploitative abuse) përfshin ato abuzime kur ndërmarrja me pozitë dominuese shfrytëzon pozicionin e saj për të përfituar në mënyrë të padrejtë, zakonisht përmes çmimeve të larta apo kushteve tregtare të padrejta, pa ndikuar drejtpërdrejt mbi konkurrentët.

33. Sipas nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit mbi zbatueshmërinë e neneve 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003, një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të abuzojë me këtë pozitë nëpërmjet shitjeve të lidhura (tying) ose kushtëzimeve të padrejta, kur klientit i kërkohet që, për të marrë një produkt (në këtë rast kredinë), të blejë një produkt tjetër (sigurimin e jetës) në kushte të përcaktuara nga vetë banka.
34. Vendimi i klientit për bankën ku do të marrë kredinë merret përpara se ai të shqyrtojë ofertat për sigurimin e jetës për kredi. Kjo do të thotë se banka kontrollon pikën e shitjes (momentin vendimtar të nënshkrimit të kontratës), pra zotëron një pozitë të dominuese ndaj klientit.
35. Procesi i zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit ndodh pas miratimit të kredisë, në ambientet e bankës, ku kredimarrësi është tashmë i varur nga vendimi i bankës për disbursimin e fondeve. Kjo situatë i jep bankës fuqi të njëanshme tregu, duke i mundësuar të “shtyjë” një produkt sigurimi të caktuar nga një shoqëri sigurimi.
36. Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në nenin 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka analizuar sjelljen e Banka Amerikane e Investimeve SHA (ABI Bank) dhe të ndërmarrjes ABI Broker Sigurimesh SHA duke shqyrtuar nëse, përmes strukturës së marrëdhënies bankë-broker dhe rolit të tyre të ndërlidhur në procesin e sigurimit të jetës për kredi, këto ndërmarrje, individualisht ose si njësi ekonomike e vetme, kanë përdorur pozitën e bankës në procesin e kreditimit për të kushtëzuar, orientuar apo kufizuar zgjedhjen e kredimarrësve në lidhje me shoqërinë e sigurimit të jetës. Konkretisht, është analizuar nëse, pavarësisht ekzistencës formale të marrëveshjeve me disa shoqëri sigurimi, organizimi i brendshëm i procesit, mungesa e procedurave të detajuara dhe të dokumentuara për paraqitjen e ofertave, si dhe incentivat ekonomike të lidhura me komisionet e brokerimit, mund të kenë

³⁸ <https://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=a940ed59-46d6-4932-a2cc-2fb52618f387>

krijuar një përqendrim të konsiderueshëm të policave pranë një ose disa shoqërive të caktuara sigurimi, me efekte potencialisht kufizuese për konkurrencën brenda këtij tregu përkatës.

37. Sigurimi i jetës së kredimarrësit në ABI Bank SHA është i detyrueshëm për kreditë ndaj individëve, të llojit kredi konsumatore me apo pa kolateral, kreditë hipotekare për blerje pasurie të patundshme, dyqane apo toka. Për kreditë ndaj subjekteve tregtare, sigurimi i jetës nuk është i detyrueshëm. Sipas ABI Bank SHA sigurimi i jetës kryhet nga ndërmarrja ABI Broker Sigurimesh SHA dhe jo nga vetë banka.
38. ABI Broker Sigurimesh SHA është e licensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me vendim nr. 246, datë 20.12.2018 për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime për klientët e bankës ABI Bank, në klasat e jetës dhe jo-jetës. Ndërmarrja e brokerimit në fjalë, lidh me klientin përkatës një kontratë ndërmjetësimi ku individ i që kërkon të sigurohet, përcakton vetë shoqërinë e sigurimit me të cilën do të lidhë kontratë. Sipas informacionit të dërguar nga ABI Bank mbi ofrimin e produktit të sigurimit të jetës, nëpërmjet ndërmarrjes ABI Broker Sigurimesh SHA, klienti para nënshkrimit pajiset me informacionin parakontraktor, në të cilin specifikohen të dhënat mbi shoqëritë e sigurimit, kushtet e marrjes në sigurim, peshën që zë secila shoqëri në treg, të dhënat financiare, peshën e dëmeve të paguara etj.
39. Ndërmarrja ABI Broker Sigurimesh SHA ka sqaruar se, ka kontrata aktive të lidhura me shoqëritë e sigurimit për të ofruar produktin e sigurimit të jetës për klientët kredimarrës. ABI Broker ka kontrata me shoqëritë e sigurimit: Sicred SHA, Sigal Uniq Group Austria SHA dhe Albsig Jetë SHA.
40. Kontratat në fjalë ndërmjet ABI Broker Sigurimesh SHA dhe shoqërive të sigurimit të jetës përfshijnë:
 - a. Kushte të përgjithshme të cilat janë të njëjta në të gjitha kontratat, përsa i përket kohëzgjatjes, rinovimit të kontratës dhe politikave të ndjekura për përfitimin e produktit të sigurimit të jetës të kredimarrësit.
 - b. Për secilën kontratë neni 8 i kontratës përcakton komisionin që shoqëria e brokerimit merr me prerjen e policave të sigurimit të jetës. Përkatësisht, në kontratën me shoqërinë Sigal Life SHA, siguresi ka detyrimit të paguaje brokerit vlerën e komisionit të ndërmjetësimit në masën 15% të primit pa taksë; në kontratën me shoqërinë Albsig Jetë SHA, brokeri përfiton komision 25% për çdo policë të prerë sigurimi jete si edhe përfiton shpërblim vjetor në rast se vlerat e policave të ndërmjetësuar prej tij gjatë një viti financiar kalojnë vlerën prej 300.000 Euro; në kontratën me shoqërinë Sicred SHA, siguresi ka detyrimit të paguaje brokerit vlerën e komisionit të ndërmjetësimit në masën 25% të primit pa taksë.
 - c. Në kontrata parashikohet që vlera e komisioneve në raste të veçanta mund të jetë e

ndryshme nga ajo e përcaktuar në kontratë, por kjo varet rast pas rasti.

41. Gjatë periudhës hetimore, rezulton se klientët kredimarrës pranë bankës ABI kanë prerë policat e sigurimit të jetës si në vijim: Sigal Life me XXX%, ndjekur nga Albsig Jetë me XXX%, Sicred me XXX% dhe së fundmi Insig Jetë me vetëm XXX% (vetëm një policë e prerë).
42. Volumi më i madh i komisioneve të përfuara vjen nga bashkëpunimi që kryhet me shoqërinë Sigal, me XXX% të totalit të rakordimeve, XXX% në lekë dhe XXX% në euro. Edhe pse për policat në dollarë amerikan përfiton XXX% të komisioneve po nga shoqëria e sigurimeve Sigal, këto janë shuma të vogla që nuk e kalojnë XXX USD/vit.
43. Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit, në formë shkresore apo prova të administruara gjatë inspektimeve, rezulton se ka dokumente që tregojnë procedurën e sigurimit të jetës nga ana e ndërmarrjes ABI Broker Sigurimesh SHA si broker. Sipas kësaj shoqërie, materiali “Rregulla për ndërmjetësim në sigurimin e pronës dhe jetës për klientët e kredive të ABI Bank” tregon të gjithë informacionet dhe kushtet e sigurimit me ndërmjetës ABI Broker Sigurimesh SHA. Gjithashtu, ndërmarrja e brokerimit ka një formular informues që i paraqet klientit, i cili nënshkruhet nga klienti në përzgjedhjen e shoqërisë së sigurimit të jetës nga vetë ai.
44. Referuar të dhënave të regjistrit tregtar për ndërmarrjen ABI Bank SHA dhe ABI Broker Sigurimesh SHA konstatohet se, ndërmarrja ABI Broker Sigurimesh SHA ka aksionar të vetëm ABI Bank SHA që zotëron 100% të 3500 kuotave të aksioneve në ABI Broker Sigurimesh SHA.
45. Në acquis të BE-se, koncepti i “grupim të ndërmarrjeve” është i unifikuar dhe shfaqet si në vijim:
 - Preambula 37 e Rregullores (BE) 2016/679 (GDPR): *“Një grupim ndërmarrjesh duhet të përfshijë një ndërmarrje kontrolluese dhe ndërmarrjet e kontrolluara prej saj, ku ndërmarrja kontrolluese duhet të jetë ajo ndërmarrje që mund të ushtrojë ndikim dominues mbi ndërmarrjet e tjera përmes, për shembull, pronësisë, pjesëmarrjes financiare, rregullave që e rregullojnë atë, ose fuqisë për t’i zbatuar...”*.
 - Doktrina e “Njësisë Ekonomike të Vetme” (Single Economic Entity) është e njohur gjerësisht në të drejtën e konkurrencës evropiane, dhe gjen zbatim dhe në arsyetimet e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED), lidhur me shkelje të rregullave të konkurrencës:
 - i. Në *Akzo Nobel NV v Commission (C-97/08 P)*, Gjykata u shpreh se pranohet që një kompani mëmë dhe një kompani e kontrolluar plotësisht mund të trajtohen si një “njësi ekonomike e

- vetme” kur mëma ushtron ndikim vendimtar mbi bijën. Kjo qasje lejon që të dyja entitetet të trajtohen bashkërisht në kuptim të ligjit të konkurrencës, pa kërkuar prova të kontrollit të drejtpërdrejtë, duke supozuar se pronësia e plotë e nënkupton këtë ndikim. (para 58-61).
- ii. Në *Sumal SL v Mercedes Benz Trucks España (C-882/19)*, Gjykata vendosi se përgjegjësia për shkelje të konkurrencës mund të shtrihet brenda grupit, pavarësisht se janë juridikisht të ndara, nëse veprojnë me një qëllim të përbashkët ekonomik në treg. (para 4-44).
46. Në rastin e ABI Bank SHA dhe ABI Broker Sigurimesh SHA, kjo e fundit është në pronësi të plotë të ABI Bank SHA, duke e bërë lidhjen e tyre një formë klasike të marrëdhënies mëmë–bijë dhe për pasojë një njësi të vetme ekonomike.
47. Nga të dhënat e administruara nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, nuk u vunë re oferta fizike të të gjitha kompanive për klientët e kësaj banke. Sipas ABI Broker/ABI Bank, si edhe duke parë dokumentacionin e shoqërive të sigurimit si edhe dokumentacionet e administruara gjatë inspektimeve në terren, ofertat e sigurimit të jetës kryhen verbalisht, me anë të telefonatave, ose komunikohen gjatë takimeve që klienti ka me përfaqësues të bankës në momentin e paraqitjes së formularit të sigurimit të jetës.
48. Megjithatë, edhe pse përqendrimi i lartë i policave të sigurimit në dy shoqëri sigurimi dhe faktet e mbledhura sugjerojnë ekzistencën e një sjelljeje potencialisht përjashtuese në treg, provat e administruara nuk janë të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë të shkeljes së nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Në veçanti, nuk rezulton të jetë provuar se orientimi i klientëve ka qenë rezultat i një detyrimi de facto të imponuar nga banka, apo se efektet e konstatuara përbëjnë kufizim të provuar dhe të drejtpërdrejtë të konkurrencës në shkallë të tillë sa të konsiderohet shkelje e nenit 9 të Ligjit nr.9121/2003.
49. Pavarësisht se ABI Broker Sigurimesh SHA ka aplikuar komisione të ndryshme për prerjen e primeve të sigurimit të jetës, të cilat nuk reflektojnë përfitim të drejtpërdrejtë për konsumatorët dhe rrisin koston e shërbimit, nga analiza e të dhënave të administruara nuk rezulton të jenë të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë se banka ka imponuar kushte të padrejta apo ka kryer praktika të abuzimit shfrytëzues në kuptim të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003. Ajo që evidentohet qartë, është nevoja për një rregullim më të mirë procedural, eliminimi i ofertave financiare në mënyrë verbale nëpërmjet dokumentimit me shkrim dhe ruajtja e tyre në dosjen e kredisë duke bërë procesin sa më të saktë dhe më transparent në lidhje me mënyrën sesi bëhet përzgjedhja e shoqërisë së sigurimit nga kredi marrësi duke limituar në maksimum hapësirat për sjellje anti konkurruese.
50. Në përfundim, me gjithë ekzistencën e dyshimeve, për sa i përket Bankës Amerikane të Investimeve SHA, nëpërmjet aktivitetit të ABI Broker Sigurimesh SHPK, mes të ciliave ka

pronësi aksionare të përbashkët, nuk ka prova të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë që në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën ABI, të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

51. Në përfundim, nuk ka prova të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë që sjellja e ndërmarrjes ABI Broker Sigurimesh SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën ABI, të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 26, nenin 43, pika 5 dhe nenin 45, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Banka Amerikane e Investimeve SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në këtë bankë.
- II. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes ABI Broker Sigurimesh SHPK në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në Banka Amerikane e Investimeve SHA, ku ndërmjetësimin e ushtron ndërmarrja ABI Broker Sigurimesh SHA.
- III. Detyrimin e ndërmarrjeve Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe ABI Broker Sigurimesh SHPK që brenda 60 ditëve, të hartojë dhe zbatojë, për çdo kredimarrës një formular të vetëm, në të cilin të pasqyrohen ofertat e të gjitha shoqërive të sigurimit, sipas propozimit të primit nga secila shoqëri sigurimi; formulari në fjalë duhet të ketë në faqen e parë, me shkrim të dukshëm, pa numër rendor emrin e secilës shoqëri sigurimi jete dhe në vijim të emrit, vlerën e primit sipas koeficienteve përkatës dhe përzgjedhjen e kredimarrësit. Ky formular duhet të nënshkruhet nga të dy palët, banka dhe kredimarrësi, dhe të ruhet si pjesë përbërëse e dosjes së kredisë e aksesueshme në çdo moment nga Autoriteti i Konkurrencës.
- IV. Detyrimin e ndërmarrjes Banka Amerikane e Investimeve SHA që brenda 30 ditëve, në kuadër të informacionit parakontraktor të dorëzuar çdo kredimarrësi, të përfshijë një njoftim të qartë, të shkruar dhe të plotë mbi përpunimin e të dhënave personale për qëllimet e vlerësimit dhe verifikimit të sjelljes së bankës në treg, përfshirë dhe aksesin dhe përpunimin e të dhënave

nga Autoriteti i Konkurrencës, në rast monitorimi, hetimi paraprak apo hetimi të thelluar ndaj bankës.

- V. Detyrimin e ndërmarrjeve Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe ABI Broker Sigurimesh SHPK të raportojë në çdo kohë që do kërkohet, pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi mënyrën e zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi duke paraqitur çdo dokument që konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti i Konkurrencës për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi.
- VI. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrjet Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe ABI Broker Sigurimesh SHPK, në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohen me penalitetin përkatës.
- VII. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për një periudhë 1 vjeçare.
- VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1267, Datë 20.02.2026

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES OTP BANK ALBANIA SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË OTP BANK ALBANIA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar dhe dhënia e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes OTP Bank Albania SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në OTP Bank Albania.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 26, neni 43, pika 5 dhe neni 45 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredithënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker

Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.”;

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur

1. Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të një ankese të depozituar më datë 30 korrik 2024, mbi dyshimin për pengim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në tregun e sigurimit të jetës për kredi, në zbatim të nenit 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, aktivizoi procedurën e monitorimit të këtij tregu.
2. Bankat³⁹ janë institucione financiare, që ushtrojnë veprimtarinë bankare të pranimi të depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimin e tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të tyre si dhe veprimtari të tjera të natyrës financiare, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Aktualisht në Shqipëri operojnë 11 banka tregtare, me kapital të huaj dhe vendas.
3. Sigurimi i Jetës për Kredi është një produkt që u ofrohet individëve kredimarrës, duke shërbyer ndër të tjera edhe si garanci për bankën, por dhe për kredimarrësin, i cili mbrohet si person i siguruar.
4. Nga analiza e informacionit të mbledhur gjatë fazës së monitorimit u konstatua se, pavarësisht shpjegimeve të dërguara me shkresë nga bankat, përqindjet e tregut total të sigurimit të jetës, të raportuara nga AMF për vitin 2023, nuk reflektohen në ndarjen e portofolit të sigurimit të jetës për kredi, që shitet përmes bankave. Kjo mospërputhje e dukshme ngriti shqetësime mbi funksionimin e konkurrencës në këtë segment të tregut.
5. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1130, datë 07.11.2024, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi për periudhën nga 7 nëntor 2021 deri në 7 nëntor 2024, vendim në të cilin përfshiu edhe ndërmarrjen OTP Bank SHA. Afati i përfundimit të hetimit paraprak, më pas, me Vendimin nr. 1159, datë 13.02.2025 u zgjat deri në 3 mars 2025.
6. Pas përfundimit të hetimit paraprak, u konkludua ndër të tjera se, sjellja e ndërmarrjes OTP Bank SHA mund të përbënte shkelje të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen

³⁹ https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Subjekte_te_licencuara/Banka/

e konkurrencës” dhe me Vendimin nr. 1171, datë 26.03.2025 Komisioni i Konkurrencës i hapi rrugë procedurës së hetimit të thelluar në përputhje me parashikimet ligjore për periudhën 7 nëntor 2021 – 26 Mars 2025. Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të hetimit.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

7. Sigurimi është një formë e manaxhimit të riskut që vjen nga një situatë e panjohur, një kontratë në bazë të së cilës një person/kompani, transferon rrezikun e mundshëm të një dëmi/humbje financiare tek një kompani sigurimi, përkundrejt pagesës së një shume që quhet prim sigurimi.
8. Sigurimi i Jetës për Kredi ofrohet për personat që marrin kredi në bankë dhe i mbron ata dhe familjarët nga rreziku i mos shlyerjes së hua-së si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit. Ky sigurim është një garanci financiare si për bankën (nga rreziku i mos shlyerjes së huasë si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit) ashtu edhe për kredimarrësin, personin e siguruar, duke çliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur.
9. Tregu i sigurimeve të jetës në Republikën e Shqipërisë funksionon në zbatim të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.
10. Ligji nr. 52/2014 parashikon si lloje të ndërmjetësimit, veprimtarinë e agentit dhe brokerit, duke përcaktuar se edhe bankat e nivelit të dytë mund të pajisen me licencë për të ushtruar këtë veprimtari. Konkretisht, neni 194, pika 4 parashikon se “Veprimtaria e agentit mund të kryhet edhe nga bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, si dhe subjekte të tjera, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti” ndërsa neni 204 pika 5 parashikon se “Veprimtaria e brokerimit mund të kryhet edhe nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti”.
11. Në bazë të nenit 194 të Ligjit nr. 52/2014, veprimtaria e agentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari. Veprimtaria e agentit në sigurime mund të kryhet edhe në emër të disa shoqërive të sigurimit, nëse shoqëritë e sigurimit kanë rënë dakord me marrëveshje të shkruar midis tyre.

12. Lidhur me veprimtarinë e brokerimit, në bazë të nenit 202 të Ligjit nr. 52/2014, përfshin të gjitha ato veprimtari, si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij. Gjithashtu, përfshin edhe asistencën për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, veçanërisht zgjidhjen e kërkesave për dëmshpërblim nga shoqëria e sigurimit, në emër dhe për llogari të konsumatorit. Brokëri/shoqëria e brokerimit ndërmjetëson për lidhjen e kontratave të sigurimit vetëm me shoqëritë e sigurimit të licencuara.
13. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo brokër pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa me shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.
14. Referuar sa më sipër, AMF në Republikën e Shqipërisë ka A licensuar 4 banka si broker në sigurime për klasat e jetës dhe 1 bankë si agjent në sigurime të kësaj kategorie. Bankat e licencuara si broker në sigurime për klasat e jetës janë: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Tirana Bank dhe OTP Bank. Si agjent për klasat e jetës është licencuar Credins Bank. Gjithashtu, ndërmarrja E-Business Solutions është licencuar si agjent në sigurime për klasat e jetës, ndërsa ABI Broker Sigurimesh është licencuar si broker në sigurimet e jetës dhe jo-jetës. Disa banka, edhe pse jo të licencuara, kanë lidhur marrëveshje me shoqëri sigurimi për klasat e jetës, duke marrë automatikisht rolin e ndërmjetësuesit.
15. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
16. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”⁴⁰, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.

⁴⁰ Miratuar me Vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

17. Në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”⁴¹, neni 7, informacioni kontraktor që duhet të japin bankat për klientët duhet të përmbajë veç të tjerave edhe, “garancitë e vendosura për të siguruar ekzekutimin e kontratës së kredisë, mënyrën e vënies së tyre në ekzekutim, dhe kontratat e sigurimit të jetës ose të pronës (kur janë të aplikueshme).
18. Mbi bazën e këtij detyrimi, klientët njihen në momentin e nënshkrimit të një kontrate kredie konsumatorë apo hipotekare me detyrimin e sigurimit të jetës, aty ku është e aplikueshme, për gjithë periudhën e mbajtjes së detyrimit. Nëpërmjet këtij detyrimi, banka sigurohet që në rast ndodhje të një ngjarjeje ndaj kredimarrësit, detyrimi i tij të mbulohet nga shoqëritë e sigurimit.
19. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës kur ka vlerësuar tregun përkatës ka marrë parasysh sjelljen e konsumatorit kredimarrës. Çfarë është më e rëndësishme për kredimarrësin, kredia (banka) apo kosto e sigurimit të jetës për kredi (primi)? Kredimarrësi kur zgjedh bankën ku do të marrë kredinë e zgjedh për arsye si: reputacioni i bankës, eksperiencia e mëparshme (llogari page apo kredi të mëparshme), norma e interesit, shpejtësia e miratimit dhe disbursimit, etj. Pra, para se të trajtohet primi i sigurimit të jetës për kredi, konsumatori e ka vendosur bankën ku do të marrë financimin. Nga sa më lart, primi është më shumë një kosto sekondare se sa një faktor vendimmarrës në vendimmarrjen për kredi.
20. Në raportin e CMA (Competition & Market Authority) të Mbretërisë së Bashkuar, “Market investigation into payment protection insurance”⁴² (paragrafi 5.89-5.91), **“pika e shitjes”** shpjegohet në mënyrë të përmbledhur: “... Avantazhi në pikën e shitjes është përfitimi që shpërndarësit gëzojnë nga fakti që kanë qasje të vetme tek klientët në momentin kur ata po marrin kredinë e tyre.”
21. Krahasimisht, vlerësohet se një situatë e ngjashme me atë të përshkruar në raportin e CMA ekziston edhe në rastin e kredive që kërkojnë sigurim jete, pasi vendimi i konsumatorit për t’u financuar nga një bankë e caktuar merret përpara zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit. Për rrjedhojë, banka gëzon një avantazh në “pikën e shitjes”, duke qenë se ka akses të privilegjuar ndaj klientit në momentin kur ai ndodhet në procesin e marrjes së kredisë.
22. Pavarësisht se banka, nëpërmjet informacionit para-kontraktor vë në dijeni kredimarrësin për nevojën e një sigurimi jete, vendimmarrja për shoqërinë e sigurimit, marrja e ofertave nga shoqëritë e ndryshme dhe krahasimi i primeve ndodh pas aprovimit të kredisë. Në këtë mënyrë banka siguron një akses të privilegjuar tek kredimarrësi, për të zgjedhur policën e sigurimit më të preferuar për bankën.

⁴¹ Miratuar me Vendimin nr. 48 datë 01.07.2015, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

⁴² https://webarchive.nationalarchives.gov.uk/ukgwa/20140403003432mp_/http://www.competition-commission.org.uk/assets/competitioncommission/docs/pdf/non-inquiry/rep_pub/reports/2009/fulltext/542.pdf

23. Për sa më sipër, tregu përkatës i produktit është: tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën OTP Bank Albania.
24. Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse, produkti i sigurimit të jetës është i detyrueshëm të blihet në momentin që banka aprovon kredinë që klienti dëshiron të marrë, atëherë si treg gjeografik do të konsiderohet vetëm territori i bankës së nivelit të dytë që ka aprovuar atë kredi. Për këtë arsye, tregu gjeografik për OTP Bank Albania do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë OTP Bank Albania SHA.

III. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

25. Pjesët e tregut janë një tregues i rëndësishëm në lidhje me strukturën e tregut dhe rëndësinë e ndërmarrjeve të ndryshme në treg. Megjithatë, Autoriteti interpreton pjesët e tregut në këndvështrimin e kushteve të tregut përkatës dhe në veçanti të dinamikës së tregut dhe të diferencimit të produkteve. Tendencia ose zhvillimi i pjesëve të tregut me kalimin e kohës, mund të merret në konsideratë për tregjet e paqëndrueshme ose për tregjet ofertues
26. Praktikë më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrjet zotërojnë një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës.⁴³
27. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndërmarrja OTP Bank Albania SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën OTP Bank Albania SHA, ka pozitë dominuese.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes në tregun përkatës

28. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo broker pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit

⁴³ Komunikim nga Komisioni Udhëzim mbi sjelljet përjashtuese, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 82 -Guidance on the Commission's enforcement priorities in applying Article 82 of the EC Treaty to abusive exclusionary conduct by dominant.

të jetës për kredi, por të vijojë sa me shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.

29. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
30. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
31. Sipas nenit 102 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasja e një pozite dominuese në treg nuk është e ndaluar në vetvete. Megjithatë, kur një ndërmarrje me pozitë dominuese përdor fuqinë e saj për të kufizuar konkurrencën në mënyrë të padrejtë, ajo mund të përbëjë një abuzim, i cili është i ndaluar me ligj.
32. Neni 102 TFEU liston kategoritë tipike të sjelljeve abuzive, por këto sjellje abuzive klasifikohen zakonisht në dy kategori kryesore: Abuzime përjashtuese (exclusionary abuses) dhe Abuzime shfrytëzuese (exploitative abuses)⁴⁴.
- Abuzime përjashtuese (Exclusionary abuse) i referohet sjelljeve të ndërmarrjeve me pozitë dominuese që synojnë të përjashtojnë konkurrentët nga tregu, ose të pengojnë hyrjen ose zhvillimin e tyre, jo thjesht të konkurrojnë lirshëm me to, por të kufizojnë konkurrencën në mënyrë aktive. Këto sjellje dëmtojnë strukturën konkurruese dhe, rrjedhimisht, edhe interesat afatgjata të konsumatorëve
 - Abuzime shfrytëzuese (Exploitative abuse) përfshin ato abuzime kur ndërmarrja me pozitë dominuese shfrytëzon pozicionin e saj për të përfutur në mënyrë të padrejtë, zakonisht përmes çmimeve të larta apo kushteve tregtare të padrejta, pa ndikuar drejtpërdrejt mbi konkurrentët.
33. Sipas nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit mbi zbatueshmërinë e neneve 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003, një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të abuzojë me këtë pozitë nëpërmjet shitjeve të lidhura (tying) ose kushtëzimeve të padrejta, kur klientit i kërkohet që, për të marrë një produkt (në këtë rast kredinë), të blejë një produkt tjetër (sigurimin e jetës) në kushte të përcaktuara nga vetë banka.

⁴⁴ <https://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=a940ed59-46d6-4932-a2cc-2fb52618f387>

34. Vendimi i klientit për bankën ku do të marrë kredinë merret përpara se ai të shqyrtojë ofertat për sigurimin e jetës për kredi. Kjo do të thotë se banka kontrollon pikën e shitjes (momentin vendimtar të nënshkrimit të kontratës), pra zotëron një pozitë të dominuese ndaj klientit.
35. Procesi i zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit ndodh pas miratimit të kredisë, në ambientet e bankës, ku kredimarrësi është tashmë i varur nga vendimi i bankës për disbursimin e fondeve. Kjo situatë i jep bankës fuqi të njëanshme tregu, duke i mundësuar të “shtyjë” një produkt sigurimi të caktuar nga një shoqëri sigurimi.
36. Autoriteti i Konkurrencës, në analizën e sjelljes së OTP Bank Albania SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë që kërkojnë sigurim jete, ka vlerësuar nëse OTP Bank Albania SHA, në cilësinë e ofruesit të kredisë (produkt lidhës), ka përdorur pozitën e saj për të kushtëzuar ose ndikuar zgjedhjen e klientëve në lidhje me blerjen e sigurimit të jetës (produkt i lidhur). Konkretisht, është shqyrtuar nëse banka, ndonëse kanë marrëveshje bashkëpunimi me disa shoqëri sigurimi jete, në praktikë, për shkak të mungesës së procedurave të sakta, hapësirave ligjore, apo me qëllim kanë orientuar pjesën më të madhe të klientëve drejt një ose disa shoqërive të caktuara sigurimi, duke krijuar përqendrim të larta të policave të prera në këto shoqëri. Si rrjedhojë, banka mund të ketë përdorur pozitën e saj dominuese për të ndikuar në tregun e sigurimit të jetës për kredi, duke kufizuar konkurrencën ndërmjet shoqërive të sigurimit dhe duke reduktuar zgjedhjen reale të konsumatorëve kredimarrës.
37. Ndërmarrja OTP Bank Albania është e licensuar si Broker në Sigurime për klasat e Jetës dhe Jo-Jetës nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me Vendimin nr. 134, datë 28.07.2023, dhe ka filluar të ushtrojë aktivitetin e Ndërmjetësimit në Sigurime për klientët kredimarrës më datë 25 Janar 2024.
38. Sigurimi i jetës është i detyrueshëm për të gjithë klientët kredimarrës të bankës OTP.
39. OTP Bank për të ushtruar veprimtarinë e brokerimit në sigurime ka lidhur kontrata bashkëpunimi me 4 shoqëri sigurimi për produktet e jetës, ku komisioni i brokerimit është XXX% me kompanitë Sigal Life SHA, Albsig Jetë SHA, Sicred SHA dhe Insig Jetë SHA.
40. Në kontratën e kredisë bankare të lidhur ndërmjet bankës dhe kredimarrësit, në Kapitulli C, Pika 2, parashikon se: “Kredimarrësi merr përsipër të lidhe me shoqëri sigurimesh të pranueshme për Bankën një (apo disa) kontrate sigurimi (referuar në këtë kontratë si “Kontrata e Sigurimit”) sipas së cilës Kredimarrësi do të beje sigurimin e (1) jetës në masën 100% të shumës së kredisë dhe (2) të pronës së rënduar me barrë hipoteke në masën 110% të shumës së kredisë, dhe ta mbaje një kontratë të tillë të vlefshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj

kontrate kredie. Pika 2 e kapitullit C, në mënyrën sesi është konceptuar në kontratat e kredisë i imponon kredimarrësit sigurimin e jetës tek një nga shoqëritë e sigurimit të pranuar nga banka, duke kufizuar zgjedhjen vetëm tek një listë e paracaktuar. Mekanizmi që krijohet është i ngjashëm me tying/bundling të detyruar duke krijuar një praktikë që ul presionin konkurrues mbi shoqëritë e sigurimit. Për më tepër ky kufizim redukton fuqinë e negocimit të kredimarrësit, rrit mundësinë e primeve më të larta të sigurimit dhe çënon transparencën që kërkohet nga parimet e tregut të lirë. Në përputhje me standartet e BE-së, DG Comp etj, klienti duhet të ketë të drejtë të zgjedhë lirisht ofruesin e sigurimit për sa kohë polica e sigurimit plotëson kushtet e riskut të kërkuara nga banka. Pavarësisht ekzistencës së këtij neni, nuk është evidentuar asnjë rast ku ky nen të jetë përdorur në praktikë për të shmangur konkurrencën midis shoqërive të sigurimit pasi banka ka marrëveshje me të tëra shoqëritë e sigurimit, por një nen i tillë, sugjerohet të mos jetë pjesë e kontratës së kredisë.

41. Gjatë periudhës hetimore, rezulton se klientët kredimarrës pranë bankës OTP kanë prerë policat e sigurimit të jetës si në vijim: Albsig Jetë me XXX%, ndjekur nga Sigal Life me XXX%, Sicred me XXX% dhe së fundmi Insig Jetë me vetëm XXX%.
42. Në rakordimet e OTP Bank me ndërmarrjet e sigurimit të jetës, konstatohet se volumi më i madh i rakordimeve kryhet me ndërmarrjen Albsig Jetë SHA për vitet 2024 me XXX% dhe 2025 me XXX%. Ndërkohë që ndërmarrjet, Insig SHA, Sicred SHA dhe Sigal SHA kanë një volum rakordimesh si në lekë dhe euro, më të vogël në krahasim me Albsig SHA.
43. Banka ka nisur aktivitetin e saj të brokerimit në sigurime gradualisht gjatë vitit 2024 dhe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me të gjitha shoqëritë kryesore të sigurimit të jetës që operojnë në treg, (Sigal Life SHA, Albsig Jetë SHA, Sicred SHA dhe Insig Jetë SHA).
44. Nga të dhënat e administruara rezulton se numri i policave të prera është i shpërndarë midis të katër shoqërive të sigurimit që banka OTP ka kontrata bashkëpunimi, gjë që tregon një konkurrencë të hapur dhe mos pasja e vetëm një shoqërie sigurimi (Albsig Jetë përbën XXX% të numrit total të policave të sigurimit të shitura të bankës OTP, më pas Sigal Life me XXX%, Sicred me XXX% dhe Insig Jetë me XXX%). Kjo lloj shpërndarjeje tregon se banka nuk shfrytëzon pozicionin e saj për të orientuar klientët drejt një shoqërie të veçantë apo për të përjashtuar konkurrentët.
45. Dispozita e pikës 2, të Kapitullit C të kontratës së kredisë që “Kredimarrësi merr përsipër të lidhe me shoqëri sigurimesh të pranueshme për Bankën një (apo disa) kontrate sigurimi (referuar ne këtë kontrate si “Kontrata e Sigurimit”) sipas së cilës Kredimarrësi do të beje sigurimin e (1) jetës në masën 100% të shumës së kredisë”, krijojnë indicie mbi mundësinë që

banka mund të të ketë shfrytëzuar pozitën e saj për të kushtëzuar konsumatorët dhe për të kufizuar konkurrencën efektive në tregun e sigurimit të jetës.

46. Elementët e administruar gjatë hetimit nuk janë të mjaftueshëm që të krijojnë bindje të shkeljes së nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Në kushtet kur ka marrëveshje me të katërta shoqëritë që ofrojnë sigurim jete në treg, nuk arrihet të faktohet në mënyrë të drejtpërdrejtë se sjellja e bankës ka prodhuar efekt përjashtues ose shfrytëzues të konsumatorit në nivel të tillë që të mund të karakterizohet si abuzim i provuar. Ajo që evidentohet qartë, është nevoja për një rregullim më të mirë procedural, eliminimi i ofertave financiare në mënyrë verbale nëpërmjet dokumentimit me shkrim dhe ruajtja e tyre në dosjen e kredisë duke bërë procesin sa më të saktë dhe më transparent në lidhje me mënyrën sesi bëhet përzgjedhja e shoqërisë së sigurimit nga kredi marrësi duke limituar në maksimum hapësirat për sjellje antikonkurruese.
47. Në përfundim, me gjithë ekzistencën e dyshimeve, nuk ka prova të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë që në tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën OTP Bank Albania SHA të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 26, nenin 43, pika 5 dhe nenin 45, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes OTP Bank Albania SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në OTP Bank Albania.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes OTP Bank Albania SHA që brenda 60 ditëve të hartojë dhe zbatojë, për çdo kredimarrës një formular të vetëm, në të cilin të pasqyrohen ofertat e të gjitha shoqërive të sigurimit, sipas propozimit të primit nga secila shoqëri sigurimi; formulari në fjalë duhet të ketë në faqen e parë, me shkrim të dukshëm, pa numër rendor emrin e secilës shoqëri sigurimi jete dhe në vijim të emrit, vlerën e primit sipas koeficienteve përkatës dhe përzgjedhjen e kredimarrësit. Ky formular duhet të nënshkruhet nga të dy palët, banka dhe kredimarrësi, dhe të ruhet si pjesë përbërëse e dosjes së kredisë e aksesueshme në çdo moment nga Autoriteti i Konkurrencës.

- III. Detyrimin e ndërmarrjes OTP Bank Albania SHA që brenda 30 ditëve të ndryshojë parashikimin e Kapitullit C, pika 2, në Kontratën e kredisë bankare, duke i cilësuar kredimarrësit të drejtën e këtij të fundit për të siguruar jetën në secilën nga shoqëritë e sigurimit të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
- IV. Detyrimin e ndërmarrjes OTP Bank Albania SHA që brenda 30 ditëve, në kuadër të informacionit parakontraktor të dorëzuar çdo kredimarrësi, të përfshijë një njoftim të qartë, të shkruar dhe të plotë mbi përpunimin e të dhënave personale për qëllimet e vlerësimit dhe verifikimit të sjelljes së bankës në treg, përfshirë dhe aksesin dhe përpunimin e të dhënave nga Autoriteti i Konkurrencës, në rast monitorimi, hetimi paraprak apo hetimi të thelluar ndaj bankës.
- V. Detyrimin e ndërmarrjes OTP Bank Albania SHA të raportojë në çdo kohë që do kërkohet, pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi mënyrën e zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi duke paraqitur çdo dokument që konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti i Konkurrencës për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi.
- VI. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja OTP Bank Albania SHA, në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.
- VII. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për një periudhë 1 vjeçare.
- VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1268, Datë 20.02.2026

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES RAIFFEISEN BANK SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË RAIFFEISEN”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar dhe dhënia e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Raiffeisen Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në Raiffeisen.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 26, neni 43, pika 5 dhe neni 45 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

-Raportit të hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.;

-Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA”;

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të një ankese të depozituar më datë 30 korrik 2024, mbi dyshimin për pengim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në tregun e sigurimit të jetës për kredi, në zbatim të nenit 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, aktivizoi procedurën e monitorimit të këtij tregu.
2. Bankat⁴⁵ janë institucione financiare, që ushtrojnë veprimtarinë bankare të pranimit të depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimin e tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të tyre si dhe veprimtari të tjera të natyrës financiare, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Aktualisht në Shqipëri operojnë 11 banka tregtare, me kapital të huaj dhe vendas.
3. Sigurimi i Jetës për Kredi është një produkt që u ofrohet individëve kredimarrës, duke shërbyer ndër të tjera edhe si garanci për bankën, por dhe për kredimarrësin, i cili mbrohet si person i siguruar.
4. Nga analiza e informacionit të mbledhur gjatë fazës së monitorimit u konstatua se, pavarësisht shpjegimeve të dërguara me shkresë nga bankat, përqindjet e tregut total të sigurimit të jetës, të raportuara nga AMF për vitin 2023, nuk reflektohen në ndarjen e portofolit të sigurimit të jetës për kredi, që shitet përmes bankave. Kjo mospërputhje e dukshme ngriti shqetësime mbi funksionimin e konkurrencës në këtë segment të tregut.
5. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1130, datë 07.11.2024, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi për periudhën nga 7 nëntor 2021 deri në 7 nëntor 2024, vendim në të cilin përfshiu edhe ndërmarrjen Raiffeisen Bank SHA. Afati i përfundimit të hetimit paraprak, më pas, me Vendimin nr. 1159, datë 13.02.2025 u zgjat deri në 3 mars 2025.
6. Pas përfundimit të hetimit paraprak, u konkludua ndër të tjera se, sjellja e ndërmarrjes Raiffeisen Bank SHA mund të përbënte shkelje të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe me Vendimin nr. 1171, datë 26.03.2025 Komisioni i Konkurrencës i hapi rrugë procedurës së hetimit të thelluar në përputhje me parashikimet ligjore për periudhën 7 nëntor 2021 – 26 Mars 2025. Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të

⁴⁵ https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Subjekte_te_licencuara/Banka/

Konkurrencës ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të hetimit.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

7. Sigurimi është një formë e manaxhimit të riskut që vjen nga një situatë e panjohur, një kontratë në bazë të së cilës një person/kompani, transferon rrezikun e mundshëm të një dëmi/humbje financiare tek një kompani sigurimi, përkundrejt pagesës së një shume që quhet prim sigurimi.
8. Sigurimi i Jetës për Kredi ofrohet për personat që marrin kredi në bankë dhe i mbron ata dhe familjarët nga rreziku i mos shlyerjes së hua-së si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit. Ky sigurim është një garanci financiare si për bankën (nga rreziku i mos shlyerjes së huasë si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit) ashtu edhe për kredimarrësin, personin e siguruar, duke çliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur.
9. Tregu i sigurimeve të jetës në Republikën e Shqipërisë funksionon në zbatim të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.
10. Ligji nr. 52/2014 parashikon si lloje të ndërmjetësimit, veprimtarinë e agentit dhe brokerit, duke përcaktuar se edhe bankat e nivelit të dytë mund të pajisen me licencë për të ushtruar këtë veprimtari. Konkretisht, neni 194, pika 4 parashikon se “Veprimtaria e agentit mund të kryhet edhe nga bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, si dhe subjekte të tjera, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti” ndërsa neni 204 pika 5 parashikon se “Veprimtaria e brokerimit mund të kryhet edhe nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti”.
11. Në bazë të nenit 194 të Ligjit nr. 52/2014, veprimtaria e agentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari. Veprimtaria e agentit në sigurime mund të kryhet edhe në emër të disa shoqërive të sigurimit, nëse shoqëritë e sigurimit kanë rënë dakord me marrëveshje të shkruar midis tyre.
12. Lidhur me veprimtarinë e brokerimit, në bazë të nenit 202 të Ligjit nr. 52/2014, përfshin të gjitha ato veprimtari, si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë

me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij. Gjithashtu, përfshin edhe asistencën për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, veçanërisht zgjidhjen e kërkesave për dëmshpërblim nga shoqëria e sigurimit, në emër dhe për llogari të konsumatorit. Brokëri/shoqëria e brokerimit ndërmjetëson për lidhjen e kontratave të sigurimit vetëm me shoqëritë e sigurimit të licencuara.

13. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo brokër pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa më shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.
14. Referuar sa më sipër, AMF në Republikën e Shqipërisë ka A licencuar 4 banka si broker në sigurime për klasat e jetës dhe 1 bankë si agjent në sigurime të kësaj kategorie. Bankat e licencuara si broker në sigurime për klasat e jetës janë: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Tirana Bank dhe OTP Bank. Si agjent për klasat e jetës është licencuar Credins Bank. Gjithashtu, ndërmarrja E-Business Solutions është licencuar si agjent në sigurime për klasat e jetës, ndërsa ABI Broker Sigurimesh është licencuar si broker në sigurimet e jetës dhe jo-jetës. Disa banka, edhe pse jo të licencuara, kanë lidhur marrëveshje me shoqëri sigurimi për klasat e jetës, duke marrë automatikisht rolin e ndërmjetësuesit.
15. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
16. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”⁴⁶, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
17. Në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”⁴⁷, neni 7, informacioni kontraktor që duhet të japin bankat për klientët duhet të përmbajë veç të tjerave edhe, “garancitë e vendosura për të siguruar ekzekutimin e kontratës së kredisë, mënyrën e vënies së tyre në ekzekutim, dhe kontratat e sigurimit të jetës ose të pronës (kur janë të aplikueshme).

⁴⁶ Miratuar me Vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

⁴⁷ Miratuar me Vendimin nr. 48 datë 01.07.2015, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

18. Mbi bazën e këtij detyrimi, klientët njihen në momentin e nënshkrimit të një kontrate kredie konsumatorë apo hipotekare me detyrimin e sigurimit të jetës, aty ku është e aplikueshme, për gjithë periudhën e mbajtjes së detyrimit. Nëpërmjet këtij detyrimi, banka sigurohet që në rast ndodhje të një ngjarjeje ndaj kredimarrësit, detyrimi i tij të mbulohet nga shoqëritë e sigurimit.
19. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës kur ka vlerësuar tregun përkatës ka marrë parasysh sjelljen e konsumatorit kredimarrës. Çfarë është më e rëndësishme për kredimarrësin, kredia (banka) apo kosto e sigurimit të jetës për kredi (primi)? Kredimarrësi kur zgjedh bankën ku do të marrë kredinë e zgjedh për arsye si: reputacioni i bankës, eksperiencia e mëparshme (llogari page apo kredi të mëparshme), norma e interesit, shpejtësia e miratimit dhe disbursimit, etj. Pra, para se të trajtohet primi i sigurimit të jetës për kredi, konsumatori e ka vendosur bankën ku do të marrë financimin. Nga sa më lart, primi është më shumë një kosto sekondare se sa një faktor vendimmarrës në vendimmarrjen për kredi.
20. Në raportin e CMA (Competition & Market Authority) të Mbretërisë së Bashkuar, “Market investigation into payment protection insurance”⁴⁸ (paragrafi 5.89-5.91), **“pika e shitjes”** shpjegohet në mënyrë të përmbledhur: “... Avantazhi në pikën e shitjes është përfitimi që shpërndarësit gëzojnë nga fakti që kanë qasje të vetme tek klientët në momentin kur ata po marrin kredinë e tyre.”
21. Krahasimisht, vlerësohet se një situatë e ngjashme me atë të përshkruar në raportin e CMA ekziston edhe në rastin e kredive që kërkojnë sigurim jete, pasi vendimi i konsumatorit për t’u financuar nga një bankë e caktuar merret përpara zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit. Për rrjedhojë, banka gëzon një avantazh në “pikën e shitjes”, duke qenë se ka akses të privilegjuar ndaj klientit në momentin kur ai ndodhet në procesin e marrjes së kredisë.
22. Pavarësisht se banka, nëpërmjet informacionit para-kontraktor vë në dijeni kredimarrësin për nevojën e një sigurimi jete, vendimmarrja për shoqërinë e sigurimit, marrja e ofertave nga shoqëritë e ndryshme dhe krahasimi i primeve ndodh pas aprovimit të kredisë. Në këtë mënyrë banka siguron një akses të privilegjuar tek kredimarrësi, për të zgjedhur policën e sigurimit më të preferuar për bankën.
23. Për sa më sipër, tregu përkatës i produktit është: tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Raiffeisen.
24. Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose

⁴⁸ https://webarchive.nationalarchives.gov.uk/ukgwa/20140403003432mp/http://www.competition-commission.org.uk/assets/competitioncommission/docs/pdf/non-inquiry/rep_pub/reports/2009/fulltext/542.pdf

shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse, produkti i sigurimit të jetës është i detyrueshëm të blihet në momentin që banka aprovon kredinë që klienti dëshiron të marrë, atëherë si treg gjeografik do të konsiderohet vetëm territori i bankës së nivelit të dytë që ka aprovuar atë kredi. Për këtë arsye, tregu gjeografik për bankën Raiffeisen do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Raiffeisen.

III. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

25. Pjesët e tregut janë një tregues i rëndësishëm në lidhje me strukturën e tregut dhe rëndësinë e ndërmarrjeve të ndryshme në treg. Megjithatë, Autoriteti interpreton pjesët e tregut në këndvështrimin e kushteve të tregut përkatës dhe në veçanti të dinamikës së tregut dhe të diferencimit të produkteve. Tendenca ose zhvillimi i pjesëve të tregut me kalimin e kohës, mund të merret në konsideratë për tregjet e paqëndrueshme ose për tregjet ofertues.
26. Praktikrat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrjet zotërojnë një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës.⁴⁹
27. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndërmarrja Raiffeisen Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Raiffeisen, ka pozitë dominuese.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes në tregun përkatës

28. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo broker pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa më shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.

⁴⁹ Komunikim nga Komisioni Udhëzim mbi sjelljet përjashtuese, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 82 -Guidance on the Commission's enforcement priorities in applying Article 82 of the EC Treaty to abusive exclusionary conduct by dominant.

29. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
30. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
31. Sipas nenit 102 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasja e një pozite dominuese në treg nuk është e ndaluar në vetvete. Megjithatë, kur një ndërmarrje me pozitë dominuese përdor fuqinë e saj për të kufizuar konkurrencën në mënyrë të padrejtë, ajo mund të përbëjë një abuzim, i cili është i ndaluar me ligj.
32. Neni 102 TFEU liston kategoritë tipike të sjelljeve abuzive, por këto sjellje abuzive klasifikohen zakonisht në dy kategori kryesore: Abuzime përjashtuese (exclusionary abuses) dhe Abuzime shfrytëzuese (exploitative abuses)⁵⁰.
- Abuzime përjashtuese (Exclusionary abuse) i referohet sjelljeve të ndërmarrjeve me pozitë dominuese që synojnë të përjashtojnë konkurrentët nga tregu, ose të pengojnë hyrjen ose zhvillimin e tyre, jo thjesht të konkurrojnë lirshëm me to, por të kufizojnë konkurrencën në mënyrë aktive. Këto sjellje dëmtojnë strukturën konkurruese dhe, rrjedhimisht, edhe interesat afatgjata të konsumatorëve
 - Abuzime shfrytëzuese (Exploitative abuse) përfshin ato abuzime kur ndërmarrja me pozitë dominuese shfrytëzon pozicionin e saj për të përfituar në mënyrë të padrejtë, zakonisht përmes çmimeve të larta apo kushteve tregtare të padrejta, pa ndikuar drejtpërdrejt mbi konkurrentët.
33. Sipas nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit mbi zbatueshmërinë e neneve 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003, një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të abuzojë me këtë pozitë nëpërmjet shitjeve të lidhura (tying) ose kushtëzimeve të padrejta, kur klientit i kërkohet që, për të marrë një produkt (në këtë rast kredinë), të blejë një produkt tjetër (sigurimin e jetës) në kushte të përcaktuara nga vetë banka.
34. Vendimi i klientit për bankën ku do të marrë kredinë merret përpara se ai të shqyrtojë ofertat për sigurimin e jetës për kredi. Kjo do të thotë se banka kontrollon pikën e shitjes (momentin vendimtar të nënshkrimit të kontratës), pra zotëron një pozitë të dominuese ndaj klientit.

⁵⁰ <https://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=a940ed59-46d6-4932-a2cc-2fb52618f387>

35. Procesi i zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit ndodh pas miratimit të kredisë, në ambientet e bankës, ku kredimarrësi është tashmë i varur nga vendimi i bankës për disbursimin e fondeve. Kjo situatë i jep bankës fuqi të njëanshme tregu, duke i mundësuar të “shtyjë” një produkt sigurimi të caktuar nga një shoqëri sigurimi.
36. Autoriteti i Konkurrencës, në analizën e sjelljes së Raiffeisen Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë që kërkojnë sigurim jete, ka vlerësuar nëse Raiffeisen Bank SHA, në cilësinë e ofruesit të kredisë (produkt lidhës), ka përdorur pozitën e saj për të kushtëzuar ose ndikuar zgjedhjen e klientëve në lidhje me blerjen e sigurimit të jetës (produkt i lidhur). Konkretisht, është shqyrtuar nëse banka, ndonëse ka marrëveshje bashkëpunimi me disa shoqëri sigurimi jete, në praktikë, për shkak të mungesës së procedurave të sakta, hapësirave ligjore, apo me qëllim kanë orientuar pjesën më të madhe të klientëve drejt një ose disa shoqërive të caktuara sigurimi, duke krijuar përqendrim të larta të policave të prera në këto shoqëri. Si rrjedhojë, banka mund të ketë përdorur pozitën e saj dominuese për të ndikuar në tregun e sigurimit të jetës për kredi, duke kufizuar konkurrencën ndërmjet shoqërive të sigurimit dhe duke reduktuar zgjedhjen reale të konsumatorëve kredimarrës.
37. Banka Raiffeisen është licensuar për të ushtruar aktivitetin e brokerimit në sigurime në bazë të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit” dhe Rregullores së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, duke u pajisur me Licencën nr. 17, datë 31.10.2016.
38. Sigurimi i jetës është i detyrueshëm për të gjithë klientët kredimarrës të bankës Raiffeisen, për të gjitha llojet e kredisë: hipotekare, mikro dhe konsumatore (personale).
39. Në cilësinë e saj si broker, Banka Raiffeisen ka kontrata aktive me të gjitha shoqëritë e sigurimit të cilat e ofrojnë produktin e sigurimit të jetës dhe që janë të licencuara në këtë treg, si: Sigal Life SHA, Sicred SHA, Insig Jetë SHA dhe Albsig Jetë SHA, për segmentet e kredisë hipotekare dhe mikro.
40. Komisionet e bankës Raiffeisen si broker përbëjnë XXX% të primit të arkëtuar për sigurimin e jetës për kreditë hipotekore dhe mikro, % e aplikuar në nivel të njëjtë për të katërta shoqëritë e sigurimit, e cila paguhet prej këtyre të fundit. Për kreditë konsumatore, komisioni i aplikuar ndaj Sigal Life, si e vetmja shoqëri me të cilën banka Raiffeisen ka lidhur kontratë sigurimi për pagesën e këtij segmenti të kredisë, është XXX% të primit të arkëtuar për “paketën e sigurimit standard” dhe XXX% të primi të arkëtuar për “paketën e sigurimit extra”.

41. Në kontratën e kredisë bankare të lidhur ndërmjet bankës Raiffeisen dhe kredimarrësit, në nenin 10 të saj “Sigurimi i kolateralit dhe i jetës” shprehet se: *“1. Kredimarrësi dhe hipotekuesit/t kanë detyrimin të sigurojnë kolateralin dhe jetën në një nga shoqëritë e sigurimit të pranuar nga Banka. Kredimarrësi/Hipotekuesi deklaron se është njohur me listën e shoqërive të sigurimit të përzgjedhura nga Banka dhe do të kryejë sigurimin e jetës dhe kolateralit në njërën prej këtyre shoqërive duke parapaguar primin për të gjithë jetën e kredisë ose çdo vit, duke rinovuar policat e sigurimit të jetës dhe të kolateralit.”* Ky nen në mënyrën sesi është konceptuar në kontratat e kredisë i imponon kredimarrësit sigurimin e jetës tek një nga shoqëritë e sigurimit të pranuar nga banka, duke kufizuar zgjedhjen vetëm tek një listë e paracaktuar. Mekanizmi që krijohet është i ngjashëm me tying/bundling të detyruar duke krijuar një praktikë që ul presionin konkurrues mbi shoqëritë e sigurimit. Për më tepër ky kufizim redukton fuqinë e negocimit të kredimarrësit, rrit mundësinë e primeve më të larta të sigurimit dhe cënon transparencën që kërkohet nga parimet e tregut të lirë. Në përputhje me standartet e BE-së, DG Comp etj, klienti duhet të ketë të drejtë të zgjedhë lirisht ofruesin e sigurimit për sa kohë polica e sigurimit plotëson kushtet e riskut të kërkuara nga banka.
42. Banka Raiffeisen disponon në sistemin e saj tarifat e primeve të shoqërive të sigurimit me të cilat ka marrëveshje dhe i jep klientit direkt ofertën përkatëse në bazë të kalkulimeve me të dhënat individuale të tij. Pasi klienti përzgjedh kompaninë e sigurimit, i dërgon asaj informacionin për lëshimin e policës.
43. Gjatë periudhës në hetim, rezulton se klientët kredimarrës për huatë hipotekare dhe mikro pranë bankës Raiffeisen, kanë prerë policat e sigurimit të jetës si në vijim, Albsig Jetë SHA me një total prej XXX%; Sigal Life SHA me XXX%; Insig Jetë SHA me XXX%. Shoqëria Sicred SHA ka numrin më të vogël të policave të prera, me vetëm XXX kontrata të lidhura përgjatë periudhës raportuese, duke pasur një prezencë aspak të ndjeshme në këtë treg.
44. Sipas bankës Raiffeisen, përfaqësimi i ulët i Sicred SHA në bankën e tyre lidhet me faktin që klientët zgjedhin kryesisht kompani më të mëdha dhe më të njohura në treg.
45. Për kreditë konsumatore (pa hipotekë), e vetmja shoqëri me të cilën banka Raiffeisen ka lidhur “kontratë sigurimi në grup” për pagesën e huasë konsumatore është me ndërmarrjen Sigal Life SHA, me. Për këtë segment, banka aplikon komision si broker prej XXX% të primit të arkëtuar për “paketën e sigurimit standard” dhe XXX% të primi të arkëtuar për “paketën e sigurimit extra”.
46. Gjatë periudhës hetimore janë prerë XXX polica sigurimi për klientët e kredisë konsumatore pranë shoqërisë Sigal Life SHA, si e vetmja shoqëri sigurimi të cilën ata mund të përzgjidhnin.

47. Për rrjedhojë, volumi më i madh i komisioneve të përfuara vjen nga bashkëpunimi që kryhet me shoqërinë Sigal Life SHA, me XXX% të rakordimeve në lekë dhe XXX% të atyre në euro, vlera të cilat kanë një diferencë shumë të madhe krahasuar me të tre shoqëritë e tjera të sigurimit.
48. Banka Raiffeisen është shprehur se, bashkëpunon vetëm me Sigal Life për sigurimin e jetës në kreditë konsumatore, pasi vetëm kjo kompani ofron sigurim në grup që i përshtatet procesit të shpejtë dhe automatik të disbursimit.
49. Referuar praktikave më të mira dhe legjislacionit evropian, sipas Direktivës (BE) 2023/2225 të datës 18 tetor 2023 për marrëveshjet e kredisë për konsumatorët, Shtetet Anëtare mund të lejojnë kredidhënësit të kërkojnë nga konsumatori që të ketë një policë sigurimi të lidhur me marrëveshjen e kredisë, duke respektuar parimin e proporcionalitetit. Në të njëjtën kohë, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që kredidhënësi të jetë i detyruar të pranojë policën e sigurimit të ofruar nga një sigurues tjetër, i ndryshëm nga opsioni i preferuar, nëse kjo policë ofron një nivel garancie të barabartë me atë të propozuar nga kredidhënësi, pa ndryshuar kushtet e kredisë që i ofrohen konsumatorit.
50. Sigurimi i jetës në grup përbën një formë të vlefshme sigurimi në bazë të parashikimit të preambulës 49 të Direktivës (BE) 2016/97 për shpërndarjen e sigurimeve (IDD). Gjithashtu, Gjykata Evropiane të Drejtësisë në çështjen C-633/20 sqaroi se në rastet kur klienti bashkohet në mënyrë vullnetare dhe kundrejt pagesës në një policë sigurimi në grup, ky veprim përbën shpërndarje sigurimi në kuptimin e Direktivës. Për pasojë, ndërmjetësuesi (në këtë rast banka) i nënshtrohet të gjitha detyrimeve ndaj konsumatorit, përfshirë transparencën, informimin dhe përshtatshmërinë e produktit.
51. Në këtë frymë, ndonëse neni 20(3) i Direktivës nuk zbatohet drejtpërdrejtë për sigurimin në grup, fryma e tij është thelbësore për të kuptuar standardet që duhet të përmbushen kur ndërmjetësuesi këshillon konsumatorin mbi zgjedhjen e policës së sigurimit. Ky nen kërkon që, kur një ndërmjetës i sigurimeve pretendon se jep këshillim të paanshëm dhe personal, ai duhet ta bazojë këtë këshillim në analizën e një numri të mjaftueshëm kontratash nga tregu, për të dhënë një rekomandim të përshtatshëm për nevojat e klientit. Ky standard synon të garantojë që konsumatori të ketë zgjedhje reale, të informuar dhe në interesin e tij më të mirë.
52. Për këtë arsye, banka Raiffeisen duhet të jetë e hapur për të lidhur marrëveshje edhe me shoqëri të tjera, për të shmangur praktikën përjashtuese dhe ekskluzive ndaj ofruesve të këtij shërbimi, me qëllim për të shmangur kufizimin e konkurrencës dhe siguruar mbrojtjen e interesave të konsumatorit.
53. Nga të dhënat e administruara nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, nuk u vunë re oferta fizike të të gjitha kompanive për klientët e kësaj bankë, por vetëm të kompanisë së

përzgjedhur në dosjen e kredisë së klientit. Sipas Bankës Raiffeisen, si dhe duke u mbështetur në dokumentacionin e shoqërive të sigurimit dhe aktet e administruara gjatë inspektimeve në terren, ofertat e sigurimit të jetës komunikohen verbalisht, sipas përlllogaritjeve të sistemit, gjatë takimeve që klienti ka me përfaqësues të bankës në momentin e paraqitjes së formularit të sigurimit të jetës.

54. Elementet e identifikuar lidhur me dispozitat kontraktore, praktikat e kufizimit të zgjedhjes së klientit në shoqëritë e sigurimit “të pranuar nga banka”, komunikimin jo të dokumentuar të ofertave për sigurim, si dhe marrëveshjen ekskluzive të konstatuar për segmentin e kredive konsumatore me shoqërinë Sigal Life SHA, krijojnë indicie mbi mundësinë që sjellja e bankës, në praktikë, të ketë prodhuar efekte kufizuese të konkurrencës dhe të ketë orientuar konsumatorin drejt shoqërisë së preferuar prej bankës. Po kështu, niveli i lartë i komisioneve të ndërmjetësimit⁵¹ të aplikuar në këtë treg, ngre dyshime mbi shfrytëzimin e pozitës dominuese në dëm të konsumatorit. Kjo situatë, kërkon ndërhyrje procedurale, aplikimin e dokumentacioni shtesë i cili do të zvogëlonte në maksimum, mundësinë e bankës, apo punonjësve të saj të caktuar, të ndërhyjnë në këtë proces.
55. Pavarësisht këtyre elementeve të dyshimit dhe rrethanave që tregojnë ekzistencën e praktikave disi përjashtuese ose shfrytëzuese, elementet e administruar nuk janë të mjaftueshme që të krijojnë bindjen për shkeljen e nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Në kushtet kur banka ka marrëveshje me të katërta shoqëritë që ofrojnë sigurim jete në treg, nuk arrihet të faktohet në mënyrë të plotë dhe të drejtpërdrejtë se sjellja e bankës ka prodhuar efekt përjashtues ose shfrytëzues të konsumatorit në nivel të tillë që të mund të karakterizohet si abuzim i provuar. Ajo që evidentohet qartë, është nevoja për një rregullim më të mirë procedural, eliminimi i ofertave financiare në mënyrë verbale nëpërmjet dokumentimit me shkrim dhe ruajtja e tyre në dosjen e kredisë duke bërë procesin sa më të saktë dhe më transparent në lidhje me mënyrën sesi bëhet përzgjedhja e shoqërisë së sigurimit nga kredi marrësi duke limituar në maksimum hapësirat për sjellje antikonkurruese..
56. Në përfundim, me gjithë ekzistencën e dyshimeve, nuk ka prova të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë që në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Raiffeisen të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 26, nenin 43, pika 5 dhe nenin 45, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

⁵¹ banka aplikon si broker deri në 50% për kreditë konsumatore.

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Raiffeisen Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Raiffeisen.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes Raiffeisen Bank SHA që brenda 60 ditëve të hartojë dhe zbatojë, për çdo kredimarrës një formular të vetëm, në të cilin të pasqyrohen ofertat e të gjitha shoqërive të sigurimit, sipas propozimit të primit nga secila shoqëri sigurimi; formulari në fjalë duhet të ketë në faqen e parë, me shkrim të dukshëm, pa numër rendor emrin e secilës shoqëri sigurimi jete dhe në vijim të emrit, vlerën e primit sipas koeficienteve përkatës dhe përzgjedhjen e kredimarrësit. Ky formular duhet të nënshkruhet nga të dy palët, banka dhe kredimarrësi, dhe të ruhet si pjesë përbërëse e dosjes së kredisë e aksesueshme në çdo moment nga Autoriteti i Konkurrencës.
- III. Detyrimin e ndërmarrjes Raiffeisen Bank SHA që brenda 30 ditëve të ndryshojë parashikimin e nenit 10, pika 1 të “Kontratës së kredisë dhe hipotekës”, duke i cilësuar kredimarrësit të drejtën e këtij të fundit për të siguruar jetën në secilën nga shoqëritë e sigurimit të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
- IV. Detyrimin e ndërmarrjes Raiffeisen Bank SHA që brenda 30 ditëve, në kuadër të informacionit parakontraktor të dorëzuar çdo kredimarrësi, të përfshijë një njoftim të qartë, të shkruar dhe të plotë mbi përpunimin e të dhënave personale për qëllimet e vlerësimit dhe verifikimit të sjelljes së bankës në treg, përfshirë dhe aksesin dhe përpunimin e të dhënave nga Autoriteti i Konkurrencës, në rast monitorimi, hetimi paraprak apo hetimi të thelluar ndaj bankës.
- V. Ti rekomandojë ndërmarrjes Raiffeisen Bank SHA që të ndërmarrë masa të përshtatshme për nxitjen e konkurrencës në segmentin e kredive konsumatore.
- VI. Detyrimin e ndërmarrjes Raiffeisen Bank SHA të raportojë në çdo kohë që do kërkohet, pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi mënyrën e zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi duke paraqitur çdo dokument që konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti i Konkurrencës për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi.
- VII. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Raiffeisen Bank SHA, në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.
- VIII. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për një periudhë 1 vjeçare.

IX. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1269, Datë 20.02.2026

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES BANKA KOMBËTARE TREGTARE SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË BANKËN KOMBËTARE TREGTARE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar dhe dhënia e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Banka Kombëtare Tregtare SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në Bankën Kombëtare Tregtare.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 26, neni 43, pika 5 dhe neni 45 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka

Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.”;

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të një ankese të depozituar më datë 30 korrik 2024, mbi dyshimin për pengim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në tregun e sigurimit të jetës për kredi, në zbatim të nenit 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, aktivizoi procedurën e monitorimit të këtij tregu.
2. Bankat⁵² janë institucione financiare, që ushtrojnë veprimtarinë bankare të pranimit të depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimin e tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të tyre si dhe veprimtari të tjera të natyrës financiare, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Aktualisht në Shqipëri operojnë 11 banka tregtare, me kapital të huaj dhe vendas.
3. Sigurimi i Jetës për Kredi është një produkt që u ofrohet individëve kredimarrës, duke shërbyer ndër të tjera edhe si garanci për bankën, por dhe për kredimarrësin, i cili mbrohet si person i siguruar.
4. Nga analiza e informacionit të mbledhur gjatë fazës së monitorimit u konstatua se, pavarësisht shpjegimeve të dërguara me shkresë nga bankat, përqindjet e tregut total të sigurimit të jetës, të raportuara nga AMF për vitin 2023, nuk reflektohen në ndarjen e portofolit të sigurimit të jetës për kredi, që shitet përmes bankave. Kjo mospërputhje e dukshme ngriti shqetësime mbi funksionimin e konkurrencës në këtë segment të tregut.
5. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1130, datë 07.11.2024, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi për periudhën nga 7 nëntor 2021 deri në 7 nëntor 2024, vendim në të cilin përfshiu edhe ndërmarrjen Banka Kombëtare Tregtare SHA. Afati i përfundimit të hetimit paraprak, më pas, me Vendimin nr. 1159, datë 13.02.2025 u zgjat deri në 3 mars 2025.
6. Pas përfundimit të hetimit paraprak, u konkludua ndër të tjera se, sjellja e ndërmarrjes BKT SHA mund të përbënte shkelje të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e

⁵² https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Subjekte_te_licencuara/Banka/

konkurrencës” dhe me Vendimin nr. 1171, datë 26.03.2025 Komisioni i Konkurrencës i hapi rrugë procedurës së hetimit të thelluar në përputhje me parashikimet ligjore për periudhën 7 nëntor 2021 – 26 Mars 2025. Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të hetimit.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

7. Sigurimi është një formë e manaxhimit të riskut që vjen nga një situatë e panjohur, një kontratë në bazë të së cilës një person/kompani, transferon rrezikun e mundshëm të një dëmi/humbje financiare tek një kompani sigurimi, përkundrajt pagesës së një shume që quhet prim sigurimi.
8. Sigurimi i Jetës për Kredi ofrohet për personat që marrin kredi në bankë dhe i mbron ata dhe familjarët nga rreziku i mos shlyerjes së hua-së si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit. Ky sigurim është një garanci financiare si për bankën (nga rreziku i mos shlyerjes së huasë si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit) ashtu edhe për kredimarrësin, personin e siguruar, duke çliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur.
9. Tregu i sigurimeve të jetës në Republikën e Shqipërisë funksionon në zbatim të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.
10. Ligji nr. 52/2014 parashikon si lloje të ndërmjetësimit, veprimtarinë e agentit dhe brokerit, duke përcaktuar se edhe bankat e nivelit të dytë mund të pajisen me licencë për të ushtruar këtë veprimtari. Konkretisht, neni 194, pika 4 parashikon se “Veprimtaria e agentit mund të kryhet edhe nga bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, si dhe subjekte të tjera, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti” ndërsa neni 204 pika 5 parashikon se “Veprimtaria e brokerimit mund të kryhet edhe nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti”.
11. Në bazë të nenit 194 të Ligjit nr. 52/2014, veprimtaria e agentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari. Veprimtaria e agentit në sigurime mund të kryhet edhe në emër të disa shoqërive të sigurimit, nëse shoqëritë e sigurimit kanë rënë dakord me marrëveshje të shkruar midis tyre.

12. Lidhur me veprimtarinë e brokerimit, në bazë të nenit 202 të Ligjit nr. 52/2014, përfshin të gjitha ato veprimtari, si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij. Gjithashtu, përfshin edhe asistencën për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, veçanërisht zgjidhjen e kërkesave për dëmshpërblim nga shoqëria e sigurimit, në emër dhe për llogari të konsumatorit. Brokeri/shoqëria e brokerimit ndërmjetëson për lidhjen e kontratave të sigurimit vetëm me shoqëritë e sigurimit të licencuara.
13. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo broker pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa më shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.
14. Referuar sa më sipër, AMF në Republikën e Shqipërisë ka licencuar 4 banka si broker në sigurime për klasat e jetës dhe 1 bankë si agjent në sigurime të kësaj kategorie. Bankat e licencuara si broker në sigurime për klasat e jetës janë: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Tirana Bank dhe OTP Bank. Si agjent për klasat e jetës është licencuar Credins Bank. Gjithashtu, ndërmarrja E-Business Solutions është licencuar si agjent në sigurime për klasat e jetës, ndërsa ABI Broker Sigurimesh është licencuar si broker në sigurimet e jetës dhe jo-jetës. Disa banka, edhe pse jo të licencuara, kanë lidhur marrëveshje me shoqëri sigurimi për klasat e jetës, duke marrë automatikisht rolin e ndërmjetësuesit.
15. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
16. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”⁵³, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
17. Në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”⁵⁴, neni 7, informacioni

⁵³ Miratuar me Vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

⁵⁴ Miratuar me Vendimin nr. 48 datë 01.07.2015, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

kontraktor që duhet të japin bankat për klientët duhet të përmbajë veç të tjerave edhe, “garancitë e vendosura për të siguruar ekzekutimin e kontratës së kredisë, mënyrën e vënies së tyre në ekzekutim, dhe kontratat e sigurimit të jetës ose të pronës (kur janë të aplikueshme).

18. Mbi bazën e këtij detyrimi, klientët njihen në momentin e nënshkrimit të një kontrate kredie konsumatorë apo hipotekare me detyrimin e sigurimit të jetës, aty ku është e aplikueshme, për gjithë periudhën e mbajtjes së detyrimit. Nëpërmjet këtij detyrimi, banka sigurohet që në rast ndodhje të një ngjarjeje ndaj kredimarrësit, detyrimi i tij të mbulohet nga shoqëritë e sigurimit.
19. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës kur ka vlerësuar tregun përkatës ka marrë parasysh sjelljen e konsumatorit kredimarrës. Çfarë është më e rëndësishme për kredimarrësin, kredia (banka) apo kosto e sigurimit të jetës për kredi (primi)? Kredimarrësi kur zgjedh bankën ku do të marrë kredinë e zgjedh për arsye si: reputacioni i bankës, eksperiencia e mëparshme (llogari page apo kredi të mëparshme), norma e interesit, shpejtësia e miratimit dhe disbursimit, etj. Pra, para se të trajtohet primi i sigurimit të jetës për kredi, konsumatori e ka vendosur bankën ku do të marrë financimin. Nga sa më lart, primi është më shumë një kosto sekondare se sa një faktor vendimmarrës në vendimmarrjen për kredi.
20. Në raportin e CMA (Competition & Market Authority) të Mbretërisë së Bashkuar, “Market investigation into payment protection insurance”⁵⁵ (paragrafi 5.89-5.91), **“pika e shitjes”** shpjegohet në mënyrë të përmbledhur: “... Avantazhi në pikën e shitjes është përfitimi që shpërndarësit gëzojnë nga fakti që kanë qasje të vetme tek klientët në momentin kur ata po marrin kredinë e tyre.”
21. Krahësimisht, vlerësohet se një situatë e ngjashme me atë të përshkruar në raportin e CMA ekziston edhe në rastin e kredive që kërkojnë sigurim jete, pasi vendimi i konsumatorit për t’u financuar nga një bankë e caktuar merret përpara zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit. Për rrjedhojë, banka gëzon një avantazh në “pikën e shitjes”, duke qenë se ka akses të privilegjuar ndaj klientit në momentin kur ai ndodhet në procesin e marrjes së kredisë.
22. Pavarësisht se banka, nëpërmjet informacionit para-kontraktor vë në dijeni kredimarrësin për nevojën e një sigurimi jete, vendimmarrja për shoqërinë e sigurimit, marrja e ofertave nga shoqëritë e ndryshme dhe krahasimi i primeve ndodh pas aprovimit të kredisë. Në këtë mënyrë banka siguron një akses të privilegjuar tek kredimarrësi, për të zgjedhur policën e sigurimit më të preferuar për bankën.

⁵⁵ https://webarchive.nationalarchives.gov.uk/ukgwa/20140403003432mp/http://www.competition-commission.org.uk/assets/competitioncommission/docs/pdf/non-inquiry/rep_pub/reports/2009/fulltext/542.pdf

23. Për sa më sipër, tregu përkatës i produktit është: tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Banka Kombëtare Tregtare.
24. Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse, produkti i sigurimit të jetës është i detyrueshëm të blihet në momentin që banka aprovon kredinë që klienti dëshiron të marrë, atëherë si treg gjeografik do të konsiderohet vetëm territori i bankës së nivelit të dytë që ka aprovuar atë kredi. Për këtë arsye, tregu gjeografik për Bankën Kombëtare Tregtare do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Banka Kombëtare Tregtare.

III. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

25. Pjesët e tregut janë një tregues i rëndësishëm në lidhje me strukturën e tregut dhe rëndësinë e ndërmarrjeve të ndryshme në treg. Megjithatë, Autoriteti interpreton pjesët e tregut në këndvështrimin e kushteve të tregut përkatës dhe në veçanti të dinamikës së tregut dhe të diferencimit të produkteve. Tendenca ose zhvillimi i pjesëve të tregut me kalimin e kohës, mund të merret në konsideratë për tregjet e paqëndrueshme ose për tregjet ofertues.
26. Praktikë më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrjet zotërojnë një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës.⁵⁶
27. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndërmarrja Banka Kombëtare Tregtare SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Banka Kombëtare Tregtare, ka pozitë dominuese.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes në tregun përkatës

28. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo broker pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi,

⁵⁶ Komunikim nga Komisioni Udhëzim mbi sjelljet përjashtuese, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 82 -Guidance on the Commission's enforcement priorities in applying Article 82 of the EC Treaty to abusive exclusionary conduct by dominant.

por të vijojë sa me shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.

29. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
30. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
31. Sipas nenit 102 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasja e një pozite dominuese në treg nuk është e ndaluar në vetvete. Megjithatë, kur një ndërmarrje me pozitë dominuese përdor fuqinë e saj për të kufizuar konkurrencën në mënyrë të padrejtë, ajo mund të përbëjë një abuzim, i cili është i ndaluar me ligj.
32. Neni 102 TFEU liston kategoritë tipike të sjelljeve abuzive, por këto sjellje abuzive klasifikohen zakonisht në dy kategori kryesore: Abuzime përjashtuese (exclusionary abuses) dhe Abuzime shfrytëzuese (exploitative abuses)⁵⁷.
- Abuzime përjashtuese (Exclusionary abuse) i referohet sjelljeve të ndërmarrjeve me pozitë dominuese që synojnë të përjashtojnë konkurrentët nga tregu, ose të pengojnë hyrjen ose zhvillimin e tyre, jo thjesht të konkurrojnë lirshëm me to, por të kufizojnë konkurrencën në mënyrë aktive. Këto sjellje dëmtojnë strukturën konkurruese dhe, rrjedhimisht, edhe interesat afatgjata të konsumatorëve
 - Abuzime shfrytëzuese (Exploitative abuse) përfshin ato abuzime kur ndërmarrja me pozitë dominuese shfrytëzon pozicionin e saj për të përfituar në mënyrë të padrejtë, zakonisht përmes çmimeve të larta apo kushteve tregtare të padrejta, pa ndikuar drejtpërdrejt mbi konkurrentët.
33. Sipas nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit mbi zbatueshmërinë e neneve 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003, një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të abuzojë me këtë pozitë nëpërmjet shitjeve të lidhura (tying) ose kushtëzimeve të padrejta, kur klientit i kërkohet që, për të marrë një produkt (në këtë rast kredinë), të blejë një produkt tjetër (sigurimin e jetës) në kushte të përcaktuara nga vetë banka.

⁵⁷ <https://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=a940ed59-46d6-4932-a2cc-2fb52618f387>

34. Vendimi i klientit për bankën ku do të marrë kredinë merret përpara se ai të shqyrtojë ofertat për sigurimin e jetës për kredi. Kjo do të thotë se banka kontrollon pikën e shitjes (momentin vendimtar të nënshkrimit të kontratës), pra zotëron një pozitë të dominuese ndaj klientit.
35. Procesi i zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit ndodh pas miratimit të kredisë, në ambientet e bankës, ku kredimarrësi është tashmë i varur nga vendimi i bankës për disbursimin e fondeve. Kjo situatë i jep bankës fuqi të njëanshme tregu, duke i mundësuar të “shtyjë” një produkt sigurimi të caktuar nga një shoqëri sigurimi.
36. Autoriteti i Konkurrencës, në analizën e sjelljes së BKT SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë që kërkojnë sigurim jete, ka vlerësuar nëse BKT SHA, në cilësinë e ofruesit të kredisë (produkt lidhës), ka përdorur pozitën e saj për të kushtëzuar ose ndikuar zgjedhjen e klientëve në lidhje me blerjen e sigurimit të jetës (produkt i lidhur). Konkretisht, është shqyrtuar nëse banka, ndonëse ka marrëveshje bashkëpunimi me disa shoqëri sigurimi jete, në praktikë, për shkak të mungesës së procedurave të sakta, hapësirave ligjore, apo me qëllim ka orientuar pjesën më të madhe të klientëve drejt një ose disa shoqërive të caktuara sigurimi, duke krijuar përqendrim të larta të policave të prera në këto shoqëri. Si rrjedhojë, banka mund të ketë përdorur pozitën e saj dominuese për të ndikuar në tregun e sigurimit të jetës për kredi, duke kufizuar konkurrencën ndërmjet shoqërive të sigurimit dhe duke reduktuar zgjedhjen reale të konsumatorëve kredimarrës.
37. Banka Kombëtare Tregtare SHA (BKT) është licensuar për të ushtruar aktivitetin e brokerimit në sigurime sipas Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit” dhe rregullores së licensimit të nxjerrë në zbatim të tij dhe është pajisur me Licensën nr. 18, datë 27.12.2016, miratuar me Vendimin nr. 206, datë 27.12.2016 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
38. Sigurimi i jetës është i detyrueshëm për të gjithë klientët kredimarrës të bankës BKT.
39. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar rezultoi se, BKT ka zbatuar 4 (katër) Akt-Marrëveshje për sigurimin e jetës, konkretisht me këto shoqëri sigurimi: Sigal Life Uniqa Group Austria SHA, Sicred SHA, Insig Jetë SHA dhe Albsig SHA.
40. Nga vlerësimi i marrëveshjeve, për produktin e sigurimit të jetës, të lidhura ndërmjet Sicred SHA, Insig Jetë SHA, Sigal Life SHA dhe Albsig SHA me bankën BKT, vërehet se kontratat janë të hartuara njësoj, komisioni i brokerimit për ndërmjetësimin në shitjen e policave të sigurimit të jetës është i njëjtë në masën XXX% të primit të arkëtuar dhe i vetmi ndryshim esencial në marrëveshja janë koeficientet e llogaritjes së primit të sigurimit.

41. Në kontratën e kredisë bankare të lidhur ndërmjet bankës dhe kredimarrësit, në nenin 11 të saj “Sigurimi i kolateralit dhe i jetës” shprehet se: “11.1. Banka ka të drejtë t’i kërkojë kredimarrësit të sigurojë kolateralin e tij/saj dhe jetën e tij/saj kundrejt çdo lloj risku në shoqëritë siguruese që Banka e shikon të arsyeshme. Në rast se Kredimarrësi ka siguruar më parë këtë kolateral, Banka ka të drejtë të kërkojë transferimin e kontratës së kredisë në favor të Bankës.” Përcaktimi i parashikuar në nenin 11.1 të kontratës së kredisë së BKT-së, sipas të cilit “Banka ka të drejtë t’i kërkojë kredimarrësit të sigurojë kolateralin dhe jetën në shoqëritë siguruese që Banka e shikon të arsyeshme”, përbën kufizim të lirisë së zgjedhjes së kredimarrësit dhe krijon një avantazh të padrejtë për shoqëritë e sigurimit të preferuara nga banka. Një formulim i tillë, nëse do të zbatohet në praktikë, (gjatë hetimit nuk janë evidentuar raste të aplikimit në praktikë të këtij neni), i jep bankës kompetencë të pakufizuar për të përcaktuar shoqërinë e sigurimit, duke i mohuar kredimarrësit mundësinë për të zgjedhur në mënyrë të pavarur siguruesin që ofron kushte më të mira çmimi, mbulimi apo shërbimi. Kjo sjell efekte përjashtuese (foreclosure) në treg, pasi kufizon hyrjen ose funksionimin normal të siguruesve të tjerë që nuk janë përzgjedhur nga banka, duke çuar në koncentrim artificial të portofolit të sigurimit të jetës në një numër të kufizuar shoqërish. Në linjë me nenin 4 të Ligjit nr. 9121/2003, i cili ndalon marrëveshjet që kanë për objekt ose pasojë kufizimin e konkurrencës, si dhe me nenin 9 të po këtij ligji për abuzimin me pozitën dominuese në një treg të ndërmjetësuar, një klauzolë e tillë krijon varësi ekonomike të kredimarrësit dhe eliminon konkurrencën ndërmjet shoqërive të sigurimit. Praktika e BE-së e konsideron kushtëzimin e produkteve financiare me blerjen e sigurimit (tying dhe bundling) si sjellje potencialisht antikonkurruese, nëse kufizon zgjedhjen efektive të konsumatorit dhe ndikon negativisht në strukturën e tregut. Pavarësisht ekzistencës së këtij neni, nuk është evidentuar asnjë rast ku ky nen të jetë përdorur për të shmangur konkurrencën midis shoqërive të sigurimit pasi banka ka marrëveshje me të tëra shoqëritë e sigurimit, por një nen i tillë, sugjerohet të mos jetë pjesë e kontratës së kredisë.
42. Gjatë periudhës hetimore, rezulton se klientët kredimarrës pranë bankës BKT kanë prerë policat e sigurimit të jetës si në vijim: Sigal Life me XXX%, ndjekur nga Albsig Jetë me XXX%, Insig Jetë me XXX% dhe së fundmi Sicred me vetëm XXX%, që përkthehet në total XXX polica.
43. Për rrjedhojë, volumi më i madh i komisioneve të përftuara vjen nga bashkëpunimi që kryhet me shoqërinë Sigal Life, me XXX% - XXX% në vit të rakordimeve në lekë dhe Sigal e Albsig me mbi XXX% të rakordimeve vjetore në euro.
44. Sipas BKT, shoqëria Sicred SHA ka përfaqësim të ulët në bankën e tyre sepse ofron vetëm sigurim jete, është më pak e njohur për klientët dhe ka prime më të shtrenjta krahasuar me kompanitë e tjera.
45. Nga të dhënat e administruara nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, nuk u evidentuan

oferta fizike të të gjitha kompanive për klientët e kësaj bankë, por vetëm të kompanisë së përzgjedhur në dosjen e kredisë së klientit. Sipas BKT, si dhe duke u mbështetur në dokumentacionin e shoqërive të sigurimit dhe aktet e administruara gjatë inspektimeve në terren, ofertat e sigurimit të jetës komunikohen verbalisht, gjatë takimeve që klienti ka me përfaqësues të bankës në momentin e paraqitjes së formularit të sigurimit të jetës.

46. Rrethanat e identifikuar në lidhje me dispozitat kontraktore, praktikën e komunikimit të ofertave vetëm në mënyrë verbale, nivelin e transparencës ndaj klientit dhe kufizimin e mundësisë efektive të zgjedhjes së konsumatorit, krijojnë indicie që banka mund të ketë shfrytëzuar pozitën e saj për të kushtëzuar konsumatorët dhe për të kufizuar konkurrencën efektive në tregun e sigurimit të jetës, nëpërmjet praktikave të lidhura, mungesës së transparencës dhe vendosjes së kushteve të padrejta kontraktuale. Kjo situatë, kërkon ndërhyrje procedurale, aplikimin e dokumentacioni shtesë i cili do të zvogëlonte në maksimum, mundësinë e bankës, apo punonjësve të saj të caktuar, të ndërhyjnë në këtë proces.
47. Pavarësisht indicieve, provat e administruara në këtë procedurë hetimore nuk ka prova konkrete që të krijojnë bindje për shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Kjo për shkak se evidencat e administruara, ndonëse tregojnë se banka ka patur mundësinë për mund të shfrytëzuar pozitën e saj për të kushtëzuar konsumatorët dhe për të kufizuar konkurrencën efektive në tregun e sigurimit të jetës, nëpërmjet praktikave të lidhura, mungesës së transparencës dhe vendosjes së kushteve të padrejta kontraktuale, në kushtet kur ka marrëveshje me të katërta shoqëritë që ofrojnë sigurimin e jetës në treg, nuk arrihet të faktohet në mënyrë të plotë dhe të drejtpërdrejtë se sjellja e bankës ka prodhuar efekt përjashtues ose shfrytëzues të konsumatorit në nivel të tillë që të mund të karakterizohet si abuzim i provuar. Ajo që evidentohet qartë, është nevoja për një rregullim më të mirë procedural, eliminimi i ofertave financiare në mënyrë verbale nëpërmjet dokumentimit me shkrim dhe ruajtja e tyre në dosjen e kredisë duke bërë procesin sa më të saktë dhe më transparent në lidhje me mënyrën sesi bëhet përzgjedhja e shoqërisë së sigurimit nga kredi marrësi duke limituar në maksimum hapësirat për sjellje antikonkurruese.
48. Në përfundim, me gjithë ekzistencën e dyshimeve, nuk ka prova të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë që në tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në Bankën Kombëtare Tregtare të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 26, nenin 43, pika 5 dhe nenin 45, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Banka Kombëtare Tregtare SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në Bankën Kombëtare Tregtare.
- II. Detyrimin e ndërmarrjes Banka Kombëtare Tregtare SHA që brenda 60 ditëve, të hartojë dhe zbatojë, për çdo kredimarrës një formular të vetëm, në të cilin të pasqyrohen ofertat e të gjitha shoqërive të sigurimit, sipas propozimit të primit nga secila shoqëri sigurimi; formulari në fjalë duhet të ketë në faqen e parë, me shkrim të dukshëm, pa numër rendor emrin e secilës shoqëri sigurimi jete dhe në vijim të emrit, vlerën e primit sipas koeficienteve përkatës dhe përzgjedhjen e kredimarrësit. Ky formular duhet të nënshkruhet nga të dy palët, banka dhe kredimarrësi, dhe të ruhet si pjesë përbërëse e dosjes së kredisë e aksesueshme në çdo moment nga Autoriteti i Konkurrencës.
- III. Detyrimin e ndërmarrjes Banka Kombëtare Tregtare SHA që brenda 30 ditëve të ndryshojë parashikimin e nenit 11.1 në Kontratën e kredisë bankare”, duke i cilësuar kredimarrësit të drejtën e këtij të fundit për të siguruar jetën në secilën nga shoqëritë e sigurimit të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
- IV. Detyrimin e ndërmarrjes Banka Kombëtare Tregtare SHA që brenda 30 ditëve, në kuadër të informacionit parakontraktor të dorëzuar çdo kredimarrësi, të përfshijë një njoftim të qartë, të shkruar dhe të plotë mbi përpunimin e të dhënave personale për qëllimet e vlerësimit dhe verifikimit të sjelljes së bankës në treg, përfshirë dhe aksesin dhe përpunimin e të dhënave nga Autoriteti i Konkurrencës, në rast monitorimi, hetimi paraprak apo hetimi të thelluar ndaj bankës.
- V. Detyrimin e ndërmarrjes Banka Kombëtare Tregtare SHA të raportojë në çdo kohë që do kërkohej, pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi mënyrën e zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi duke paraqitur çdo dokument që konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti i Konkurrencës për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi.
- VI. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Banka Kombëtare Tregtare SHA, në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.
- VII. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për një periudhë 1 vjeçare.
- VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1270, Datë 20.02.2026

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES TIRANA BANK SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË TIRANA BANK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar dhe dhënia e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Tirana Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në Tirana Bank.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 26, neni 43, pika 5 dhe neni 45 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.;

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.”;

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur

1. Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të një ankese të depozituar më datë 30 korrik 2024, mbi dyshimin për pengim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në tregun e sigurimit të jetës për kredi, në zbatim të nenit 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, aktivizoi procedurën e monitorimit të këtij tregu.
2. Bankat⁵⁸ janë institucione financiare, që ushtrojnë veprimtarinë bankare të pranimi të depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimin e tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të tyre si dhe veprimtari të tjera të natyrës financiare, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Aktualisht në Shqipëri operojnë 11 banka tregtare, me kapital të huaj dhe vendas.
3. Sigurimi i Jetës për Kredi është një produkt që u ofrohet individëve kredimarrës, duke shërbyer ndër të tjera edhe si garanci për bankën, por dhe për kredimarrësin, i cili mbrohet si person i siguruar.
4. Nga analiza e informacionit të mbledhur gjatë fazës së monitorimit u konstatua se, pavarësisht shpjegimeve të dërguara me shkresë nga bankat, përqindjet e tregut total të sigurimit të jetës, të raportuara nga AMF për vitin 2023, nuk reflektohen në ndarjen e portofolit të sigurimit të jetës për kredi, që shitet përmes bankave. Kjo mospërputhje e dukshme ngriti shqetësime mbi funksionimin e konkurrencës në këtë segment të tregut.
5. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1130, datë 07.11.2024, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi për periudhën nga 7 nëntor 2021 deri në 7 nëntor 2024, vendim në të cilin përfshiu edhe ndërmarrjen Tirana Bank SHA. Afati i përfundimit të hetimit paraprak, më pas, me Vendimin nr. 1159, datë 13.02.2025 u zgjat deri në 3 mars 2025.
6. Pas përfundimit të hetimit paraprak, u konkludua ndër të tjera se, sjellja e ndërmarrjes Tirana Bank SHA mund të përbënte shkelje të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe me Vendimin nr. 1171, datë 26.03.2025 Komisioni i Konkurrencës i hapi rrugë procedurës së hetimit të thelluar në përputhje me parashikimet ligjore për periudhën 7 nëntor 2021 – 26 Mars 2025. Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të hetimit.

⁵⁸ https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Subjekte_te_licencuara/Banka/

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

7. Sigurimi është një formë e manaxhimit të riskut që vjen nga një situatë e panjohur, një kontratë në bazë të së cilës një person/kompani, transferon rrezikun e mundshëm të një dëmi/humbje financiare tek një kompani sigurimi, përkundrajt pagesës së një shume që quhet prim sigurimi.
8. Sigurimi i Jetës për Kredi ofrohet për personat që marrin kredi në bankë dhe i mbrojnë ata dhe familjarët nga rreziku i mos shlyerjes së hua-së si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit. Ky sigurim është një garanci financiare si për bankën (nga rreziku i mos shlyerjes së huasë si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit) ashtu edhe për kredimarrësin, personin e siguruar, duke çliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur.
9. Tregu i sigurimeve të jetës në Republikën e Shqipërisë funksionon në zbatim të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.
10. Ligji nr. 52/2014 parashikon si lloje të ndërmjetësimit, veprimtarinë e agjentit dhe brokerit, duke përcaktuar se edhe bankat e nivelit të dytë mund të pajisen me licencë për të ushtruar këtë veprimtari. Konkretisht, neni 194, pika 4 parashikon se “Veprimtaria e agjentit mund të kryhet edhe nga bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, si dhe subjekte të tjera, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti” ndërsa neni 204 pika 5 parashikon se “Veprimtaria e brokerimit mund të kryhet edhe nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti”.
11. Në bazë të nenit 194 të Ligjit nr. 52/2014, veprimtaria e agjentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari. Veprimtaria e agjentit në sigurime mund të kryhet edhe në emër të disa shoqërive të sigurimit, nëse shoqëritë e sigurimit kanë rënë dakord me marrëveshje të shkruar midis tyre.
12. Lidhur me veprimtarinë e brokerimit, në bazë të nenit 202 të Ligjit nr. 52/2014, përfshin të gjitha ato veprimtari, si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për

t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij. Gjithashtu, përfshin edhe asistencën për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, veçanërisht zgjidhjen e kërkesave për dëmshpërblim nga shoqëria e sigurimit, në emër dhe për llogari të konsumatorit. Brokëri/shoqëria e brokerimit ndërmjetëson për lidhjen e kontratave të sigurimit vetëm me shoqëritë e sigurimit të licencuara.

13. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo brokër pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa me shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.
14. Referuar sa më sipër, AMF në Republikën e Shqipërisë ka A licencuar 4 banka si broker në sigurime për klasat e jetës dhe 1 bankë si agjent në sigurime të kësaj kategorie. Bankat e licencuara si broker në sigurime për klasat e jetës janë: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Tirana Bank dhe OTP Bank. Si agjent për klasat e jetës është licencuar Credins Bank. Gjithashtu, ndërmarrja E-Business Solutions është licencuar si agjent në sigurime për klasat e jetës, ndërsa ABI Broker Sigurimesh është licencuar si broker në sigurimet e jetës dhe jo-jetës. Disa banka, edhe pse jo të licencuara, kanë lidhur marrëveshje me shoqëri sigurimi për klasat e jetës, duke marrë automatikisht rolin e ndërmjetësuesit.
15. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negociimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
16. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”⁵⁹, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
17. Në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”⁶⁰, neni 7, informacioni kontraktor që duhet të japin bankat për klientët duhet të përmbajë veç të tjerave edhe, “garancitë e vendosura për të siguruar ekzekutimin e kontratës së kredisë, mënyrën e vënies së tyre në ekzekutim, dhe kontratat e sigurimit të jetës ose të pronës (kur janë të aplikueshme).

⁵⁹ Miratuar me Vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

⁶⁰ Miratuar me Vendimin nr. 48 datë 01.07.2015, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

18. Mbi bazën e këtij detyrimi, klientët njihen në momentin e nënshkrimit të një kontrate kredie konsumatorë apo hipotekare me detyrimin e sigurimit të jetës, aty ku është e aplikueshme, për gjithë periudhën e mbajtjes së detyrimit. Nëpërmjet këtij detyrimi, banka sigurohet që në rast ndodhje të një ngjarjeje ndaj kredimarrësit, detyrimi i tij të mbulohet nga shoqëritë e sigurimit.
19. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës kur ka vlerësuar tregun përkatës ka marrë parasysh sjelljen e konsumatorit kredimarrës. Çfarë është më e rëndësishme për kredimarrësin, kredia (banka) apo kosto e sigurimit të jetës për kredi (primi)? Kredimarrësi kur zgjedh bankën ku do të marrë kredinë e zgjedh për arsye si: reputacioni i bankës, eksperiencia e mëparshme (llogari page apo kredi të mëparshme), norma e interesit, shpejtësia e miratimit dhe disbursimit, etj. Pra, para se të trajtohet primi i sigurimit të jetës për kredi, konsumatori e ka vendosur bankën ku do të marrë financimin. Nga sa më lart, primi është më shumë një kosto sekondare se sa një faktor vendimmarrës në vendimmarrjen për kredi.
20. Në raportin e CMA (Competition & Market Authority) të Mbretërisë së Bashkuar, “Market investigation into payment protection insurance”⁶¹ (paragrafi 5.89-5.91), **“pika e shitjes”** shpjegohet në mënyrë të përmbledhur: “... Avantazhi në pikën e shitjes është përfitimi që shpërndarësit gëzojnë nga fakti që kanë qasje të vetme tek klientët në momentin kur ata po marrin kredinë e tyre.”
21. Krahasimisht, vlerësohet se një situatë e ngjashme me atë të përshkruar në raportin e CMA ekziston edhe në rastin e kredive që kërkojnë sigurim jete, pasi vendimi i konsumatorit për t’u financuar nga një bankë e caktuar merret përpara zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit. Për rrjedhojë, banka gëzon një avantazh në “pikën e shitjes”, duke qenë se ka akses të privilegjuar ndaj klientit në momentin kur ai ndodhet në procesin e marrjes së kredisë.
22. Pavarësisht se banka, nëpërmjet informacionit para-kontraktor vë në dijeni kredimarrësin për nevojën e një sigurimi jete, vendimmarrja për shoqërinë e sigurimit, marrja e ofertave nga shoqëritë e ndryshme dhe krahasimi i primeve ndodh pas aprovimit të kredisë. Në këtë mënyrë banka siguron një akses të privilegjuar tek kredimarrësi, për të zgjedhur policën e sigurimit më të preferuar për bankën.
23. Për sa më sipër, tregu përkatës i produktit është: tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Tirana.
24. Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse, produkti i sigurimit

⁶¹ https://webarchive.nationalarchives.gov.uk/ukgwa/20140403003432mp_/http://www.competition-commission.org.uk/assets/competitioncommission/docs/pdf/non-inquiry/rep_pub/reports/2009/fulltext/542.pdf

të jetës është i detyrueshëm të blihet në momentin që banka aprovon kredinë që klienti dëshiron të marrë, atëherë si treg gjeografik do të konsiderohet vetëm territori i bankës së nivelit të dytë që ka aprovuar atë kredi. Për këtë arsye, tregu gjeografik për Tirana Bank do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Tirana Bank.

III. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

25. Pjesët e tregut janë një tregues i rëndësishëm në lidhje me strukturën e tregut dhe rëndësinë e ndërmarrjeve të ndryshme në treg. Megjithatë, Autoriteti interpreton pjesët e tregut në këndvështrimin e kushteve të tregut përkatës dhe në veçanti të dinamikës së tregut dhe të diferencimit të produkteve. Tendencat ose zhvillimi i pjesëve të tregut me kalimin e kohës, mund të merret në konsideratë për tregjet e paqëndrueshme ose për tregjet ofertues.
26. Praktikën më të mirë të vendeve të Bashkimit Evropian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrjet zotërojnë një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës.⁶²
27. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndërmarrja Tirana Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Tirana Bank, ka pozitë dominuese.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes në tregun përkatës

28. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo broker pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa më shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.
29. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin

⁶² Komunikim nga Komisioni Udhëzim mbi sjelljet përjashtuese, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 82 -Guidance on the Commission's enforcement priorities in applying Article 82 of the EC Treaty to abusive exclusionary conduct by dominant.

me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.

30. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
31. Sipas nenit 102 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasja e një pozite dominuese në treg nuk është e ndaluar në vetvete. Megjithatë, kur një ndërmarrje me pozitë dominuese përdor fuqinë e saj për të kufizuar konkurrencën në mënyrë të padrejtë, ajo mund të përbëjë një abuzim, i cili është i ndaluar me ligj.
32. Neni 102 TFEU liston kategoritë tipike të sjelljeve abuzive, por këto sjellje abuzive klasifikohen zakonisht në dy kategori kryesore: Abuzime përjashtuese (exclusionary abuses) dhe Abuzime shfrytëzuese (exploitative abuses)⁶³.
- Abuzime përjashtuese (Exclusionary abuse) i referohet sjelljeve të ndërmarrjeve me pozitë dominuese që synojnë të përjashtojnë konkurrentët nga tregu, ose të pengojnë hyrjen ose zhvillimin e tyre, jo thjesht të konkurrojnë lirshëm me to, por të kufizojnë konkurrencën në mënyrë aktive. Këto sjellje dëmtojnë strukturën konkurruese dhe, rrjedhimisht, edhe interesat afatgjata të konsumatorëve
 - Abuzime shfrytëzuese (Exploitative abuse) përfshin ato abuzime kur ndërmarrja me pozitë dominuese shfrytëzon pozicionin e saj për të përfituar në mënyrë të padrejtë, zakonisht përmes çmimeve të larta apo kushteve tregtare të padrejta, pa ndikuar drejtpërdrejt mbi konkurrentët.
33. Sipas nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit mbi zbatueshmërinë e neneve 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003, një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të abuzojë me këtë pozitë nëpërmjet shitjeve të lidhura (tying) ose kushtëzimeve të padrejta, kur klientit i kërkohet që, për të marrë një produkt (në këtë rast kredinë), të blejë një produkt tjetër (sigurimin e jetës) në kushte të përcaktuara nga vetë banka.
34. Vendimi i klientit për bankën ku do të marrë kredinë merret përpara se ai të shqyrtojë ofertat për sigurimin e jetës për kredi. Kjo do të thotë se banka kontrollon pikën e shitjes (momentin vendimtar të nënshkrimit të kontratës), pra zotëron një pozitë të dominuese ndaj klientit.

⁶³ <https://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=a940ed59-46d6-4932-a2cc-2fb52618f387>

35. Procesi i zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit ndodh pas miratimit të kredisë, në ambientet e bankës, ku kredimarrësi është tashmë i varur nga vendimi i bankës për disbursimin e fondeve. Kjo situatë i jep bankës fuqi të njëanshme tregu, duke i mundësuar të “shtyjë” një produkt sigurimi të caktuar nga një shoqëri sigurimi.
36. Autoriteti i Konkurrencës, në analizën e sjelljes së Tirana Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë që kërkojnë sigurim jete, ka vlerësuar nëse Tirana Bank SHA, në cilësinë e ofruesit të kredisë (produkt lidhës), ka përdorur pozitën e saj për të kushtëzuar ose ndikuar zgjedhjen e klientëve në lidhje me blerjen e sigurimit të jetës (produkt i lidhur). Konkretisht, është shqyrtuar nëse banka, ndonëse ka marrëveshje bashkëpunimi me disa shoqëri sigurimi jete, në praktikë, për shkak të mungesës së procedurave të sakta, hapësirave ligjore, apo me qëllim kanë orientuar pjesën më të madhe të klientëve drejt një ose disa shoqërive të caktuara sigurimi, duke krijuar përqendrim të larta të policave të prera në këto shoqëri. Si rrjedhojë, banka mund të ketë përdorur pozitën e saj dominuese për të ndikuar në tregun e sigurimit të jetës për kredi, duke kufizuar konkurrencën ndërmjet shoqërive të sigurimit dhe duke reduktuar zgjedhjen reale të konsumatorëve kredimarrës.
37. Tirana Bank SHA është licensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me Vendim nr. 76, datë 15.06.2020 “Për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime për klientët”, në klasat e jetës sipas Ligjit nr. 52/2014 “Per veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit” dhe rregullores së licensimit të nxjerrë në zbatim të tij
38. Sigurimi i jetës në Tirana Bank SHA kryhet bazuar në politikën e kredidhënies dhe aprovimin e rastit të kredisë. Në rast vendimi për sigurim jete, në aprovim përcaktohen të dhënat mbi sigurimin e jetës (i siguruari, shuma e sigurimit dhe afati).
39. Tirana Bank SHA ka kontrata aktive që prej vitit 2020, të lidhura me të gjitha shoqëritë e sigurimit të cilat e ofrojnë produktin e sigurimit të jetës dhe që janë të licencuara në këtë treg si: Sigal Life Uniqa Group Austria SHA, Sicred SHA, Insig Jetë SHA dhe Albsig Jetë SHA.
40. Tirana Bank ka të përfshirë në dokumentacionin që i paraqet klientit një formular për sigurimin e jetës. Në këtë formular listohen kompanitë e sigurimit të licencuara nga AMF si edhe kushtet e tyre përkatëse.
41. Klientët e Tirana Bank SHA kanë prerë policat e sigurimit të jetës si në vijim: Me volum primesh në Lekë: Albsig Jetë SHA me XXX%, Sigal Life SHA me XXX%, Sicred SHA me XXX% dhe Insig Jetë SHA me XXX%. Me volum primesh në Euro: Albsig Jetë SHA me XXX%, Sigal Life SHA me XXX%, Sicred SHA me XXX% dhe Insig Jetë SHA me XXX%. Me numër policash të prera: Albsig Jetë SHA me XXX%, Sigal Life SHA me XXX%, Sicred

SHA me XXX% dhe Insig Jetë SHA me XXX%.; Për rrjedhojë, volumi më i madh i komisioneve të përftuara vjen nga bashkëpunimi që kryhet me shoqërinë Albsig, me XXX% të totalit të rakordimeve, XXX% në lekë dhe XXX% në euro.

42. Të dhënat e administruara tregojnë përqendrim të lartë në një shoqëri të vetme, pavarësisht ekzistencës të marrëveshjeve me katër shoqëri sigurimi, duke krijuar në këtë mënyrë dyshimin se banka, mund të ketë ndikuar klientët, duke kufizuar konkurrencën efektive ndërmjet katër shoqërive të sigurimit me të cilat ajo ka marrëveshje ndërmjetësimi. Megjithatë, duhet theksuar se dyshimi i mësipërm nuk është arritur të vërtetohet përgjatë hetimit të thelluar, ç'ka bën thelbësore adresimin e situatës së evidentuar me qëllim eliminimin e mundësisë për sjellje të kësaj natyre në të ardhmen.
43. Edhe pse përqendrimi i lartë i policave të sigurimit në një shoqëri të vetme dhe faktet e mbledhura sugjerojnë ekzistencën e një sjelljeje potencialisht të pabarabartë dhe të aftë për të prodhuar efekte përjashtuese ose shfrytëzuese në treg, provat e administruara nuk janë të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë të shkeljes së nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Në veçanti, nuk rezulton të jetë provuar se orientimi i klientëve ka qenë rezultat i një detyrimi de facto të imponuar nga banka, apo se efektet e konstatuara përbëjnë kufizim të provuar dhe të drejtpërdrejtë të konkurrencës në shkallë të tillë sa të konsiderohet shkelje e nenit 9 të Ligjit nr.9121/2003. Ajo që evidentohet qartë, është nevoja për një rregullim më të mirë procedural, eliminimi i ofertave financiare në mënyrë verbale nëpërmjet dokumentimit me shkrim dhe ruajtja e tyre në dosjen e kredisë duke bërë procesin sa më të saktë dhe më transparent në lidhje me mënyrën sesi bëhet përzgjedhja e shoqërisë së sigurimit nga kredi marrësi duke limituar në maksimum hapësirat për sjellje antikonkurruese.
44. Në përfundim, me gjithë ekzistencën e dyshimeve, nuk ka prova të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë që në tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Tirana të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 26, nenin 43, pika 5 dhe nenin 45, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Tirana Bank SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në Tirana Bank.

- II. Detyrimin e ndërmarrjes Tirana Bank SHA që brenda 60 ditëve, të hartojë dhe zbatojë, për çdo kredimarrës një formular të vetëm, në të cilin të pasqyrohen ofertat e të gjitha shoqërive të sigurimit, sipas propozimit të primit nga secila shoqëri sigurimi; formulari në fjalë duhet të ketë në faqen e parë, me shkrim të dukshëm, pa numër rendor emrin e secilës shoqëri sigurimi jete dhe në vijim të emrit, vlerën e primit sipas koeficienteve përkatës dhe përzgjedhjen e kredimarrësit. Ky formular duhet të nënshkruhet nga të dy palët, banka dhe kredimarrësi, dhe të ruhet si pjesë përbërëse e dosjes së kredisë e aksesueshme në çdo moment nga Autoriteti i Konkurrencës.
- III. Detyrimin e ndërmarrjes Tirana Bank SHA që brenda 30 ditëve, në kuadër të informacionit parakontraktor të dorëzuar çdo kredimarrësi, të përfshijë një njoftim të qartë, të shkruar dhe të plotë mbi përpunimin e të dhënave personale për qëllimet e vlerësimit dhe verifikimit të sjelljes së bankës në treg, përfshirë dhe aksesin dhe përpunimin e të dhënave nga Autoriteti i Konkurrencës, në rast monitorimi, hetimi paraprak apo hetimi të thelluar ndaj bankës.
- IV. Detyrimin e ndërmarrjes Tirana Bank SHA të raportojë në çdo kohë që do kërkohet, pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi mënyrën e zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi duke paraqitur çdo dokument që konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti i Konkurrencës për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi.
- V. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja Tirana Bank SHA, në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.
- VI. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për një periudhë 1 vjeçare.
- VII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1271, Datë 25.02.2026

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E
PËRPUNIMIT DHE TREGTIMIT TË SHEQERIT”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimin e kërkesës së Sekretariatit për hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e importit, përpunimit dhe tregtimit të sheqerit.

Baza Ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42 pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të: Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi monitorimin e tregut të importit, përpunimit dhe tregtimit të sheqerit. ”

VËREN SE :

Sekretari i Përgjithshëm, bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me anë të urdhrin nr. 123, datë 17.12.2025 “Për ngritjen e grupit të punës “Për monitorimin e e produkteve të shportës ushqimore”, ngriti grupin e punës për monitorimin e produkteve të shortës ushqimore.

Për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për realizimin e kësaj procedure, në zbatim të nenit 34 të ligjit nr. 9121/2003, me anë të shkresës sonë nr. 1088/2, datë 23.12.2025 “Kërkesë për informacion”, është kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbi importet e realizuara për produktet e shportës sipas subjekteve importuese, për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2025. Në përgjigje të kësaj kërkesë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka depozituar informacionin e kërkuar nëpërmjet e-malit zyrtar.

Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u vërejt në Shqipëri, nevojat për sheqer sigurohen nga tregu ndërkombëtar pra 100% nga importi. Sheqeri është produkt

bazë ushqimor, me kërkesë relativisht inelastike (konsumi nuk ndryshon shumë nga çmimi). Importi për sheqerit realizohet për përdorim industrial dhe për shitje për përdorim familjar dhe industrial.

Për vitin 2023, ndërmarrjet kryesore të importit të sheqerit të bardhë janë ndërmarrja Agrana Studen Albania SHPK me pjesë tregu prej _____ sipas sasisë së importuar dhe ndërmarrja Ferra & CO SHPK me _____ të sasisë së importuar dhe ndërmarrja Agro Blend SHPK me _____ të sasisë së importuar. Ndërmarrjet e tjera zënë nën 7 % të sasisë së importuar të sheqerit. Zëri “Për Tjera” përfshin rreth 39 ndërmarrje importuese të sheqerit të bardhë, por që pesha specifike e secilës prej tyre është shumë e vogël.

Informacioni për siguruar gjatë monitorimit të zhvilluar në vitin 2023 me nr. 410/5, prot., datë 23.10.2023 “Informacion në lidhje me monitorimin e tregut të tregtimit të produkteve oriz dhe sheqer”, konstatohet se ndërmarrja Agrana Studen Albania SHPK tregtonte sheqer vetëm në nivel shumice, për klientë si Teuta, Coca Cola, Pepsi etj., në paketime të gatshme 50 kg dhe 1 kg, pa operuar në tregun e shitjes me pakicë. Sipas këtij informacioni, sheqeri për importuar nga kjo ndërmarrje tregtohej në markete nga Teuta SHPK, e cila ka ekskluzivitet për paketimin 1 kg.

Gjithashtu gjatë monitorimit të realizuar gjatë periudhës 17 dhjetor 2025 – 15 janar 2025, vihet re në disa prej marketeve të monitoruara në raftet e tyre kishin vetëm marken e sheqerit të ndërmarrjes Ferra & Co, sjellje e cila ngre dyshime për aplikimin e kontratave ekskluziviteti me kushte.

Gjatë vitit 2025, çmimi CIF i produktit sheqer, luhet nga 46 deri në 63 lekë/kg, ku vlerën më të ulët e ka patur në muajt shtator, tetor 2025, ndërsa vlerën më të lartë në mars 2025. Nga muaji mars 2025, vërehet një ulje e çmimit mesatar mujor CIF të sheqerit.

Referuar sa më sipër, nga analiza e të dhënave sasiore dhe strukturore të tregut të importit të sheqerit për vitin 2025 rezulton se ky treg paraqet përqendrim të lartë dhe varësie të plotë nga furnizimi ndërkombëtar. Nevojat e tregut vendas për sheqer mbulohen në masën 100% nga importi, çka e bën këtë treg veçanërisht të ndjeshëm ndaj sjelljeve të operatorëve kryesorë në nivelet e importit dhe tregtimit me shumicë. Duke qenë se sheqeri është një produkt bazë ushqimor, me kërkesë relativisht inelastike, çdo kufizim ose shtrembërim i konkurrencës në hallkat e sipërme të zinxhirit reflektohet drejtpërdrejt në çmimet dhe kushtet e furnizimit për konsumatorin përfundimtar.

Struktura e importit të sheqerit të bardhë vërehet se ka një nivel të lartë përqendrimi, ku tre ndërmarrje kryesore zotërojnë rreth _____ të sasisë totale të importuar. Në veçanti, AGRANA–STUDEN ALBANIA SHPK zë _____ sipas volumit të importit, e ndjekur nga FERRA & CO INDUSTRIAL IMPEX SHPK me _____ dhe AGRO BLEND SHPK me _____. Pjesa e mbetur e tregut ndahet mes një numri të konsiderueshëm operatorësh të vegjël, të cilët individualisht kanë peshë të papërfillshme në treg.

Analiza e funksionimit të zinxhirit të tregtimit evidenton gjithashtu ndarje të qartë funksionale midis tregut me shumicë dhe atij me pakicë, më një integrim vertikal ndërmjet tyre. Ndërmarrja AGRANA–STUDEN ALBANIA SHPK operon në nivel importi dhe shitjeje me shumicë, duke furnizuar klientë të mëdhenj industrialë dhe tregtarë. Megjithatë, ekzistenca e një marrëdhënieje

ekskluzive me ndërmarrjen Teuta SHPK për paketimin e sheqerit në ambalazh 1 kg, i destinuar për tregun me pakicë, krijon një lidhje vertikale, e cila mund të kufizojë hyrjen e operatorëve të tjerë në këtë segment të tregut.

Dinamika e çmimeve CIF, megjithëse tregon një tendencë rënëse gjatë pjesës së dytë të vitit 2025, nuk përjashton rrezikun e ushtrimit të fuqisë së tregut. Në një treg me kërkesë inelastike dhe përqendrim të lartë, ndryshimet e çmimeve në hallkat e importit dhe shumicës mund të mos reflektohen plotësisht ose në mënyrë simetrike në çmimet për konsumatorin përfundimtar, veçanërisht kur ekzistojnë marrëdhënie ekskluzive dhe kontroll i kufizuar i kanaleve të shpërndarjes.

Duke marrë në konsideratë të gjitha sa më sipër, përkatësisht varësinë e plotë nga importi, përqendrimin e lartë të tregut, pozicionin e fortë të disa operatorëve kryesorë, si dhe ekzistencën e marrëdhënieve ekskluzive vertikale që mund të kufizojnë aksesin në treg dhe konkurrencën efektive, konstatohet se ekzistojnë indicie të arsyeshme për kufizim ose shtrembërim të konkurrencës në kuptim të neneve 4 dhe/ose 9 të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 4, nenit 9, nenit 24, shkronja d), si dhe nenit 42 pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e përpunimit dhe tregtimit të sheqerit;
2. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janar 2025 deri në 31 Janar 2026;
3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1272, Datë 25.02.2026

“MBIAUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË WARNER BROS. DISCOVERY, INC. NGA SHOQËRIA NETFLIX, INC.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë Warner Bros. Discovery, Inc. nga shoqëria Netflix, Inc.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përftimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Warner Bros. Discovery, Inc. nga shoqëria Netflix, Inc.”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar për përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë Warner Bros. Discovery, Inc. nga shoqëria Netflix, Inc.
2. Referuar dokumentit “Marrëveshje dhe Plani i Bashkimit”, të lidhur më datë [] palët janë:
3. **Blerësi: Netflix, Inc.** është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të shtetit Delaware, SHBA dhe një ofrues i shërbimeve *streaming* audio-vizuale të transmetimit direkt te konsumatori. Netflix, Inc. prodhon si dhe licencon/ blen përmbajtje audiovizuale (filma, seriale televizive, dokumentarë dhe lojëra interaktive), nga burime të shumta për transmetim të drejtpërdrejtë tek konsumatorët.

- **Shoqëria Nightingale Sub, Inc., (filiali i bashkuar)**, si palë në Marrëveshje, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të shtetit Delaware, SHBA dhe degë tërësisht në pronësi të blerësit
- 4. Netflix, Inc., [____], por realizon të ardhura nga furnizimi me pakicë i shërbimeve audiovizuale për përdoruesit fundorë, përmes platformës së tij të transferimit *streaming*.
- 5. **Target: Warner Bros. Discovery, Inc.** është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të shtetit Delaware, SHBA, një kompani globale e medias dhe argëtimit që krijon dhe shpërndan një portofol përmbajtjesh audiovizive.
- **Shoqëria New Topco 25, Inc., (shoqëria e re)**, si palë në Marrëveshje, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të shtetit Delaware, SHBA dhe është degë tërësisht në pronësi të shoqërisë target.
- 6. Warner Bros. Discovery, Inc. [____], por është aktive në: shpërndarjen në kinema të filmave (vetëm nëpërmjet Blitz Film& Video Distribution Limited); licencimin e përmbajtjes audiovizive (WB licencon kontent/përmbajtje vetëm në nivel rajonal dhe europian); furnizimi me shumicë i kanaleve televizive; dhe furnizimi me pakicë i shërbimeve audiovizuale për përdoruesit fundor.

II. Përqendrimi

- 7. Ndërmjet palëve Warner Bros. Discovery, Inc. (shoqëria target), Netflix, Inc. (blerësi), Nightingale Sub, Inc., degë tërësisht në pronësi të blerësit (filiali i bashkuar) dhe New Topco 25, Inc., degë tërësisht në pronësi të shoqërisë target (shoqëria e re) është lidhur “Marrëveshje dhe Plani i Bashkimit”, më datë [____].
- 8. Referuar deklaratës së palës njoftuese në përputhje me “Marrëveshjen dhe Planin e Bashkimit”, Netflix, Inc. planifikon të blejë të gjithë titujt me të drejtë vote të shoqërisë Warner Bros. Discovery, Inc., në këmbim të shumës së paguar dhe aksioneve të shoqërisë Netflix, Inc.
- 9. *Së pari*: Warner Bros. Discovery, Inc. do të nënshtrohet një riorganizimi, në kuadër të të cilit do t’i kalojë të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë sipas “Marrëveshjes dhe Planin e Bashkimit”, filialit të saj në pronësi të plotë, New Topco 25, Inc., një entitet i sapothemeluar, i cili do të zëvendësojë shoqërinë Warner Bros. Discovery, Inc. në bashkim.
- 10. *Së dyti*: Warner Bros. Discovery, Inc. më pas do të bashkohet me një shoqëri të sapokrijuar dhe do të zotërohet plotësisht nga New Topco 25, Inc. (Holdco Merger), ku më pas Warner Bros. Discovery, Inc. do të jetë si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (së bashku me “Holdco Merger”, “Holdco Reorganization”). Përpara mbylljes së transaksionit, por pas Holdco Reorganization dhe në përputhje me “Marrëveshjen e Ndarjes dhe Shpërndarjes”, Warner Bros. Discovery, Inc. do të shkëpusë aktivitetin e saj të Rrjeteve Globale/Global Networks dhe do të mbajë vetëm aktivitetin e Transmetimit/Streaming dhe Studiove.

11. *Së treti*: Warner Bros. Discovery, Inc. në formën tashmë të Warner Bros., do të bashkohet përfundimisht me shoqërinë në pronësi të plotë të Netflix, Inc., shoqërinë Nightingale Sub, Inc., shoqëri sapo e themeluar (Merger Sub).
12. Në mbyllje të këtij transaksioni, Netflix, Inc. do të ushtrojë kontroll të vetëm mbi shoqërinë Warner Bros. Discovery, Inc.
13. Për sa më sipër transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë Warner Bros. Discovery, Inc nga shoqëria Netflix, Inc., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

14. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shërbimeve të prodhimit dhe shpërndarjes audiovizuale, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
15. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë Warner Bros. Discovery, Inc. nga shoqëria Netflix, Inc.
16. Shoqëria Warner Bros. Discovery, Inc. (target) është një shoqëri globale e medias dhe argëtimit që krijon dhe shpërndan një portofol përmbajtjesh audiovizive.
17. Para transaksionit targeti zhvillonte veprimtarinë e tij në tre linja biznesi: Transmetimi/Streaming, i cili përbëhet kryesisht nga shërbimet PayTV dhe shërbime streaming; Studio, që përbëhet kryesisht nga prodhimi dhe publikimi i filmave për shfaqje fillestare në kinema, si dhe prodhimi dhe licencimi fillestar i programeve televizive për palët e treta; dhe Global Linear Networks, i cili përbëhet kryesisht nga rrjetet televizive vendase dhe ndërkombëtare të Target.
18. Si pjesë e transaksionit, Target, nëpërmjet një procesi shkëputje (spin-off), parashikon për t’u ndarë në dy shoqëri të listuara në bursë, konkretisht Warner Bros dhe Discovery Global. Pjesë e transaksionit do të jetë vetëm Warner Bros (WB), i cili do të përbëhet kryesisht nga linja e biznesit Streaming dhe Studio të target (përfshirë Warner Bros. Television, Warner Bros. Motion Picture Group, DC Studios, HBO dhe HBO MAX, si edhe bibliotekat e saj të filmave dhe programeve televizive), dhe do të blihet nga Blerësi.
19. Blerësi, shoqëria Netflix, Inc., është një ofrues i shërbimeve streaming audio-vizuale të transmetimit direkt te konsumatori. Netflix, Inc. prodhon si dhe licencon/ blen përmbajtje audiovizuale (filma, seriale televizive, dokumentarë dhe lojëra interaktive), nga burime të shumta për transmetim të drejtpërdrejtë tek konsumatorët.

20. Netflix, Inc. [____], por realizon të ardhura nga furnizimi me pakicë i shërbimeve audiovizuale për përdoruesit fundor, përmes platformës së tij të transmetimit streaming.
21. Target, Warner Bros. Discovery [____], por është aktive në: shpërndarjen në kinema të filmave (vetëm nëpërmjet Blitz Film& Video Distribution Limited); licencimin e përmbajtjes audio-vizive (WB licencon kontent/përmbajtje vetëm në nivel rajonal dhe europian); furnizimi me shumicë i kanaleve televizive; dhe furnizimi me pakicë i shërbimeve audiovizuale për përdoruesit fundor.
22. Nga analiza e konkurrencës, u konstatua se tregu për ofrimin me pakicë të shërbimeve audio-vizive për përdoruesit fundor është i vetmi treg produkti në Shqipëri ku ka një mbivendosje horizontale midis aktivitetit të Palëve, por pa sjellë shqetësime për konkurrencën nëpërmjet krijimit apo forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë Warner Bros. Discovery, Inc. nga shoqëria Netflix, Inc.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1273, Datë 25.02.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË DISA ASETEVE QË LIDHEN ME BIZNESIN ESTEE LAUDER BULGARIA EOOD NGA SHOQËRIA ORBICO BULGARIA EOOD”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim e kontrollit të disa aseteve që lidhen me biznesin Estee Lauder Bulgaria EOOD nga shoqëria Orbico Bulgaria EOOD.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitimit të kontrollit të disa aseteve që lidhen me biznesin Estee Lauder Bulgaria EOOD nga shoqëria Orbico Bulgaria EOOD.”,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar të përfitimit të kontrollit të disa aseteve që lidhen me biznesin Estee Lauder Bulgaria EOOD nga shoqëria Orbico Bulgaria EOOD.
2. Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

3. **Pala Blerëse: Orbico Bulgaria EOOD** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Bullgarisë, me objekt aktiviteti tregti brenda dhe jashtë, tregti me shumicë, përfaqësim tregtar, ndërmjetësim, shërbime transporti, konsultime, reklama, informacione, servis, ndërtime, projekte, programim, marketing, si dhe çdo veprimtari tjetër të cilën nuk e ndalon ligji. Orbico Bulgaria EOOD kontrollohet plotësisht nga ORBICO d.o.o., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kroacisë, me objekt aktiviteti blerja dhe shitja e mallrave, kryerja e ndërmjetësimit tregtar në tregun e brendshëm dhe të huaj, përfaqësimi i kompanive të huaja, transporti rrugor i mallrave, transporti i mallrave në trafikun ndërkombëtar, reklamim etj.
4. ORBICO d.o.o. është shoqëria mëmë e grupit të shoqërive ORBICO. ORBICO Group është distributor i një numri të madh markash, duke filluar nga produktet e kujdesit të bukurisë, produktet ushqimore dhe jo ushqimore, pajisjet teknike dhe elektrike deri në farmaceutikë, lodrat, tekstilet, cigaret, si dhe produktet e vajit motorik.
5. Shoqëria ORBICO d.o.o. zotëron 100% të kuotave të shoqërisë ORBICO SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti tregtim artikujsh industrial, import dhe eksport me shumicë dhe pakicë pijesh alkoolike, duhan, cigare, produkte kozmetike, karburante të ndryshme, vajra lubrifikantë etj.

Pala Shitëse:

6. **Estee Lauder Bulgaria EOOD** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Bullgarisë, me objekt aktiviteti import dhe eksport, shitje me shumicë, shitje dhe distribuim të kozmetikës prestigjioze, parfumeri dhe produkte të lidhura me kozmetikën, si dhe çdo veprimtari tjetër të cilën nuk e ndalon ligji.
7. **Estee Lauder Hellas S.A.** është një shoqëri anonime, e themeluar sipas ligjeve të Greqisë, me objekt aktiviteti tregtimin, importin, eksportin, marketingun, shpërndarjen, shitjen, furnizimin e produkteve kozmetike, farmaceutike, parfumeve etj; ofrimin e shërbimeve të konsulencës për të gjitha çështjet që lidhen me promovimin, krijimin, organizmin ndërtimin, marketingun, organizimin e programeve të trajtimit profesional etj.
8. Referuar skemës së depozituar, Estee Lauder Bulgaria EOOD dhe Estee Lauder Hellas S.A. zotërohen drejtpërdrejt nga shoqëria Estee Lauder Europe, Inc. (U.S). dhe indirekt nga shoqëria The Estee Lauder Companies, Inc. (U.S.).
9. **Target:** target përfshijnë asetet fikse të përdorura në operimin e 7 (shtatë) dyqaneve fizike me pakicë të Estee Lauder Bulgaria EOOD, si dhe marrëveshjet kontraktuale dhe operacionale të nevojshme për vazhdimin e aktivitetit të biznesit. Dyqanet me pakicë të operuara nga Estee Lauder Bulgaria EOOD janë të vendosura në ambiente tregtare të marra me qira nga Shitësi, të gjitha në territorin e Bullgarisë dhe shesin ekskluzivisht marka kozmetike premium.
10. Target nuk ka prani të drejtpërdrejtë apo indirekte në Shqipëri.

II. Përqendrimi

11. Më datë [____], ndërmjet shoqërisë Estee Lauder Hellas S.A. (Shoqëria) dhe Orbico Bulgaria EOOD (Shitësi me Pakicë) është nënshkruar “Marrëveshja e Furnizimit dhe Licencës”. [____].
12. [____]
13. Referuar shkresës nr. 77/3 prot. i AK, datë 12.02.2026 “Plotësim Informacioni”, ndërmjet shoqërive Orbico Bulgaria EOOD (Blerësi) dhe Estee Lauder Bulgaria EOOD (Shitësi) janë nënshkruar “Marrëveshje për Blerjen e Aseteve” dhe “Marrëveshje për Blerjen e Mallrave” më datë 19 janar 2026. Bazuar në “Marrëveshje për Blerjen e Aseteve”, shitësi shet, transferon dhe i cakton blerësit dhe blerësi blen nga shitësi, të gjitha asetet fikse, të cilat përbëjnë një pjesë integrale të kësaj marrëveshje dhe përfshijnë një listë me asete në dyqane të pavarura. [____].
14. Referuar deklaratës së palës njoftuese, blerësi do të fitojë të drejtën për të operuar Dyqanet me Pakicë për shitjen me pakicë të kozmetikës selektive të klasit premium, si dhe të drejtën për të shpërndarë produkte kozmetike dhe të bukurisë që aktualisht janë pjesë e portofolit të Estee Lauder Bulgaria EOOD, duke siguruar vazhdimësinë e operacioneve të biznesit dhe praninë e pandërprerë të markave në tregun bullgar.
15. Pas përfundimit, Orbico Bulgaria EOOD do të ushtrojë kontrollin e vetëm mbi asetet dhe operacionet përkatëse të biznesit në Bullgari.
16. Bazuar në Udhëzimin “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 1.3 “Objekti i Kontrollit”, parashikohet se: “Përfitimi i kontrollit mbi asetet mund të konsiderohet si një përqendrim, vetëm nëse këto asete përbëjnë ndërmarrjen si një e tërë ose një pjesë të saj d.m.th. një biznes me një përfaqësim në treg, e cila ka një xhiro vjetore tregu. Një transaksion në lidhje me asetet e pa-prekshme të tilla si markat, patentat ose të drejtën e autorit mund të konsiderohet një përqendrim nëse këto asete përbëjnë një biznes me një xhiro vjetore. Në çdo rast, transferta e licencave të markës, patentave ose të drejtave të autorit, pa asete të tjera shtesë, mundet vetëm të plotësojnë këto kriteret nëse licencat janë ekskluzive në të paktën një territor të caktuar dhe transfertat e këtyre licencave do të transferojnë aktivitetin që gjeneron xhiroja. Nga licencat jo-ekskluzive mund të përjashtohen ato që mund të përbëjnë një biznes me vete, të cilat gjenerojnë xhiro në treg.”. Referuar deklaratës së palëve, Asetet Target kanë realizuar një xhiro vjetore tregu për vitin 2024.
17. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të disa aseteve që lidhen me biznesin Estee Lauder Bulgaria EOOD nga shoqëria Orbico Bulgaria EOOD, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”. Si i tillë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

18. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shitjes me pakicë të produkteve premium kozmetike dhe të bukurisë, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
19. Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të disa aseteve që lidhen me biznesin Estee Lauder Bulgaria EOOD nga shoqëria Orbico Bulgaria EOOD.
20. ORBICO BULGARIA EOOD është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit bullgar, e cila kontrollohet 100% nga ORBICO d.o.o., një shoqëri aktive kryesisht në shitjen dhe distribucionin e produkteve kozmetike, ushqimore dhe jo ushqimore, farmaceutike, tekstile, etj. ORBICO d.o.o. është prezente në Shqipëri nëpërmjet ORBICO SHPK, e cila operon kryesisht në tregun e produkteve të konsumit të shpejtë (FMCG) dhe tregun e bukurisë në vend.
21. Target përfshin asetet fikse të përdorura në operimin e dyqaneve me pakicë të Estee Lauder Bulgaria EOOD në Bullgari, të vendosura në ambiente tregtare të marra me qira nga shitësi. Target nuk ka prani të drejtpërdrejtë apo indirekte në Shqipëri.
22. Transaksioni do ti mundësojë Orbico-s të marrë përsipër dhe të vazhdojë shpërndarjen e produkteve të Shitësit si dhe operimin e dyqaneve të markave me pakicë në Bullgari.
23. Nga sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës konstatoi se përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshime në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të disa aseteve që lidhen me biznesin Estee Lauder Bulgaria EOOD nga shoqëria Orbico Bulgaria EOOD.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1274, Datë 25.02.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR PËRJASHTIMIN NË BLOK TË KATEGORIVE TË MARRËVESHJEVE VERTIKALE DHE PRAKTIKAVE TË BASHKËRENDUARA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi shfuqizimin e nenit 8 të Rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”, miratuar me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1249 datë 19.12.2025

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

-Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

-VBER (EU) 2022/720;

-Vendimin e Komisioni i Konkurrencës nr. 1249, datë 19.12.2025, rregulloren “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”;

-Komentet e Komisionit Evropian;

-Projekt – Vendimin e Komisionit të Konkurrencës “Për një ndryshim në rregulloren “për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”, miratuar me vendimin e Komisioni i Konkurrencës nr. 1249 datë 19.12.2025.

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”, miratuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1249, datë 19.12.2025, **neni 8 shfuqizohet**.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1275, Datë 25.02.2026

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPRAK NË TREGUN E TRANSPORTIT DETAR NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVË NË PORTIN E DURRËSIT DHE VLORËS ME DISA DETYRIME PËR NDËRMARRJET QË OPEROJNË NË TREG DHE DISA REKOMANDIMEVE PËR MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z. Denar BIBA	Kryetar
Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Rezana KONOMI	Anëtar
Znj. Fatjola DELIJA	Anëtar
Z. Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimi i Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës.

Baza Ligjore: Neni 4 dhe 9, neni 24, shkronja d), neni 26, neni 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit mbi hetimin paraprak në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës; dhe;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi raportin e hetimit paraprak,

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, gjatë muajit Qershor 2025, ka zhvilluar procedurën e monitorimit të tregut të transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe portin e Vlorës, me qëllim evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në këtë treg.

2. Komisioni i Konkurrencës, në përfundim të këtij monitorimi, bazuar në nenin 42 pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me Vendimin nr. 1194, datë 21.07.2025, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës”, të ndryshuar me VKK nr. 1245, datë 12.12.2025, vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës, për të vlerësuar nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të nenit 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003. Hetimi paraprak përfshin periudhën kohore 1 Janar 2022 deri në 30 Qershor 2025.
3. Në zbatim të vendimit të mësipërm të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të ligjit nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 529/11, datë 21.07.2025 "Autorizim inspektorësh", Inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës, gjatë periudhës së hetimit paraprak kryen inspektime pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës.
4. Në vazhdim të procedurës, për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121/2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, gjatë periudhës së hetimit paraprak janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: Agjencitë Detare përfaqësuese të operatorëve të trageteve, që ushtrojnë veprimtari në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, Autoriteti Portual Durrës dhe Portit Detar Vlorë SHA.

II. ANALIZA E KONKURRENCËS

II.1 Tregu Përkatës

5. Përcaktimi i tregut përkatës është elementi kryesor i analizës së konkurrencës. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, si dhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”: *“Treg përkatës janë produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët, ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen, ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”*. Në zbatim të ligjit nr. 9121/2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
6. Shërbimi i transportit detar në Shqipëri realizohet nëpërmjet portit të Durrësit në linjat me destinacion Bari dhe Ankona dhe nëpërmjet portit të Vlorës linjën me destinacion Brindisi.

7. Për qëllime të hetimit, treg përkatës produkti do të konsiderohet shërbimi i transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve që realizohet nga Porti i Durrësit dhe Porti i Vlorës. Duke pasur parasysh destinacionin e linjave të trageteve dhe zëvendësueshmërinë e tyre nga ana e kërkesës dhe ofertës, tregu përkatës ndahet sipas nëntregjeve të mëposhtme:
- Nëntregu i shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve nga Porti i Durrësit në drejtim të Portit të Barit, Itali dhe anasjelltas;
 - Nëntregu i shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve nga Porti i Durrësit në drejtim të Portit të Ankonës, Itali dhe anasjelltas;
 - Nëntregu i shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve nga Porti i Vlorës në drejtim të Portit të Brindisit, Itali dhe anasjelltas.
8. Tregu përkatës gjeografik janë Portet e Durrësit dhe Vlorës ku kryhet transport detar i udhëtarëve.

II.2 Struktura e tregut dhe sjellja e ndërmarrjeve në treg

9. Në tregun përkatës, pra në tregun e shërbimit të transportit detar të udhëtarëve operojnë 4 operatorë të trageteve, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në portet e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet Agjencive Detare përfaqësuese.
10. Në portin e Durrësit, në linjën Durrës - Bari - Durrës operojnë 3 operatorë konkretisht:
- Operatori Adria Ferries SPA, me seli në Ankona, Itali, i cili përfaqësohet në Shqipëri nga agjencia AF Agency SHPK, me qendër në Durrës, me numër NUIS: XXX;
 - Operatori Nobel Maritime INC me seli në Pire, Greqi, kompania menaxhuese e trageteve të Ventouris Ferries, të cilët përfaqësohen në Shqipëri nga agjencia Duni Port Agency SHPK (Pelagio Agency SHPK), me qendër në Durrës, me numër NUIS: XXX;
 - Operatori Grandi Navi Veloci SPA (GNV), me seli në Palermo, Itali, i cili përfaqësohet në Shqipëri nga agjencia Niki Mare SHPK, me qendër në Durrës, me numër NUIS: XXX;

ndërsa në linjën Durrës - Ankona - Durrës operon një operator Adria Ferries S.P.A/AF Agency SHPK, i cili nuk ka konkurrent të tjerë, duke zotëruar pozitë dominuese në këtë linjë.

11. Në portin e Vlorës, deri në datë 04.10.2024, kanë ushtruar aktivitet në tregun e shërbimit të transportit detar të udhëtarëve dy operatorë:
- Operatori Tnitsea Shipping LDA, me seli në Madeira, Portugali, e cila përfaqësohet në Shqipëri nga agjencia Euroferries SHPK, me qendër në Vlorë, me NUIS: XXX;

- A-Ships Management SA, me seli në Athin, Greqi, e përfaqësuar nga agjensia detare Gerverni Sea Lines SHPK, me NUIS: XXX, operator i cili e ka ndërprerë në mënyrë të njëanshme shërbimin dhe ka pezulluar aktivitetin që nga janari 2025.

Nga data 04.10.2024 operatori Tnitsea Shipping LDA/Euroferries SHPK ushtron veprimtari i vetëm në linjën Vlorë – Brindisi - Vlorë duke zotëruar pozitë dominuese në këtë treg.

12. Lidhur me metodologjinë e përcaktimit të çmimeve të aplikuara nga operatorët, një nga faktoret përcaktues, i cili pasqyrohet në çmimin final të biletave, janë edhe tarifatat portuale, të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ministrisë së Financave, me nr. 4, datë 11.6.2021, “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës për vitin 2021”, si dhe Urdhërin e përbashkët nr. 3069, datë 14.6.2016, “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në Portet Detare Vlorë, Sarandë dhe Shëngjin”, të ndryshuar.
13. Për linjën Durrës-Bari-Durrës, operatori Adria Ferries S.P.A/AF Agency SHPK, gjatë periudhës hetimore zë rreth të pjesës së tregut sipas numrit të pasagjerëve për vitin 2022, gjatë vitit 2023, dhe në rënie për vitin 2024 dhe gjashtë mujorin e parë të 2025 me përkatsisht rreth dhe të tregut. Kjo rënie verëhet pas hyrjes së operatorit të ri GNV, i cili për vitin 2024 ka zënë rreth të tregut sipas numrit të pasagjerëve dhe për periudhën janar – gusht rreth të numrit të pasagjerëve.
14. Nobel Maritime INC/Duni Port Agency SHPK për vitet 2022 dhe 2023 zotëron mbi të tregut sipas numrit të pasagjerëve, ndërsa pas hyrjes së operatorit të ri GNV në këtë linjë, pjesa e tregut të Nobel Maritime INC paraqitet mbi e cila vazhdon edhe për 6 mujorin e parë të vitit 2025.
15. Për periudhën hetimore, të ardhurat e operatorëve janë në nivele të qëndrueshme të cilat gjenerojnë dhe norma fitimi pozitive. Nga sa vërehet ndërmarrja Nobel Maritime INC e cila operon vetëm në linjën Durrës-Brindizi rezulton me norma fitimi relativisht të larta nga për periudhën hetimore.
16. Indeksi i përqendrimit HHI sipas nëntregjeve, tregon se të gjitha nëntregjet e shërbimit të transportit detar të udhëtarëve për linjën Durrës-Bari–Durrës është shumë i përqendruar. Ndërsa për linjën Durrës–Ankona-Durrës dhe Vlorë – Brindisi –Vlorë operatorët përkatës në treg zotërojnë të tregut duke rezultuar në HHI me vlerë maximale.
17. Nga të dhënat e pasqyrave financiare për vitet 2022, 2023 dhe 2024 të ndërmarrjeve nën hetim, vërejmë se gjatë tre viteve të fundit kanë patur norma pozitive fitimi dhe relativisht të larta.

18. Duke patur parasysh kriteret kryesore për të vlerësuar pozitën dominuese në treg bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2013, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si pjesët e tregut, treguesit të përqendrimit, fuqinë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjeve, barrierat e hyrjes në treg, konkurrencën potenciale, transparencën e tregut etj., konstatohet se:
- Ndërmarrja AF Agency SPA/Adria Ferries SHPK ka pozitë dominuese në nëntregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve nga Porti i Durrësit drejt Portit të Ankonës;
 - Ndërmarrja Tnitsea Shipping LDA/Euroferries SHPK ka pozitë dominuese në nëntregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve nga Porti i Vlorës drejt Portit të Brindisit.
19. Nga analiza e çmimeve mesatare mujore të biletave të shitura për linjën Durrës-Ankona-Durrës për vitin 2022 vërehet një rritje e konsiderueshme e çmimit të shitjes së biletave në sezonet e pikut. Përgjatë vitit çmimet e biletave variojnë më e ulta rreth 15 euro dhe çmimi më i lartë 190 euro. Për vitin 2023 çmimet e shitjes së biletave për linjën Durrës-Ankona variojnë nga çmimi më i ulët rreth 7.5 euro dhe çmimi më i lartë 200 euro. Çmimet e shitjes së biletave përgjatë vitit 2024 variojnë nga çmimi më i ulët rreth 10 euro dhe çmimi më i lartë 240 euro ndërsa për periudhën janar-qershor 2025 variojnë nga çmimi më i ulët rreth 15 euro dhe çmimi më i lartë 266 euro.
20. Nga analiza e çmimeve mesatare të aplikuara nga operatori Adria Ferries SPA/AF Agency SHPK vërehet se çmimet e aplikuara për të gjitha kategoritë janë nën nivelin maksimal të miratuar nga Ministria.
21. Gjatë hetimit paraprak u kërkuar nga ndërmarrjet edhe struktura e kostos. Nga përgjigjet e ndërmarrjeve edhe gjatë inspektimeve por edhe gjatë përgjigjes shkresore, nuk rezultoi të kenë informacion të detajuar për çdo zë të kostove fikse apo variabël, pasi sipat tyre çmimet e biletave përcaktohen nga ndërmarrjet e huaja pronare/menaxhuese të anijeve dhe jo nga agjentët detarë që operojnë në shqipëri.
22. Duke qënë se operatori Adria Ferries SPA është një ndërmarrje me pozitë dominuese në nëntregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve me nisje nga porti i Durrësit drejt portit të Ankonës, nga vlerësimi i sjelljes kontraktore të këtij Operatori dhe Agjentit të tij AF Agency SHPK, nën këndvështrimin e nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003, rezultoi se, në marrëdhëniet juridike që ato krijojnë ndërmjet tyre dhe me të tretët, në të drejtat dhe detyrimet e vendosura për palët, operojnë duke ju përmbajtur kushteve të përgjithshme të kontratave, në respekt të detyrimeve ligjore dhe kontraktore, duke mos aplikuar forma

kufizuese që mund të bien ndesh me nenin 9, të ligjit nr. 9121/2023 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

23. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes AF Agency SPA, me pozitë dominuese në nëntregun e shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve për linjën Durrës – Ankona – Durrës dhe anasjelltas, nga krahasimi i tarifave të aplikuara dhe trendit të tyre gjatë periudhës hetimore, Benchmark-ut rajonal dhe krahasimit të çmimeve të biletave të aplikuara me tarifat e miratuara si dhe kontratave të operatorit, rezulton se nuk vërehen shenja të abuzimit me pozitën dominuese, sipas nenit 9 të ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, nga ndërmarrja AF Agency SPA në nëntregun përkatës për periudhën nën hetim.
24. Nga analiza e çmimeve mesatare mujore të biletave të shitura për linjën Vlorë – Brindisi - Vlorë për vitin 2022 çmimet e aplikuara variojnë sipas kategorive nga më i ulti 7 euro deri te më i larti 95 euro. Për vitin 2023, çmimi mesatar mujor i biletave varion nga më i ulti 7 euro te më i larti 125 euro. Edhe për vitin 2024 çmimet mesatare mujore të shitje së biletave kanë variuar nga çmimi më i ulët 15 euro te çmimi më i lartë 165 euro. Në këtë vit vihet re një rritje e çmimeve sipas kategorive por mbeten brenda kufirit të miratuar nga Ministria. Edhe për 6 mujorin e 2025 çmimet e biletave variojnë nga 15 euro çmimi më i ulët te 165 euro çmimi më i larte.
25. Nga vlerësimi i kontratave të administruara gjatë hetimit, të ndërmarrjeve Tnitsea Shipping LDA përfaqësuar nga agjencia Euroferries SHPK, në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve në portin Vlorë, në marrëdhëniet juridike që këto ndërmarrje krijojnë ndërmjet tyre dhe me të tretët, në të drejtat dhe detyrimet e palëve, përgjithësisht operojnë duke ju përmbajtur kushteve të përgjithshme të kontratave, në respekt të detyrimeve ligjore dhe kontraktore, duke mos aplikuar forma kufizuese që mund të bien ndesh me nenin 9, të ligjit 9121/2023 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
26. Si konkluzion, referuar analizës së sjelljes së ndërmarrjes Tnitsea Shpiping LDA, me pozitë dominuese në nëntregun e shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve për linjën Vlorë – Brindisi – Vlorë, nga krahasimi i tarifave të miratuara nga Ministria me çmimet mesatare mujore të shitjes së biletave si dhe benchmark rajonal si dhe kontratave të operatorit rezulton se nuk vërehen shenja të abuzimit me pozitën dominuese, sipas nenit 9 të ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, nga ndërmarrja Tnitsea Shpiping LDA në nëntregun përkatës të shërbimit të transportit detar në linjën Vlorë – Brindisi - Vlorë për periudhën nën hetim.
27. Tarifat e aplikuara nga operatorët AF Agency SPA/Adria Ferries SHPK dhe Nobel Maritime INC/Duni Port Agency SHPK, nuk janë të njëjta, pra nuk vërehen shenja të bashkërendimit

ndërmjet operatorëve edhe për sa i përket rradhës së nisjeve/mbërritjes të trageteve nga Porti për linjën Durrës – Bari nuk vërehet një rregull i caktuar për hyrje - daljet e trageteve pra nuk vërtetohet një koordinim në sjelljen e operatoreve lidhur me një ndarje të mundshme tregu, apo elementë që tregojnë për ekzistencë të një marrëveshjeje apo praktike të bashkërenduar në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

28. Tregu i shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve ka qenë objekt monitorimi, hetimi dhe vendimmarrjeje nga ana e Autoritetit të Konkurrencës edhe më parë. Përkatësisht, me VKK nr. 248, datë 11/10/2012, “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit detar ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve në qytetin e Vlorës”; VKK nr. 349, datë 19/02/2015, “Për masat rregulluese dhe rekomandimet në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”; VKK nr. 369, datë 2.07. 2015 “Për disa masa detyruese në tregun e shërbimit të transportit ndërkombëtar detar në Portin e Vlorës”; si dhe VKK nr. 467, datë 04.07.2017, “Për marrjen e disa masave për rregullimin e konkurrencës në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak.”
29. Lidhur me rekomandimet e mësipërme, nga hetimi paraprak në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës dhe Durrësit, hapur me VKK nr. 1194, datë 21.07.2025, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës”, rezulton se, rekomandimet e dhëna nga Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr. 349, datë 19/02/2015 “Për masat rregulluese dhe rekomandimet në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve” janë reflektuar në nenin 10 të Udhëzimit të MIE nr. 883, datë 21.12.2018, “Për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit kombëtar dhe ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre”, (i cili ka shfuqizuar Udhëzimin e MTI nr. 4, datë 21.5.2015 "Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre", të ndryshuar).
30. Mbi zbatimin e pikave të nenit 10 të Udhëzimit, është kërkuar informacion nga Porti Detar Vlorë SHA, Autoriteti Portual Durrës dhe MIE. Sa i përket zbatimit të detyrimit mbi depozitim të detajuar të të gjitha kostove reale për shërbimin që ofrojnë subjektet e licencuara, si pjesë e kontratës së lidhur me portin/terminalin portual, Porti Detar Vlorë SH.A në shkresën e tij nr. 529/46 prot. AK, datë 15.01.2026, “Kthim përgjigje”, shprehet se: “.. ky udhëzim është praktikisht jo korrekt, sepse kur tarifat janë deklaruar në autoritetet përkatëse dhe është marrë dhe leja e aktivitetit, atëherë ska asnjë rol paraqitja e kostove për lidhjen e kontratës”. Mos

zbatimi në praktik i detyrimeve të reflektuara në nenin 10 të udhëzimit të mësipërme, rezulton edhe nga shqyrtimi dhe vlerësimi i përmbajtjes së kontratave të lidhura midis agjentëve detar dhe Portit/Autoritetit portual. Konkretisht është konstatuar se në këto kontrata mungojnë dispozitat përkatëse lidhur me detyrimin e operatorëve për depozitimin e kostove reale për shërbimin që ofrojnë, ashtu dhe mbajtjen e të dhënave ditore për tarifat e aplikuara për çdo biletë të shitur, dhe mbajtjen e rekordeve të shitjeve të biletave nga ndërmarrjet që operojnë në treg. Mungesa e depozitimit të kostove reale për shërbimet e ofruara, ka sjellë për pasojë në mungesën e një metodologjie, bazuar në kostot reale, për përcaktimin e nivelit të tarifave maksimale për shërbimin e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve dhe automjeteve, në zbatim të rekomandimeve të dhëna MIE me VKK nr. 349, datë 19/02/2015.

31. Si konkluzion, sa i përket zbatimit në praktikë të rekomandimeve të dhëna me VKK nr. 349, datë 19/02/2015 “Për masat rregulluese dhe rekomandimet në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”, si dhe me VKK nr. 467, datë 04.07.2017, “Për marrjen e disa masave për rregullimin e konkurrencës në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve në portin e Vlorës dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak”, rezulton se edhe gjatë kësaj periudhe hetimore këto rekomandime nuk janë zbatuar në praktikë, pasi në kontratat e operatorëve me Portin mungojnë dispozitat përkatëse lidhur me detyrimin e operatorëve për depozitimin e kostove reale për shërbimin që ofrojnë, mbajtjen e të dhënave ditore për tarifat e aplikuara për çdo biletë të shitur, dhe mbajtjen e rekordeve të shitjeve të biletave nga ndërmarrjet që operojnë në treg, pra këto të dhëna nuk mbikëqyren nga MIE. Për më tepër subjekti i licencuar/agjenti detar Niki Mare SHPK, nuk ka lidhur një kontratë me portin, në zbatim të nenit 10 të Udhëzimit nr. 883, datë 21.12.2018, kontratë e cila duhet të përmbajë të gjitha kriteret e përcaktuara në këtë nen, i cili reflekton rekomandimet e dhëna nga Autoriteti i Konkurrencës.
32. Në një situatë të tillë të tregut vlerësojmë se, hartimi dhe zbatimi i një metodologjie të brendshme për përcaktimin e çmimeve, nga ana e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve, metodologji e cila të bazohet në kostot reale të shërbimit dhe të sigurojë transparencë, objektivitet dhe mosdiskriminim në aplikimin e tarifave, do të mundësonte krijimin e kushteve për funksionimin efektiv dhe transparent të tregut, parandalimin e praktikave të mundshme antikonkurruese dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.
33. Duke qenë se ndërmarrjet pronare të mjeteve lundruese, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve nëpërmjet përfaqësuesve të tyre/Agjencie Detare në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë subjekte të huaja të cilat ushtrojnë veprimtari ndërkombëtare, përshfiri edhe territorin e RSH-së, duke sjellë pasoja drejtpërdrejt në tregun e brendshëm, Autoriteti i Konkurrencës, referuar nenit 71, “Këmbimi i të dhënave me autoritetet

simotra” të ligjit nr. 9121/2003, në kuadër të Memorandumeve të Mirëkuptimit me Autoritetet Simotra, si dhe Udhëzuesit “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut” (Direktiva e BE-së 2019/1, ECN +) Kapitulli VII, në bazë të një kërkesë, mund të kërkojë kryerjen e hetimeve në bashkëpunim me autoritetet simotra me kusht ruajtjen e reciprocitetit dhe respektimin e rregullave të sekretit tregtar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d), nenin 26, nenin 43, pika 5, dhe nenin 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve në portin e Durrësit dhe Vlorës.
- II. Detyrimin e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve që, brenda 3 (tre) muajve nga marrja e këtij vendimi, të hartojnë dhe zbatojnë një metodologji për përcaktimin e çmimeve, të bazuar në kostot reale të shërbimit, e cila të garantojë transparencë, objektivitet dhe mosdiskriminim në aplikimin e çmimeve.
- III. Metodologjia e përcaktimit të çmimeve, sipas pikës II, duhet të përfshijë, ndër të tjera:
 - a) identifikimin, përlllogaritjen dhe dokumentimin e detajuar të të gjitha kostove reale, direkte dhe indirekte, të lidhura me ofrimin e shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve;
 - b) ndarjen e kostove dhe tarifave sipas kategorive të shërbimit dhe llojeve të biletave, në mënyrë që tarifat e aplikuar të reflektojnë strukturën reale të kostove për çdo kategori udhëtimi;
 - c) përcaktimin e një marzhi fitimi të arsyeshëm dhe ekonomikisht të justifikuar, në përputhje me parimet e konkurrencës efektive;
 - d) diferencimin sezonal të çmimeve, kur aplikohet, mbi baza objektive dhe të verifikueshme;
 - e) dokumentimin dhe ruajtjen e metodologjisë dhe të dhënave përkatëse, duke garantuar aksesueshmërinë e tyre në çdo kohë për institucionet licencuese dhe mbikëqyrëse;
 - f) rishikimin periodik të metodologjisë dhe nivelit të çmimeve, në funksion të ndryshimeve të kostove reale dhe kushteve të tregut.
- IV. Ndërmarrjet, në përfundim të afatit 3 (tre) mujor, duhet të raportojnë pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi hartimin dhe zbatimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimeve si më sipër.

Në çdo rast, Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës rezervon të drejtën e bashkëpunimit me autoritetet

simotra, në zbatim të nenit 71 të ligjit nr. 9121/2003, Memorandumeve përkatëse të Mirëkuptimit dhe Udhëzuesit të AK, “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut” (Direktiva e BE-së 2019/1, ECN +).

- V. T’i rekomandojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë që në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Konkurrencës ndër vite, të realizojë:
- a) Monitorimin e zbatimit të tarifave sipas njoftimeve dhe miratimit të MIE-së për secilin traget/linjë kryesisht gjatë sezonit të lartë;
 - b) Sigurimin e të dhënave të detajuara mbi të gjitha kostot reale për shërbimin që ofrojnë operatorët;
 - c) Monitorimin e mbajtjes së të dhënave ditore për tarifat e aplikuara për çdo biletë të shitur, si dhe mbajtjes së rekordeve të shitjeve të biletave nga ndërmarrjet që operojnë në treg;
 - d) Ndërmarrjen e masave të nevojshme rregullatore për ta bërë të detyrueshëm për ndërmarrjet që operojnë në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve, hartimin dhe zbatimin e një metodologjie bazuar në kostot reale për përcaktimin e nivelit të tarifave maksimale për shërbimet e ofruara.
- VI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi palëve të interesuara.
- VII. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1276 , Datë 25.02.2026

“PËR MBYLLJEN PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE NDAJ NDËRMARRJES INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE NË BANKËN INTESA SANPAOLO”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.02.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar dhe dhënia e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Intesa SanPaolo.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 26, neni 43, pika 5 dhe neni 45 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës

SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim e jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.”;

- Pretendimet/shpjegimet e dhëna nga ndërmarrja Intesa SanPaolo Bank Albania SHA në seancën dëgjimore të zhilluar pranë AK më datë 20.02.2026, si dhe të paraqitura me shkrim me anë të shkresës protokolluar pranë AK me nr. 126/12 prot., datë 20.02.2026, me lëndë “Parashtrime në seancën dëgjimore me Komisionin e Konkurrencës lidhur me hetimin e thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete”, dërguar nga ndërmarrja Intesa SanPaolo Bank Albania SHA.

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës mbi pretendimet e paraqitura me shkrim nga ndërmarrja ndërmarrja Intesa SanPaolo Bank Albania SHA në lidhje me seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 20.02.2026.

VËREN SE :

I.Procedura e ndjekur

- 1.Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të një ankese të depozituar më datë 30 korrik 2024, mbi dyshimin për pengim, kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në tregun e sigurimit të jetës për kredi, në zbatim të nenit 28, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, aktivizoi procedurën e monitorimit të këtij tregu.
- 2.Bankat⁶⁴ janë institucione financiare, që ushtrojnë veprimtarinë bankare të pranimi të depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimin e tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të tyre si dhe veprimtari të tjera të natyrës financiare, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Aktualisht në Shqipëri operojnë 11 banka tregtare, me kapital të huaj dhe vendas.
- 3.Sigurimi i Jetës për Kredi është një produkt që u ofrohet individëve kredimarrës, duke shërbyer ndër të tjera edhe si garanci për bankën, por dhe për kredimarrësin, i cili mbrohet si person i siguruar.
- 4.Nga analiza e informacionit të mbledhur gjatë fazës së monitorimit u konstatua se, pavarësisht

⁶⁴ https://www.bankofalbania.org/Mbikeqyrja/Subjekte_te_licencuara/Banka/

shpjegimeve të dërguara me shkresë nga bankat, përqindjet e tregut total të sigurimit të jetës, të raportuara nga AMF për vitin 2023, nuk reflektohen në ndarjen e portofolit të sigurimit të jetës për kredi, që shitet përmes bankave. Kjo mospërputhje e dukshme ngriti shqetësime mbi funksionimin e konkurrencës në këtë segment të tregut.

5. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1130, datë 07.11.2024, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi për periudhën nga 7 nëntor 2021 deri në 7 nëntor 2024, vendim në të cilin përfshiu edhe ndërmarrjen Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA. Afati i përfundimit të hetimit paraprak, më pas, me Vendimin nr. 1159, datë 13.02.2025 u zgjat deri në 3 mars 2025.
6. Pas përfundimit të hetimit paraprak, u konkludua ndër të tjera se, sjellja e ndërmarrjes Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA mund të përbënte shkelje të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe me Vendimin nr. 1171, datë 26.03.2025 Komisioni i Konkurrencës i hapi rrugë procedurës së hetimit të thelluar në përputhje me parashikimet ligjore për periudhën 7 nëntor 2021 – 26 Mars 2025. Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme në kuadër të hetimit.

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

7. Sigurimi është një formë e manaxhimit të riskut që vjen nga një situatë e panjohur, një kontratë në bazë të së cilës një person/kompani, transferon rrezikun e mundshëm të një dëmi/humbjeje financiare tek një kompani sigurimi, përkundrejt pagesës së një shume që quhet prim sigurimi.
8. Sigurimi i Jetës për Kredi ofrohet për personat që marrin kredi në bankë dhe i mbron ata dhe familjarët nga rreziku i mos shlyerjes së hua-së si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit. Ky sigurim është një garanci financiare si për bankën (nga rreziku i mos shlyerjes së huasë si pasojë e humbjes së jetës së kredimarrësit) ashtu edhe për kredimarrësin, personin e siguruar, duke qlliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur.
9. Tregu i sigurimeve të jetës në Republikën e Shqipërisë funksionon në zbatim të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.
10. Ligji nr. 52/2014 parashikon si lloje të ndërmjetësimit, veprimtarinë e agentit dhe brokerit,

duke përcaktuar se edhe bankat e nivelit të dytë mund të pajisen me licencë për të ushtruar këtë veprimtari. Konkretisht, neni 194, pika 4 parashikon se “Veprimtaria e agjentit mund të kryhet edhe nga bankat, degët e bankave të huaja ose subjektet financiare jobanka, pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, si dhe subjekte të tjera, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti” ndërsa neni 204 pika 5 parashikon se “Veprimtaria e brokerimit mund të kryhet edhe nga bankat dhe/ose degët e bankave të huaja pasi të kenë marrë më parë miratimin nga Banka e Shqipërisë, sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti”.

11. Në bazë të nenit 194 të Ligjit nr. 52/2014, veprimtaria e agjentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari. Veprimtaria e agjentit në sigurime mund të kryhet edhe në emër të disa shoqërive të sigurimit, nëse shoqëritë e sigurimit kanë rënë dakord me marrëveshje të shkruar midis tyre.
12. Lidhur me veprimtarinë e brokerimit, në bazë të nenit 202 të Ligjit nr. 52/2014, përfshin të gjitha ato veprimtari, si prezantimi, propozimi, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negociimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij. Gjithashtu, përfshin edhe asistencën për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, veçanërisht zgjidhjen e kërkesave për dëmshpërblim nga shoqëria e sigurimit, në emër dhe për llogari të konsumatorit. Brokëri/shoqëria e brokerimit ndërmjetëson për lidhjen e kontratave të sigurimit vetëm me shoqëritë e sigurimit të licencuara.
13. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo brokër pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa më shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.
14. Referuar sa më sipër, AMF në Republikën e Shqipërisë ka A licensuar 4 banka si broker në sigurime për klasat e jetës dhe 1 bankë si agjent në sigurime të kësaj kategorie. Bankat e licencuara si broker në sigurime për klasat e jetës janë: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Tirana Bank dhe OTP Bank. Si agjent për klasat e jetës është licensuar Credins Bank. Gjithashtu, ndërmarrja E-Business Solutions është licensuar si agjent në sigurime për klasat e jetës, ndërsa ABI Broker Sigurimesh është licensuar si broker në sigurimet e jetës dhe jo-jetës. Disa banka, edhe pse jo të licencuara, kanë lidhur marrëveshje me shoqëri sigurimi për klasat e jetës, duke marrë automatikisht rolin e ndërmjetësuesit.

15. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negocimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t'i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
16. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”⁶⁵, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
17. Në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”⁶⁶, neni 7, informacioni kontraktor që duhet të japin bankat për klientët duhet të përmbajë veç të tjerave edhe, “garancitë e vendosura për të siguruar ekzekutimin e kontratës së kredisë, mënyrën e vënies së tyre në ekzekutim, dhe kontratat e sigurimit të jetës ose të pronës (kur janë të aplikueshme).
18. Mbi bazën e këtij detyrimi, klientët njihen në momentin e nënshkrimit të një kontrate kredie konsumatorë apo hipotekare me detyrimin e sigurimit të jetës, aty ku është e aplikueshme, për gjithë periudhën e mbajtjes së detyrimit. Nëpërmjet këtij detyrimi, banka sigurohet që në rast ndodhje të një ngjarjeje ndaj kredimarrësit, detyrimi i tij të mbulohet nga shoqëritë e sigurimit.
19. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës kur ka vlerësuar tregun përkatës ka marrë parasysh sjelljen e konsumatorit kredimarrës. Çfarë është më e rëndësishme për kredimarrësin, kredia (banka) apo kosto e sigurimit të jetës për kredi (primi)? Kredimarrësi kur zgjedh bankën ku do të marrë kredinë e zgjedh për arsye si: reputacioni i bankës, eksperiencia e mëparshme (llogari page apo kredi të mëparshme), norma e interesit, shpejtësia e miratimit dhe disbursimit, etj. Pra, para se të trajtohet primi i sigurimit të jetës për kredi, konsumatori e ka vendosur bankën ku do të marrë financimin.
20. Në raportin e CMA (Competition & Market Authority) të Mbretërisë së Bashkuar, “Market investigation into payment protection insurance”⁶⁷ (paragrafi 5.89-5.91), “**pika e shitjes**” shpjegohet në mënyrë të përmbledhur: “... Avantazhi në pikën e shitjes është përfitimi që shpërndarësit gëzojnë nga fakti që kanë qasje të vetme tek klientët në momentin kur ata po marrin kredinë e tyre.”
21. Krahasimisht, vlerësohet se një situatë e ngjashme me atë të përshkruar në raportin e CMA

⁶⁵ Miratuar me Vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

⁶⁶ Miratuar me Vendimin nr. 48 datë 01.07.2015, Këshilli Mbikëqyrës BSH.

⁶⁷ https://webarchive.nationalarchives.gov.uk/ukgwa/20140403003432mp_/http://www.competition-commission.org.uk/assets/competitioncommission/docs/pdf/non-inquiry/rep_pub/reports/2009/fulltext/542.pdf

ekziston edhe në rastin e kredive që kërkojnë sigurim jete, pasi vendimi i konsumatorit për t'u financuar nga një bankë e caktuar merret përpara zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit. Për rrjedhojë, banka gëzon një avantazh në “pikën e shitjes”, duke qenë se ka akses të privilegjuar ndaj klientit në momentin kur ai ndodhet në procesin e marrjes së kredisë.

22. Pavarësisht se banka, nëpërmjet informacionit para-kontraktor vë në dijeni kredimarrësin për nevojën e një sigurimi jete, vendimmarrja për shoqërinë e sigurimit, marrja e ofertave nga shoqëritë e ndryshme dhe krahasimi i primeve ndodh pas aprovimit të kredisë. Në këtë mënyrë banka siguron një akses të privilegjuar tek kredimarrësi, për të zgjedhur policën e sigurimit më të preferuar për bankën.
23. Për sa më sipër, tregu përkatës i produktit është: tregu i ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Intesa SanPaolo.
24. Tregu gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet ofrojnë dhe kërkojnë produkte dhe/ose shërbime, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene. Meqenëse, produkti i sigurimit të jetës është i detyrueshëm të blihet në momentin që banka aprovon kredinë që klienti dëshiron të marrë, atëherë si treg gjeografik do të konsiderohet vetëm territori i bankës së nivelit të dytë që ka aprovuar atë kredi. Për këtë arsye, tregu gjeografik për bankën Intesa SanPaolo do të konsiderohet territori ku kryen veprimtarinë Banka Intesa SanPaolo.

III.Vlerësimi i Pozitës Dominuese

25. Pjesët e tregut janë një tregues i rëndësishëm në lidhje me strukturën e tregut dhe rëndësinë e ndërmarrjeve të ndryshme në treg. Megjithatë, Autoriteti interpreton pjesët e tregut në këndvështrimin e kushteve të tregut përkatës dhe në veçanti të dinamikës së tregut dhe të diferencimit të produkteve. Tendencia ose zhvillimi i pjesëve të tregut me kalimin e kohës, mund të merret në konsideratë për tregjet e paqëndrueshme ose për tregjet ofertues
26. Praktikë më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian sugjerojnë se sa më e madhe të jetë pjesa e tregut dhe sa më e gjatë periudha që ndërmarrjet zotërojnë një pjesë të tillë tregu, aq më e mundur është që ky element të jetë një tregues i rëndësishëm për një pozicion dominues dhe të justifikojë në rrethana të caktuara ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës.⁶⁸
27. Nisur nga pjesa e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit

⁶⁸ Komunikim nga Komisioni Udhëzim mbi sjelljet përjashtuese, lidhur me zbatueshmërinë e nenit 82 -Guidance on the Commission's enforcement priorities in applying Article 82 of the EC Treaty to abusive exclusionary conduct by dominant.

3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ndërmarrja Intesa SanPaolo Bank Albania SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Intesa SanPaolo, ka pozitë dominuese.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes në tregun përkatës

28. Produkti i sigurimit të jetës është i lidhur me kredinë, e cila kërkon sigurim jete dhe në varësi të procedurave të brendshme të bankave, shitet pas aprovimit të kredisë dhe firmosjes së kontratës së kredisë. Për të lehtësuar procedurat për klientët, disa banka kanë shtuar gamën e shërbimeve të tyre duke u licensuar si agjentë apo broker pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në mënyrë që klienti kredimarrës, të mos vonohet me procedurat e sigurimit të jetës për kredi, por të vijojë sa me shpejt, duke kryer sigurimin e jetës në degën e bankës ku ka zgjedhur të marrë kredinë.
29. Në rolin e ndërmjetësit në sigurime, veprimtaria e bankave si broker në sigurime, përfshin prezantimin, propozimin, apo aktivitete të tjera përgatitore, të cilat kanë të bëjnë me negociimin me shoqërinë e sigurimit në emër dhe për llogari të konsumatorit, për t’i mundësuar nënshkrimin e një kontrate sigurimi, sipas kërkesave dhe nevojave të tij.
30. Neni 194 pika 1 e Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” shprehet se, veprimtaria e agjentit në sigurime kryhet në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit dhe përfshin prezantimin, propozimin dhe aktivitete të tjera përgatitore mbi kontratën e sigurimit, si dhe nënshkrimin e saj nga i siguruari. Gjithashtu neni 198 pika 3 e po këtij ligji, shprehet se agjenti apo shoqëria e agjentëve në sigurime kryen vetëm ato veprimtari, për të cilat është miratuar apo licencuar.
31. Në zbatim të Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, bankat sipas klasifikimit të kredisë, janë të detyruara të sigurojnë kredinë mbështetur në analizën dhe vlerësimin e cilësisë e kolateralit/ose garancisë së vendosur për marrjen e kredisë.
32. Sipas nenit 102 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” pasja e një pozite dominuese në treg nuk është e ndaluar në vetvete. Megjithatë, kur një ndërmarrje me pozitë dominuese përdor fuqinë e saj për të kufizuar konkurrencën në mënyrë të padrejtë, ajo mund të përbëjë një abuzim, i cili është i ndaluar me ligj.
33. Neni 102 TFEU liston kategoritë tipike të sjelljeve abuzive, por këto sjellje abuzive klasifikohen zakonisht në dy kategori kryesore: Abuzime përjashtuese (exclusionary abuses) dhe Abuzime

shfrytëzuese (exploitative abuses)⁶⁹.

- Abuzime përjashtuese (Exclusionary abuse) i referohet sjelljeve të ndërmarrjeve me pozitë dominuese që synojnë të përjashtojnë konkurrentët nga tregu, ose të pengojnë hyrjen ose zhvillimin e tyre, jo thjesht të konkurrojnë lirshëm me to, por të kufizojnë konkurrencën në mënyrë aktive. Këto sjellje dëmtojnë strukturën konkurruese dhe, rrjedhimisht, edhe interesat afatgjata të konsumatorëve
 - Abuzime shfrytëzuese (Exploitative abuse) përfshin ato abuzime kur ndërmarrja me pozitë dominuese shfrytëzon pozicionin e saj për të përfituar në mënyrë të padrejtë, zakonisht përmes çmimeve të larta apo kushteve tregtare të padrejta, pa ndikuar drejtpërdrejt mbi konkurrentët.
34. Sipas nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimit mbi zbatueshmërinë e neneve 8 dhe 9 të Ligjit nr. 9121/2003, një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të abuzojë me këtë pozitë nëpërmjet shitjeve të lidhura (tying) ose kushtëzimeve të padrejta, kur klientit i kërkohet që, për të marrë një produkt (në këtë rast kredinë), të blejë një produkt tjetër (sigurimin e jetës) në kushte të përcaktuara nga vetë banka.
35. Vendimi i klientit për bankën ku do të marrë kredinë merret përpara se ai të shqyrtojë ofertat për sigurimin e jetës për kredi. Kjo do të thotë se banka kontrollon pikën e shitjes (momentin vendimtar të nënshkrimit të kontratës), pra zotëron një pozitë të dominuese ndaj klientit.
36. Procesi i zgjedhjes së shoqërisë së sigurimit ndodh pas miratimit të kredisë, në ambientet e bankës, ku kredimarrësi është tashmë i varur nga vendimi i bankës për disbursimin e fondeve. Kjo situatë i jep bankës fuqi të njëanshme tregu, duke i mundësuar të “shtyjë” një produkt siguri të caktuar nga një shoqëri siguri.
37. Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në nenin 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ka analizuar sjelljen e Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA duke shqyrtuar nëse banka, duke e bërë sigurimin e jetës kusht për dhënien e kredive hipotekare, ka përdorur pozitën e saj në procesin e kreditimit për të ndikuar drejtpërdrejt ose tërthorazi në përzgjedhjen e shoqërisë së sigurimit nga ana e kredimarrësve. Analiza është përqendruar veçanërisht në strukturën e marrëveshjeve të bashkëpunimit me shoqëritë e sigurimit të jetës, në mënyrën konkrete të menaxhimit të procesit të sigurimit, si dhe në mekanizmin e përfitimit të të ardhurave të quajtura “administrim i llogarisë së primeve”. Konkretisht, është vlerësuar nëse aplikimi i komisioneve të diferencuara mbi primet e sigurimit, pavarësisht mungesës së licencimit të bankës si agjent apo broker në sigurime, si dhe devijimet e konsiderueshme në shpërndarjen e portofolit të policave krahasuar me strukturën e përgjithshme të tregut, mund të

⁶⁹ <https://www.lexology.com/library/detail.aspx?g=a940ed59-46d6-4932-a2cc-2fb52618f387>

kenë krijuar incentiva ekonomike për orientimin e kërkesës drejt shoqërive të caktuara sigurimi, me efekte potencialisht kufizuese për konkurrencën.

38. Intesa SanPaolo Bank Albania SHA nuk është e licensuar as si “agjent në sigurime” dhe as si “broker në sigurime”. Banka Intesa SanPaolo Bank Albania sqaron se sigurimi i jetës së kredimarrësve të saj është i detyrueshëm vetëm për kreditë hipotekare. Kjo bankë, gjithashtu nuk është e përfshirë nga AMF⁷⁰ në listën zyrtare të agjentëve apo brokerave të sigurimit të jetës në faqen e saj zyrtare.
39. Intesa SanPaolo Bank Albania SHA ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me të gjitha shoqëritë e sigurimit të jetës. Marrëveshjet ndërmjet Bankës dhe shoqërive të sigurimit të jetës përmbajnë klauzola të njëjta duke u siguruar që të garantohen të njëjtat kushte sigurimi nga shoqëritë e sigurimit, në kuadër të administrimit të rreziqeve të kredisë, me të cilat ekspozohet Banka nga dhënia e kredisë.
40. Gjatë periudhës në hetim, rezulton se klientët kredimarrës, kanë prerë policat e sigurimit të jetës si në vijim, Albsig Jetë SHA me një total prej XXX%; Sigal Life me XXX%; Insig Jetë me XXX%. Shoqëria Sicred ka vetëm rreth XXX% ose XXX lekë prime të paguara për të gjithë periudhën.
41. Nga akt-marrëveshjet e administruara gjatë hetimit paraprak, në formë shkresore, rezulton se sipas nenit 11 të këtyre akt-marrëveshjeve, “Administrimi i Llogarisë së Primeve”, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA përfiton komisione nga shoqëritë e sigurimit për administrimin e llogarive të primeve që këto të fundit disponojnë pranë Bankës. Komisionet që aplikon Banka për çdo prim të paguar për secilën nga kompanitë e sigurimit janë të përcaktuara në Aneksin 8, “Kostoja e Shërbimeve Administrative” të akt-marrëveshjeve dhe paraqiten si vijon: Albsig Jetë SHA, komisioni është XXX lekë/prim; Insig Jetë SHA, për prime më të larta ose të barabarta me XXX lekë ose ekuivalent komisioni është XXX lekë (ose ekuivalent) për prim, për prime nën vlerën XXX lekë ose ekuivalent, komisioni do të jetë i barabartë me masën e primit; Sicred SHA, XXX% e volumit të primeve të paguara; Sigal Life SHA, XXX% e volumit të primeve të paguara.
42. Pjesa më e madhe e komisioneve të përfituara nisur dhe numri më i lartë i policave të prera i përket shoqërisë Albsig Jetë SHA, më pas e dyta vjen Sigal Life SHA, Insig Jetë SHA është e treta për nga shuma e komisioneve të paguara, ndërsa Sicred SHA ka paguar një shumë të vogël komisionesh duke qenë se dhe numri i policave të prera pranë kësaj shoqërie sigurimi është i papërfillshëm.

⁷⁰ https://amf.gov.al/ts_abs_banka_agjent.asp dhe https://amf.gov.al/ts_abs_banka_broker.asp.

43. Termi i përdorur nga banka, ‘administrim i llogarisë së primeve’, nuk përputhet me natyrën reale të komisioneve të përfituara, pasi një shërbim i zakonshëm administrimi llogarie nuk gjeneron komisione të lidhura me mirëmbajtjen e llogarisë së primeve. Kjo situatë ngre çështje mbi natyrën dhe funksionin e këtyre komisioneve dhe mbi arsyet pse banka lidh marrëveshje të tilla, duke qenë se ajo nuk është e licencuar dhe nuk ushtron veprimtari ndërmjetësimi në fushën e sigurimeve. Në këtë kuptim, mënyra se si strukturohen dhe aplikohen këto komisione e bëjnë këtë praktikë një abuzim shfrytëzues të pozitës së saj dominuese në treg.
44. Gjithashtu, komisionet e ndryshme që banka aplikon mes shoqërive të sigurimit për administrimin e llogarive të primeve, të përcaktuara në marrëveshjet me këto shoqëri, shfrytëzojnë këtë pozitë dominuese për të përfituar nga aktiviteti i sigurimeve, pa ndonjë përfitim të drejtpërdrejtë për konsumatorët. Kjo praktikë kufizon konkurrencën, pasi përfitimet dhe kostot e sigurimit menaxhohen në favor të bankës, duke e bërë të vështirë që klientët dhe konkurrentët të ndërhyjnë ose të përfitojnë nga kushtet e tregut, duke e bërë këtë praktikë që banka ndjek, një abuzim shfrytëzues të pozitës së saj dominuese në treg duke shfrytëzuar pozicionin për të imponuar kushte të padrejta financiare përmes komisioneve të administrimit të llogarive të primeve të sigurimit.
45. Edhe se, Banka Intesa SanPaolo deklaron se, nuk ka politika apo procedura të përcaktuara për sigurimin e jetës në kuadër të dhënies së kredisë, nga telefonatat me klientët kredimarrës rezultojnë të paktën tre raste, ku punonjës të caktuar të bankës nuk kanë ndjekur procedurat zyrtare. Në këto raste, punonjësit kanë ndërhyrë për të lehtësuar procesin e marrjes së kredisë, duke ofruar asistencë për sigurimin e ofertave nga shoqëri sigurimi. Edhe pse këto veprime mund të jenë ndërmarrë me mirëbesim dhe në interes të klientit, ato nuk janë në përputhje me procedurat e brendshme të bankës.
46. Gjatë analizës së sjelljes së Intesa Sanpaolo Bank Albania në tregun e sigurimit të jetës për kredi, Sekretariati ka evidentuar një situatë të veçantë dhe të ndryshme nga modeli i ndjekur nga shumica e bankave të tjera të nivelit të dytë. Kjo bankë nuk zotëron as licencë brokeri dhe as licencë agjenti pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), çka, sipas kuadrit ligjor për sigurimin, risigurimin dhe ndërmjetësimin në sigurime në Republikën e Shqipërisë, e përjashton bankën nga e drejta për të kryer çdo veprim ndërmjetësimi, promovimi, trajtimi të policave apo përfitimi të komisioneve mbi primet e sigurimit.
47. Pavarësisht mungesës së licencimit, Intesa Sanpaolo ka marrëveshje bashkëpunimi me të katër shoqëritë e sigurimit të jetës që operojnë në treg. Pavarësisht pretendimit të bankës se nuk ndikon në përzgjedhjen e shoqërisë nga kredimarrësit dhe se këta të fundit gëzojnë liri të plotë për të zgjedhur ofruesin e sigurimit, analiza e të dhënave të tregut dhe e sjelljes së bankës tregon

një realitet të ndryshëm nga ai i paraqitur prej saj.

48. Së pari, struktura e portofolit të sigurimit të jetës për kredi brenda Intesa Sanpaolo-s nuk pasqyron aspak përqindjet e tregut të raportuara nga AMF për tregun e jetës në total edhe pse produkti objekt i këtij hetimi të thelluar përben rreth 70% të totalit të gjithë tregut të sigurimit të jetës në Shqipëri dhe është praktikisht e pamundur qës për një produkt kaq të rëndësishëm, të mos ketë reflektim në tregun brenda bankës. Devijimi i ndjeshëm midis peshës së shoqërive në treg dhe peshës së tyre brenda bankës përben një tregues të qartë por të pa vërtetueshëm me prova konkrete nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës se procesi i përzgjedhjes së kompanisë së sigurimit nuk është rezultat i konkurrencës së lirë në treg, por i ndikimeve të brendshme që burojnë nga mënyra se si banka strukturon ofrimin e këtij produkti.
49. Së dyti, pretendimi i bankës se nuk ka komunikime apo ndërveprime me shoqëritë e sigurimit nuk gjen mbështetje në provat e administruara gjatë hetimit. Nga inspektimet dhe dokumentacioni i siguruar (p.sh., e-mail-e të shkëmbyera), rezulton se banka ka pasur komunikime të drejtpërdrejta dhe raste të koordinimit me kompanitë e sigurimit lidhur me trajtimin e policave për klientët. Edhe vetë ndërmarrja ankuese ka deklaruar se, megjithëse në raste të rralla, është kontaktuar nga banka për marrjen e ofertave, gjë që bie ndesh me deklarin e bankës se nuk ndërhyr në këtë proces.
50. Së treti, është fakti që në mungesë të licencës si agjent apo broker, Intesa Sanpaolo ka gjetur një mënyrë alternative për të përfituar të ardhura nga primet e sigurimit, duke aplikuar një tarifë të quajtur “Komision për administrimin e llogarisë së primeve” mbi çdo prim sigurimi. Megjithëse kjo tarifë paraqitet si tarifë administrative, niveli i saj dhe mënyra e aplikimit përputhen plotësisht me komisionet që bankat e licencuara agjentë ose broker aplikojnë ligjërisht, çka tregon se banka po ushtron në mënyrë të tërthortë një veprimtari ndërmjetësimi për të cilën nuk është e licencuar.
51. Ky mekanizëm jo vetëm deformon konkurrencën në tregun e sigurimit të jetës, por krijon edhe një avantazh të padrejtë ndaj bankave të tjera që operojnë në përputhje me kuadrin rregullator dhe kanë marrë licencat përkatëse. Nëse kjo situatë nuk adresohet nga AMF dhe Banka e Shqipërisë, rrezikohet që edhe banka të tjera të ndjekin të njëjtin model, duke e shtyrë tregun drejt një sjelljeje të përgjithshme ekstra-ligjore që dobëson integritetin e tregut dhe minon procesin e konkurrencës së lirë. Kjo sjellje përben risk për funksionimin e tregut dhe kërkon ndërhyrje të koordinuar rregullatore në vijim.
52. Në përfundim, me gjithë ekzistencën e dyshimeve, nuk ka prova të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë që në tregun e ndërmjetësimi për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Intesa SanPaolo të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 26, nenin 43, pika 5 dhe nenin 45, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

I.Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Intesa SanPaolo Bank Albania SHA në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete në bankën Intesa SanPaolo.

II.Detyrimin e ndërmarrjes Intesa SanPaolo Bank Albania SHA që brenda 60 ditëve:

i.të ndalojë aplikimin e komisioneve të emëtuara si “Administrimi i Llogarisë së Primeve”.

ii.të shfuqizojë marrëveshjet e bashkëpunimit me shoqëritë e sigurimit, për aq kohë sa banka nuk është e licencuar si broker ose agjent në sigurime si dhe të ndërmarrë çdo veprim të nevojshëm për rregullimin e kësaj situate, në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe Bankën e Shqipërisë.

III.Detyrimin e ndërmarrjes Intesa SanPaolo Bank Albania SHA që gjatë periudhës tranzitore 60 ditore sipas pikës II të këtij vendimi, për çdo kredimarrës të hartojë dhe zbatojë një formular të vetëm, në të cilin të pasqyrohen ofertat e të gjitha shoqërive të sigurimit, sipas propozimit të primit nga secila shoqëri sigurimi; formulari në fjalë duhet të ketë në faqen e parë, me shkrim të dukshëm, pa numër rendor emrin e secilës shoqëri sigurimi jete dhe në vijim të emrit, vlerën e primit sipas koeficienteve përkatës dhe përzgjedhjen e kredimarrësit. Ky formular duhet të nënshkruhet nga të dy palët, banka dhe kredimarrësi, dhe të ruhet si pjesë përbërëse e dosjes së kredisë e aksesueshme në çdo moment nga Autoriteti i Konkurrencës. Nga momenti i përfundimit të periudhës 60 ditore, deri në rregullimin e kësaj situate sipas pikes II/2 më sipër, të ndalojë çdo komunikim të formës verbale apo me shkrim me ndërmarrjet e sigurimit për këtë produkt duke i ngarkuar çdo kredimarrësi të drejtën dhe detyrimin për të marrë ofertën për sigurimin e jetës për kredi pranë njëres prej ndërmarrjeve të sigurimit që e ofron këtë shërbim. I gjithë procesi për sigurimin e jetës nga kredimarrësi duhet të kryhet jashtë sporteleve të Intesa SanPaolo Bank Albania SHA dhe polica e sigurimit të jetës duhet të paraqitet e nënshkruar nga kredimarrësi pranë bankës, deri në momentin që banka licensohet në një nga format, agjent ose broker.

IV.Detyrimin e ndërmarrjes Intesa SanPaolo Bank Albania SHA që brenda 30 ditëve, në kuadër të informacionit parakontraktor të dorëzuar çdo kredimarrësi, të përfshijë një njoftim të qartë, të shkruar dhe të plotë mbi përpunimin e të dhënave personale për qëllimet e vlerësimit dhe

verifikimit të sjelljes së bankës në treg, përfshirë dhe aksesin dhe përpunimin e të dhënave nga Autoriteti i Konkurrencës, në rast monitorimi, hetimi paraprak apo hetimi të thelluar ndaj bankës.

V.Detyrimin e ndërmarrjes Intesa SanPaolo Bank Albania SHA të raportojë në çdo kohë që do kërkohet, pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi mënyrën e zbatimit të detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi duke paraqitur çdo dokument që konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti i Konkurrencës për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi.

VI.Në rast të mos përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja SanPaolo Bank Albania SHA, në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.

VII.Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për një periudhë 1 vjeçare.

VIII.Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1278, Datë 09.03.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË THE BRIDGE S.R.L. NGA SHOQËRIA AMBIENTA SGR SPA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.03.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim e kontrollit të shoqërisë The Bridge S.r.l. nga shoqëria Ambienta SGR SPA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitimit të kontrollit të shoqërisë The Bridge S.r.l. nga shoqëria Ambienta SGR SPA”,

VËREN SE :

I.Palët në transaksion dhe procedura

- 1.Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim e kontrollit të shoqërisë The Bridge S.r.l. nga shoqëria Ambienta SGR SPA.
- 2.Referuar dokumenteve “Kontratë Shitblerje Kuotash” dhe “Kontratë Investimi”, palët në marrëveshje janë:
- 3.**Blerësi: Ambienta SGR SPA** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Italisë, me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve të menaxhimit kolektiv të kursimeve, të realizuar

nëpërmjet promovimit, krijimit dhe organizimit të organizmave të investimit kolektiv të kursimeve, etj. Ambienta SGR SPA është e specializuar në investime në shoqëri që operojnë në sektorë të lidhur me qëndrueshmërinë mjedisore.

4. Ambienta SGR SPA zotërohet në masën X% nga Ambienta Holding S.p.A. dhe pjesa tjetër nga entitete të ndryshme, kryesisht individë.

5. Në Shqipëri, Ambienta SGR SPA zotëron në mënyrë indirekte, tërësisht, shoqërinë Maccaferri Balkans SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Prodhimin dhe tregtimin e produkteve me përdredhje të dyfishtë (si gabione, materase dhe rrjeta), i rrjetave në formë unazore dhe tregtimin e produkteve gjeosintetike të përdorura për të zgjidhur problemet në lidhje me kontrollin e erozionit, stabilizimin e terrenit, mbrojtjen nga rënia e gurëve, projekte infrastrukture në sektorë si rrugë, hekurudha, lumenj, kanale, landfille, mbrojtje bregdetare dhe ndërtime civile në territorin e Shqipërisë, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut dhe në çdo vend tjetër të përcaktuar nga Organi i Administrimit (“Territori”), etj.

6. **Shitësi: EM S.r.L.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Italisë, i cili zotërohet nga tre individë, shtetas italianë.

7. **Target: The Bridge S.r.l.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Italisë, e cila ushtron veprimtarinë e saj në prodhimin dhe tregtimin e ushqimeve, pijeve dhe produkteve të tyre; në kultivimin e produkteve bujqësore; në import, eksport dhe tregti me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore, pijeve dhe produkteve të tyre, përfshirë bimët mjekësore dhe produktet për erboristeri, etj. Veprimtaria aktuale e shoqërisë target përbëhet ekskluzivisht nga përpunimi, prodhimi dhe paketimi i produkteve ushqimore dhe të pijshëm me bazë bimore, për përdorim tregtar vetëm në sektorin civil. Para transaksionit, The Bridge S.r.l. zotërohet plotësisht nga shitësi.

8. The Bridge S.r.l. nuk ka prezencë juridike në Shqipëri.

II. Përqendrimi

9. Më datë [____], është nënshkruar “Kontratë Shitblerje Kuotash”, ndërmjet shoqërisë Ambienta SGR SPA në cilësinë e blerësit, EM S.r.L. në cilësinë e shitësit dhe znj. Margherita Rancan, z. Paolo Negro Marcigaglia dhe z. Marco Negro Marcigaglia (pronarët e drejtpërdrejtë të shitësit).

10. Po në këtë datë, shoqëritë Ambienta SGR SPA, EM S.r.L., z. Paolo Negro Marcigaglia dhe z. Marco Negro Marcigaglia (Aksionarët Indirekt) kanë nënshkruar “Kontratë Investimi”.

11. Referuar këtyre kontratave dhe për qëllime të transaksionit, Ambienta SGR SPA do të themelojë një shoqëri të parë ndërmjetëse me përgjegjësi të kufizuar (**TopCo**), e cila do të themelojë një shoqëri tjetër ndërmjetëse me përgjegjësi të kufizuar (që më pas do të shndërrohet në një shoqëri aksionare) (**HoldCo**), e cila nga ana e saj do të themelojë një shoqëri të tretë ndërmjetëse me përgjegjësi të kufizuar (**BidCo**). Kjo e fundit do të caktohet nga Ambienta si blerëse e të gjithë

kapitalit aksionar të shoqërisë target. Më tej, Ambienta SGR SPA do të sigurojë që TopCo të miratojë një seri rritjesh të kapitalit aksionar të HoldCo-s, të cilat do të ofrohen për nënshkrim nga TopCo, shitësi dhe menaxherët. Si rezultat i këtyre rritjeve të kapitalit, Ambienta SGR SPA do të zotërojë në mënyrë indirekte aksionet e klasës A, që përfaqësojnë 70% të kapitalit aksionar të HoldCo-s, ndërsa shitësit do të zotërojnë aksionet e klasës B, që përfaqësojnë 30% të kapitalit të mbetur bruto, përfshirë pjesën proporcionale të kapitalit të rezervuar për menaxherët.

12. Seksioni III i Kontratë Investimi rregullon qeverisen e HoldCo, BidoCo dhe Target. Pala njoftuese deklaroi se Kontrata e Investimit, duke iu referuar dispozitave të statuteve të HoldCo (bashkëlidhur kësaj kontrate), që do të miratohen brenda datës Closing, parashikon të drejta vetoje për shitësit dhe për drejtuesit e emëruar nga shitësit, për qeverisjen e HoldCo, BidCo dhe target. Asnjë nga këto të drejta vetoje nuk është e tillë që t'i japë kontroll shitësit.
13. Në Kontratën e Investimit është parashikuar gjithashtu që brenda 12 muajve nga përfundimi i transaksionit, BidCo dhe target do të vazhdojnë me Bashkimin (Merger), si rezultat i të cilit shoqëria që rezulton nga bashkimi do të jetë shoqëria target The Bridge S.r.l.
14. Në përfundim të transaksionit të propozuar, Ambienta SGR SPA do të përftojë kontrollin e shoqërisë target The Bridge S.r.l.
15. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë The Bridge S.r.l. nga shoqëria Ambienta SGR SPA, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

16. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i përpunimit, prodhimit, paketimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore me bazë bimë, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
17. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë The Bridge S.r.l. nga shoqëria Ambienta SGR SPA.
18. Ambienta është një shoqëri e menaxhimit të aseteve, e specializuar në investime në shoqëri që operojnë në sektorë të lidhur me qëndrueshmërinë mjedisore.
19. Ambienta zotëron në mënyrë indirekte një shoqëri tërësisht në pronësi të saj në Shqipëri, shoqërinë Maccaferri Balkans SHPK, e cila operon në tregun e prodhimit dhe tregtimit të produkteve me përdredhje të dyfishtë (si gabione, materase dhe rrjeta), i rrjetave në formë unazore dhe tregtimin e produkteve gjeosintetike të përdorura për të zgjidhur problemet në lidhje me kontrollin e erozionit, stabilizimin e terrenit, mbrojtjen nga rënia e gurëve.

20. Shoqëria The Bridge S.r.l. operon ekskluzivisht në përpunimin, prodhimin dhe paketimin e produkteve ushqimore dhe të pijshëm me bazë bimore, për përdorim tregtar vetëm në sektorin civil. The Bridge S.r.l. nuk ka prani apo degë në Shqipëri, por ka realizuar një xhiro për vitin 2024.
21. Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit të shoqërisë The Bridge S.r.l. nga shoqëria Ambienta SGR SPA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
NR.1279, DATË 09.03.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË PRIMORSKI SKLADI, D.O.O. NGA SHOQËRITË OTP ALAPKEZELŐ ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG DHE OTP BANKA D.D.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.03.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim e kontrollit të përbashkët të shoqërisë PRIMORSKI SKLADI, d.o.o. nga shoqëritë OTP Alapkezelő Zártkörűen Működő Részvénytársaság dhe OTP banka d.d.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PRIMORSKI SKLADI, d.o.o. nga shoqëritë OTP Alapkezelő Zártkörűen Működő Részvénytársaság dhe OTP banka d.d.”,

VËREN SE:

I.Palët në transaksion dhe procedura

1.Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me përfitim e kontrollit të përbashkët të shoqërisë PRIMORSKI SKLADI, d.o.o. nga shoqëritë OTP Alapkezelő Zártkörűen Működő Részvénytársaság dhe OTP banka d.d.

- 2.Referuar dokumentit “Kontratë për shitjen dhe transferimin e kuotës”, të lidhur më datë [] palët janë:
- 3.**Blerësi 1: OTP Alapkezelő Zártkörűen Működő Részvénytársaság / OTP Alapkezelő Zrt.** (OTP Fund Management Pte.Ltd.) është një shoqëri aksionare e regjistruar sipas legjislacionit Hungarez, e cila menaxhon fondet e investimeve brenda grupit OTP. Veprimtaria kryesore e saj është menaxhimi i fondeve të investimeve UCITS dhe fondeve alternative të investimeve, si dhe dhënia e këshillave financiare përkatëse.
- 4.**Blerësi 2: OTP banka d.d.** është një shoqëri aksionare e regjistruar sipas legjislacionit Slloven, e cila operon si një bankë universale që ofron shërbime pagesash, depozitash, kreditimi dhe shërbime të tjera financiare në Slloveni.
- 5.Blerësit zotërohen nga OTP Bank Plc., e cila është shoqëria mëmë e Grupit OTP.
- 6.Grupi OTP është prezent në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë Banka OTP Albania SHA, një shoqëri aksionare, me objekt aktiviteti: a) pranimi i depozitave monetare ose i fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimi i tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të vet, b) dhënie huash të të gjitha llojeve duke përfshirë kredi konsumatorësh dhe kredi hipotekore, c) faktoring dhe financim të transaksioneve tregtare, etj. Aksionar i vetëm i shoqërisë është shoqëria OTP Bank NYRT.
- 7.**Shitësi: ELEKTRONCEK GROUP B.V.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me ligjin e Mbretërisë së Holandës. Shitësi është mbajtësi i kuotës që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë PRIMORSKI SKLADI, d.o.o.
- 8.**Shoqëria Target: PRIMORSKI SKLADI Upravljanje z investicijskimi skladi, d.o.o., Koper / PRIMORSKI SKLADI, d.o.o.,** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar sipas legjislacionit Slloven, e cila ushtron aktivitetin e saj në menaxhimin e fondeve të investimeve, me qëllim forcimin e pozitës rajonale të grupit në segmentin e shërbimeve financiare, si dhe zgjerimin e veprimtarisë në fushën e menaxhimit të fondeve të investimeve në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore. Kjo shoqëri gjithashtu ushtron aktivitetin e saj në përputhje me Ligjin mbi Fondet e Investimeve dhe aktet e tjera përkatëse të legjislacionit slloven, nën mbikëqyrjen e Agjencisë për Tregun e Letrave me Vlerë të Republikës së Sllovenisë, e cila lëshon dhe mbikëqyr licencat për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të fondeve të hapura të investimeve.

II.Përqendrimi

- 9.Ndërmjet palëve ELEKTRONCEK GROUP B.V., (shitësi), OTP Alapkezelő Zártkörűen Működő Részvénytársaság, (blerësi 1), OTP banka d.d., (blerësi 2) është lidhur “Kontratë për shitjen dhe transferimin e kuotës”, më datë [].

10. Transaksioni i njoftuar ka të bëjë me blerjen e 100% të aksioneve të shoqërisë target, PRIMORSKI SKLADI d.o.o., nga shoqëria OTP Alapkezelő Zrt. dhe shoqëria OTP banka d.d., shoqëri të cilat i përkasin Grupit OTP.
11. Referuar kësaj Marrëveshje, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të, OTP Alapkezelő Zrt. dhe OTP banka d.d. do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi shoqërinë PRIMORSKI SKLADI d.o.o., ku pas realizimit të transaksionit: OTP Alapkezelő Zrt. do të zotërojë 75% të kuotës dhe OTP Banka d.d. do të zotërojë 25% të kuotës.
12. Pas realizimit të përqendrimit, Grupi OTP do të fitojë kontroll të plotë mbi shoqërinë PRIMORSKI SKLADI, d.o.o.
13. Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PRIMORSKI SKLADI, d.o.o. nga shoqëritë OTP Alapkezelő Zártkörűen Működő Részvénytársaság dhe OTP banka d.d., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

14. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i menaxhimit të fondeve të investimeve, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
15. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PRIMORSKI SKLADI, d.o.o. nga shoqëritë OTP Alapkezelő Zártkörűen Működő Részvénytársaság dhe OTP banka d.d., shoqëri të Grupit OTP.
16. OTP Bank Nyrt është një shoqëri aksionare publike, shoqëria mëmë e Grupit OTP. OTP Bank Nyrt është prezent dhe realizon të ardhura në Shqipëri nëpërmjet filialit të saj OTP Bank Albania SHA në tregun e shërbimeve bankare.
17. PRIMORSKI SKLADI d.o.o. ka objekt aktiviteti menaxhimit të fondeve të investimeve dhe nuk realizon të ardhura në Republikën e Shqipërisë.
18. Transaksioni i propozuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë PRIMORSKI SKLADI, d.o.o. nga shoqëritë OTP Alapkezelő Zártkörűen Működő Részvénytársaság dhe OTP banka d.d.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr.1280, Datë 27.03.2026

“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPAK NË TREGUN E IMPORTIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË CIGAREVE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.03.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Hapjen e procedurës së hetimit parapak në tregun e importit dhe tregtimin me shumicë të cigareve.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE :

1. Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të nenit 28, pika “a” të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (Ligji nr. 9121/2003), ka nisur procedurën e monitorimit të tregut të importit dhe tregtimin me shumicë të cigareve.
2. Në tregun e cigareve, referuar pikës 4.2 të Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, operojnë, në nivele të ndryshme: importuesit dhe prodhuesit vendas, si furnizues kryesor; furnizuesit e ndërmjetëm si dhe njësitë e shitjes me pakicë.
3. Në përputhje me sa më sipër, furnizuesi kryesor përcakton çmimin maksimal të shitjes me pakicë të cigareve dhe është i detyruar ta deklarojë atë çmim në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar, jo më vonë se 10 ditë para datës së aplikimit të çmimit të ri. Po ashtu, furnizuesi kryesor ka detyrimin të publikojë

deklaratën e ndryshimit të çmimit maksimal të shitjes me pakicë për çdo lloj cigareje dhe pakete në jo më pak se dy gazeta ditore kombëtare dhe jo më vonë se 5 ditë nga data e aplikimit të çmimit të ri. Për efekte marketingu çmimet maksimale mund të vazhdojnë të publikohen në çdo media të shkruar apo elektronike për aq kohë sa ato çmime janë në fuqi.

4. Në faqen e zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve janë publikuar çmimet maksimale të shitjes me pakicë të cigareve për ndërmarrje të ndryshme që operojnë në tregun e cigareve.
5. Produktet e duhanit janë mallra që i nënshtrohen akcizës, sipas Ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Pulla e akcizës, sipas nenit 41, pika 5 të këtij ligji, vendoset në mënyrë të detyrueshme mbi paketat e cigareve në formë të tillë që të jetë e dukshme dhe të grisur me hapjen e paketës. Akciza për cigaret llogaritet për 1000 copë dhe përcaktohet në Shtojcën nr. 1, pjesa III “Duhan dhe nënproduktet e tij”.
6. Në kuadër të monitorimit, Autoriteti i Konkurrencës ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) mbi importet e realizuara sipas subjekteve importuese për cigaret me kodet doganore përkatëse, për periudhën janar 2021 – dhjetor 2025. Nga ky informacion, për produktin cigare (FMC, Factory Made Cigarettes) dhe cigaret elektronike pa djegie, vape, Heat-not-burn (HNB) rezultoi si vijon:
 - i. Tregu i importit të cigareve karakterizohet nga një nivel i lartë përqendrimi, ku ndërmarrja Philip Morris Albania SHPK zotëron në vitin 2025 një pjesë tregu prej XXX% në segmentin e cigareve tradicionale (FMC) dhe XXX% në segmentin e cigareve elektronike (HNB) dhe vape.
 - ii. Pjesa e tregut e kësaj ndërmarrjeje paraqitet në nivele të larta dhe në rritje progresive gjatë periudhës së analizuar, pa evidentuar luhajtje domethënëse që do të tregonin presion të ndjeshëm konkurrues nga ndërmarrjet e tjera.
7. Në Shqipëri ekziston prodhim vendas i duhanit (bimë), i cili sipas INSTAT⁷¹ në vitin 2024 llogaritet se janë mbjellë 907 ha dhe prodhuar 1861 ton. Nga të dhënat e publikuara nga Open Data, vitin 2020, eksporti i duhanit ishte vetëm 615 ton, dhe prodhimi 1438 ton. Ndërkohe që ky prodhim ka arritur sasinë më të mëdha në vitin 2008 me 2061 ton, vitin 2015 1730 ton, vitin 2017 1699 ton. Për sa i përket prodhimit të cigareve FMC, në Shqipëri prodhimi, nëse ekziston është i papërfillshëm dhe informal. Marka e vetme e FMC në Shqipëri është DS (Durrësi Special) e cila është vetëm markë tregtare dhe prodhohet jashtë vendit.
8. Nga analiza rezulton se, tregu operon në një regjim të veçantë fiskal dhe rregullator, i karakterizuar nga: Nivel i lartë i akcizës, i përcaktuar në mënyrë progresive për periudhën

⁷¹ https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START__BU__AFC/BU04/table/tableViewLayout1/

2022–2026; Aplikimi i TVSH-së mbi çmimin e shitjes me pakicë; Kontroll i posaçëm fiskal për mallrat me akcizë, përfshirë detyrimin për pullën e akcizës; Ndalimi i reklamimit dhe sponsorizimit të produkteve të duhanit; Përcaktimi dhe deklarimi i detyrueshëm i çmimit maksimal të shitjes me pakicë nga furnizuesi kryesor.

9. Këto faktorë përbëjnë barriera të konsiderueshme hyrjeje për ndërmarrje të reja dhe kufizojnë strukturën konkurruese të tregut. Në këto kushte, konkurrenca zhvillohet kryesisht ndërmjet furnizuesve kryesorë (importuesve), ndërsa distributorët dhe njësitë e shitjes me pakicë nuk kanë hapësirë reale për konkurrencë në çmim, pasi çmimi maksimal i shitjes me pakicë përcaktohet dhe kontrollohet nga furnizuesi kryesor. Regjimi i çmimit maksimal të shitjes me pakicë përqendron kontrollin e çmimit në nivelin e furnizuesit kryesor, duke i dhënë këtij të fundit ndikim të drejtpërdrejtë mbi çmimin final në treg.
10. Duke marrë në konsideratë pjesën e konsiderueshme dhe në rritje të tregut të zotëruar nga një ndërmarrje e vetme, barrierat e larta hyrëse të krijuara nga regjimi fiskal dhe rregullator, centralizimin e përcaktimit të çmimit përmes mekanizmit të çmimit maksimal të shitjes me pakicë, si dhe rëndësinë ekonomike dhe fiskale të tregut të cigareve, vlerësohet i nevojshëm një verifikim i plotë i strukturës së tregut dhe i sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të cigareve në territorin e Republikës së Shqipërisë, për të vlerësuar nëse këto sjellje mund të përbëjnë shkelje të nenit 9 dhe/ose nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të cigareve.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2022 deri në 27 mars 2026.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 2 (dy) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1281 , Datë 27.03.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË HELICONTROL KORLÁTOLT FELELŐSSÉGŰ TÁRSASÁG NGA SHOQËRIA 4IG ŰR ÉS VÉDELMI TECHNOLOGIÁK ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.03.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim të kontrollit të shoqërisë HeliControl Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitimit të kontrollit të shoqërisë HeliControl Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság,

VËREN SE:

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim të kontrollit të shoqërisë HeliControl Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

2. Referuar dokumentit “Kontratë shitblerje e kuotave të kapitalit”, palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi 1: 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság /4iG Űr és Védelmi Zrt. (4iG SDT)** është një shoqëri aksionare e mbyllur, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, me objekt kryesor aktiviteti menaxhimi i aseteve (mbajtjes). 4iG SDT është aktive në sektorin e mbrojtjes dhe të teknologjisë së lartë, duke u fokusuar në zhvillimin dhe prodhimin e sistemeve mbrojtëse, teknologjive ushtarake dhe zgjidhjeve për teknologjinë hapësinore. Gjithashtu, shoqëria është e angazhuar në shërbime të teknologjisë së informacionit dhe telekomunikacionit, si dhe në investime strategjike në industri të teknologjisë së lartë dhe të lidhura me mbrojtjen. Kjo shoqëri është pjesë e grupit 4iG.
4. Grupi 4iG është prezent në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë ONE ALBANIA SHA, një shoqëri aksionare e themeluar, sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: ndërtimin, zotërimin, operimin dhe ofrimin e rrjetit publik të telefonisë së lëvizshme të standardit GSM dhe telefoni fikse, komunikimi bazë i telefonisë celulare në rrjetin lokal bazuar në kanalet radio, komunikim bazë në rrjetin ndërqytetas që lidhen me transmetimin radio, komunikim ndërkombëtar të çdo lloj transmetimi dhe vale, komunikimi i të dhënave në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, komunikim multimedia dhe ISDN, komunikim teleteks dhe videotekst, etj.
5. **Blerësi 2: MNS AERO Zártkörűen Működő Részvénytársaság** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë me objekt aktiviteti: Menaxhimi i aseteve (holding).
6. **Shitësi : Wollemia Trust Kft.** është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë.
7. **Shoqëria Target: HeliControl Korlátolt Felelősségű Társaság/ HeliControl Kft.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, me objekt aktiviteti kryesor: Riparim dhe mirëmbajtje e mjeteve ajrore civile dhe anijeve kozmike.
8. Shoqëria target HeliControl Korlátolt Felelősségű Társaság nuk është prezente dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.

II. Përqendrimi

9. Më datë [_____], ndërmjet shoqërisë 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság (blerësi1), shoqërisë MNS AERO Zártkörűen Működő Részvénytársaság (blerësi 2) dhe shoqërisë Wollemia Trust Kft. (shitësi), është nënshkruar “Kontratë për shitblerjen e pjesës së kapitalit të shoqërisë”, lidhur me shitblerjen e kuotave të kapitalit themeltar që përfaqësojnë X% dhe X% të kapitalit të kapitalit themeltar të shoqërisë HeliControl Korlátolt Felelősségű Társaság.

10. Referuar kësaj Marrëveshje, shitësi dhe blerësi 2 janë pronarët e vetëm të kuotave që përfaqësojnë gjithsej 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë HeliControl Kft., ku shitësi zotëron një kuotë që përfaqëson X% të kapitalit themeltar, ndërsa blerësi 2 zotëron një kuotë që përfaqëson X% të kapitalit themeltar.
11. Pala njoftuese deklaron se, pas përmbylljes së transaksionit, blerësi do të fitojë kontroll mbi X% të aksioneve nga X% të aksioneve të zotëruara nga shoqëria Wollemia Trust Kft., ndërsa MNS AERO Zártkörűen Működő Részvénytársaság do të rrisë pjesëmarrjen e saj me X% të aksioneve duke zotëruar X% të aksioneve.
12. Palët gjithashtu kanë përgatitur “Draft Marrëveshje Bashkëpunimi”, ku përcaktohen çështjet vendimmarrëse të Asamblesë e Përgjithshme, si organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë target. Referuar këtij dokumenti, Aksionarët do të kenë **raportet e votimit** si vijon: (i) 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság: do të përfitojë X% të drejtës së votës, (ii) MNS AERO Zártkörűen Működő Részvénytársaság: do të përfitojë X% të drejtës së votës. Referuar Aneksit 1, “ Çështjet e Rezervuara për Asamblenë e Përgjithshme që kërkojnë shumicë X%”, janë çështje strategjike mbi veprimtarinë e shoqërisë target. Si rezultat, 4iG SDT do të ushtrojë kontroll të vetëm vendimmarrës mbi shoqërinë target.
13. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë HeliControl Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

14. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shërbimeve të mirëmbajtjes, riparimit, remontit dhe modernizimit të helikopterëve civilë dhe ushtarakë të certifikuar nga EASA (European Union Aviation Safety Agency), por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
15. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë HeliControl Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Űr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
16. Shoqëria 4iG SDT është një shoqëri aktive në sektorin e mbrojtjes dhe të teknologjisë së lartë, duke u fokusuar në zhvillimin dhe prodhimin e sistemeve mbrojtëse, teknologjive ushtarake dhe zgjidhjeve për teknologjinë hapësinore, pjesë e Grupit 4iG. Shoqëria nuk është aktive në tregun përkatës.

17. Grupi 4iG është prezent në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë ONE ALBANIA SHA, një shoqëri aktive në tregun e komunikimeve elektronike.
18. MNS AERO Zrt. është një shoqëri holding, me objekt aktiviteti menaxhimi i aseteve.
19. Shoqëria target, HeliControl Korlátolt Felelősségű Társaság është aktiv në tregun e shërbimeve të mirëmbajtjes, riparimit dhe remontit të helikopterëve, në të cilin Blerësi do të bëhet pjesë pas Transaksionit. Shoqëria nuk është aktive në asnjë treg në Shqipëri.
20. Nga sa më sipër, konstatohet se transaksioni i propozuar nuk krijon mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk sjell ndryshim dhe nuk ka ndikim në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit të shoqërisë HeliControl Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Úr és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1282, Datë 27.03.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT INDIREKT TË SHOQËRISË SWIXX BIOPHARMA HOLDING AG NGA SHOQËRIA SK CAPITAL PARTNERS, LP, NËPËRMJET SHOQËRISË SKES INVESTMENT 17 S.À.R.L.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.03.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përftimin e kontrollit indirekt të shoqërisë Swixx Biopharma Holding AG nga shoqëria SK Capital Partners, LP, nëpërmjet shoqërisë SKES Investment 17 S.à.r.l.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përftimit të kontrollit indirekt të shoqërisë Swixx Biopharma Holding AG nga shoqëria SK Capital Partners, LP, nëpërmjet shoqërisë SKES Investment 17 S.à.r.l.”,

VËREN SE:

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përftimin e kontrollit indirekt të shoqërisë Swixx Biopharma Holding AG nga shoqëria SK Capital Partners, LP, nëpërmjet shoqërisë SKES Investment 17 S.à.r.l.
2. Referuar dokumentit “Marrëveshje për Blerjen e Aksioneve”, palët në marrëveshje janë:

3. **Blerësi: SKES Investment 17 S.à.r.l.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Luksemburgut, objekti i së cilës është mbajtja e aksioneve, në çdo formë, në Luksemburg dhe në shoqëritë e huaja dhe çdo formë tjetër investimi, përmes blerjes, abonimit ose çdo mjeti tjetër, si dhe transferimi me anë të shitjes, këmbimit ose çdo mjeti tjetër të titujve të çdo lloji etj.
4. SKES Investment 17 S.à.r.l. është një shoqëri e veçantë, SPV, e krijuar vetëm për qëllime të transaksionit të njoftuar, e cila kontrollohet në mënyrë indirekte nga fonde të kontrolluara nga shoqëri të lidhura dhe të menaxhuara nga SK Capital Partners, LP. SK Capital Partners, LP është një firmë investimesh private, e themeluar sipas legjislacionit të Delaware, me fokus në materiale të specializuara, kimikateve dhe farmaceutikës.
5. Blerësi nuk ka prani në Shqipëri por, nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar nga SK Capital Partners, LP, Apotex, ka realizuar të ardhura.
6. **Shitësit:** Janë X [] shoqëri dhe X [] persona fizikë, të cilët së bashku zotërojnë 100% të kapitalit të shoqërisë target.
7. **Target: Swixx Biopharma Holding AG** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit zviceran, me objekt veprimtarie blerja, mbajtja, administrimi dhe tjetërsimi drejtpërdrejt ose tërthorazi i pjesëmarrjeve të çdo lloji, veçanërisht në fushën e shëndetësisë, si dhe mbështetja e ndërmjetësimeve dhe ofrimi i shërbimeve në të gjitha veprimtaritë e lidhura me to etj. Swixx Biopharma Holding AG është aktive në komercializimin e produkteve farmaceutike me dozë të përfunduar ("FDPs") për shoqëri farmaceutike të palëve të treta.
8. Shoqëria Swixx Biopharma Holding AG ka prezencë juridike në Shqipëri përmes filialit të zotëruar plotësisht indirekt prej saj shoqërinë AMICUS PHARMA SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me aktivitet parësor hulumtim i tregut dhe sondazh i opinionit publik; marrëdhëniet me publikun dhe aktivitetet e komunikimit; Aktivitetet e biznesit dhe aktivitetet e tjera të konsulencës për menaxhimin. Aktivitetet dytësore do të përfshijnë kultivimin e erëzave, prodhimin e barnave, produkteve farmaceutike dhe bujqësore; prodhimin e produkteve farmaceutike bazë etj.

II. Përqendrimi

9. Më datë [], ndërmjet shoqërisë SKES Investment 17 S.à.r.l. (në cilësinë e blerësit) dhe X [] shoqëri dhe X [] persona fizikë (në cilësinë e shitësit) është nënshkruar "Marrëveshje për Blerjen e Aksioneve" në lidhje me blerjen e të gjitha aksioneve në Swixx Biopharma Holding AG. Në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj marrëveshje, secili prej shitësve pranon të shesë dhe në Finalizim, të transferojë pronësinë e plotë ligjore dhe përfituese të aksioneve të mbajtura nga shitësit tek blerësi pa asnjë barrë, dhe blerësi pranon të blejë aksionet nga shitësit.

10. Referuar deklaratës së palëve, disa shitës (Shitësit Riinvestues), si dhe disa anëtarë të menaxhmentit të Swixx Biopharma (Menaxhmenti) do të riinvestojnë në mënyrë indirekte në Shoqëri duke blerë interesa në Lux Aggregator S.C.A., shoqëri e cila mban në mënyrë indirekte 100% të aksioneve të Blerësit. Pas këtij procesi, pritet që SK Capital Partners, LP të zotërojë në mënyrë indirekte më shumë se X% të Lux Aggregator S.C.A. dhe të ketë kontroll të vetëm mbi bordin e saj. Shitësit Riinvestues, menaxhmenti, si dhe çdo bashkëinvestitor do të ketë vetëm të drejta të kufizuara mbrojtëse dhe qeverisëse, por nuk do të ketë as individualisht, as kolektivisht, ndonjë të drejtë thelbësore vetoje në qeverisjen apo strategjinë e Lux Aggregator S.C.A., që do t'u mundësonte atyre të ndikonin në mënyrë thelbësore në vendimet strategjike tregtare të shoqërisë target Swixx Biopharma Holding AG.
11. Pas zbatimit të Marrëveshjes për Blerjen e Aksioneve, SKES Investment 17 S.à.r.l. do të përftojë 100% të aksioneve dhe kontrollin e vetëm të shoqërisë target Swiss Biopharma Holding AG. Si rezultat, SK Capital Partners, LP do të përftojë kontrollin në mënyrë indirekte mbi Swixx Biopharma Holding AG.
12. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit indirekt të shoqërisë Swixx Biopharma Holding AG nga shoqëria SK Capital Partners, LP, nëpërmjet shoqërisë SKES Investment 17 S.à.r.l., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

13. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", si dhe rasteve të trajtuara nga Komisioni Evropian në tregje të tilla, tregu përkatës do të konsiderohet tregu i furnizimit me shumicë i barnave sipas klasifikimit ATC3 kategoria N05A, që janë barna me veprim antipsikotik, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
14. Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit indirekt të shoqërisë Swixx Biopharma Holding AG nga shoqëria SK Capital Partners, LP, nëpërmjet shoqërisë SKES Investment 17 S.à.r.l.
15. Shoqëria SK Capital Partners LP është një firmë investimesh private, me fokus në materiale të specializuara, kimikate dhe farmaceutike. Blerësi dhe asnjë nga shoqëritë e portofolit të kontrolluara prej tij nuk kanë prani juridike në Shqipëri, por kanë realizuar të ardhura.
16. E vetmja shoqëri me aktivitet minimal në Shqipëri është Apotex, një kompani farmaceutike e fokusuar në ilaçe gjenerike, produkte over-the-counter dhe familje produktesh biosimilare. Apotex ka gjeneruar shitje minimale përmes furnizimit të FDP-ve tek klientët në Shqipëri gjatë

vitit fiskal prill 2024-mars 2025, nga shitja e produkteve të saj për importuesit e produkteve farmaceutike në Shqipëri.

17. Shoqëri Swixx Biopharma Holding AG është aktive në komercializimin e produkteve farmaceutike me dozë të përfunduar (FDPs) për shoqëritë farmaceutike të palëve të treta. Ajo furnizon kryesisht me produkte të shoqërive biofarmaceutike, OTC dhe pajisje mjekësore në këto tregje.
18. Në Shqipëri Swixx vepron përmes një filiali të zotëruar tërësisht prej saj, shoqërisë Amicus Pharma SHPK. Fokusi i shoqërisë Amicus Pharma SHPK është sigurimi i disponueshmërisë së ilaçeve me cilësi të lartë, të cilat i përgjigjen nevojave të pacienteve dhe kontribuojnë në zhvillimin e sektorit mjekësor. Ndërkohë edhe Swixx Biopharma realizon shitje në Shqipëri nëpërmjet importuesve të produkteve farmaceutike.
19. Transaksioni i propozuar klasifikohet si përqendrim horizontal, i cili prek tregun e furnizimit me shumicë të barnave sipas klasifikimit ATC3 kategoria N05A, që janë barna me veprim antipsikotik.
20. Sipas vlerësimit të palës njoftuese, bari Solian i shitur nga Swixx Biopharma dhe Apo-Olanzepin i shitur nga Apotex, klasifikohen të dy në kategorinë ATC N05A-Antipsikotikë. Bazuar në vlerat e shitjeve të regjistruara nga IQVIA në 2025, pjesa e tregut e Solian dhe Apo-Olanzepin rezulton të jetë shumë e vogël, rreth X%. Në treg ekzistojnë një numër i madh furnizuesish të tjerë të FDP-ve antipsikotik të disponueshëm dhe të shitur në Shqipëri me pjesë tregu dukshëm më të lartë.
21. Nga sa më sipër, transaksioni i propozuar krijon mbivendosje horizontale midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar, por nuk shkakton shqetësime për konkurrencën, në asnjë segment të mundshëm, për shkak të krijimit apo forcimit të pozitës dominuese. Transaksioni i synuar nuk sjell ndryshime domethënëse në strukturat e tregut përkatës të produktit në Shqipëri.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit indirekt të shoqërisë Swixx Biopharma Holding AG nga shoqëria SK Capital Partners, LP, nëpërmjet shoqërisë SKES Investment 17 S.à.r.l.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1283, Datë 27.03.2026

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË ČESKÉ AEROLINIE A.S. DHE GRUPIT SMARTWINGS NGA SHOQËRIA PEGASUS HAVA TAŠIMACILIĞI ANONIM ŞIRKETI”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.03.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim e kontrollit të shoqërisë České aerolinie a.s. dhe Grupit Smartwings nga shoqëria Pegasus Hava Tašimacılığı Anonim Şirketi.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitimit të kontrollit të shoqërisë České aerolinie a.s. dhe Grupit Smartwings nga shoqëria Pegasus Hava Tašimacılığı Anonim Şirketi.

VËREN SE:

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar për përfitim e kontrollit të shoqërisë České aerolinie a.s. dhe Grupit Smartwings nga shoqëria Pegasus Hava Tašimacılığı Anonim Şirketi.
2. Referuar dokumentit “Marrëveshje Kuadër për Shitjen dhe Blerjen e Aksioneve të České aerolinie a.s.”, palët në marrëveshje janë:

3. **Blerësi: Pegasus Hava Taşımacılığı Anonim Şirketi (Pegasus Hava Taşımacılığı A.Ş.)** është një shoqëri aksionare, e themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit turk, e cila ushtron veprimtari në ofrimin e shërbimeve të transportit ajror të pasagjerëve me fluturime të rregullta dhe charter, duke operuar sipas një modeli biznesi të linjës ajrore me kosto të ulët. Pegasus Hava Taşımacılığı A.Ş. ofron gjithashtu shërbime të ndryshme ndihmëse (ancillary) të lidhura me transportin e pasagjerëve, përfshirë shitjen e ushqimeve dhe pijeve para dhe gjatë fluturimit, shitjen e produkteve duty-free në fluturimet ndërkombëtare, tarifatat për bagazhe shtesë, transport mallrash etj.
4. Pegasus Hava Taşımacılığı A.Ş. kontrollohet nga shoqëria Esas Holding Anonim Şirketi, shoqëri holding e një grupi shoqërish investimi, e cila ushtron veprimtari në një sërë sektorësh, përfshirë aviacionin, tregtinë me pakicë, pasuritë e paluajtshme dhe kujdesin shëndetësor.
5. Grupi Pegasus (Pegasus, së bashku me të gjithë filialet e saj të kontrolluara (drejtpërdrejt ose tërthorazi) nuk zotëron dhe nuk kontrollon asnjë shoqëri në Republikën e Shqipërisë, por realizon të ardhura nga ofrimi i shërbimeve të transportit ajror.
6. **Shitësi: Prague City Air s.r.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit Çek.
7. **Target: České aerolinie a.s.** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit çek, me objekt aktiviteti veprimtari hotelerie; prodhimi, tregtimi dhe shërbimet që nuk janë të përfshira në shtojcat 1 deri 3 të Ligjit për veprimtarinë tregtare: ndërmjetësim në tregti dhe shërbime, tregtim me shumicë dhe pakicë, shërbime spedicionere dhe përfaqësim në procedurat doganore, ndërmjetësim punësimi, shitja e alkoolit për konsum dhe pijeve alkoolike etj. České aerolinie a.s. aktualisht zotërohet me 70% të aksioneve nga Prague City Air s.r.o. dhe me 30% të aksioneve nga Smartwings, a.s.
8. **Smartwings, a.s.** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit çek, me objekt aktiviteti transport ajror tregtar i rregullt dhe i parregullt, brenda dhe ndërmjet shteteve, i pasagjerëve, bagazheve të tyre, kafshëve, postës dhe mallrave (Cargo); manovrimi i avionëve në platformë; regjistrimi i pasagjerëve, ngarkesave dhe postës etj.
9. České aerolinie a.s. zotëron 100% të kapitalit themeltar të paguar plotësisht dhe të drejtave të votës në Smartwings, a.s., duke ushtruar kështu kontroll të vetëm mbi Grupin Smartwings. Fusha kryesore e veprimtarisë së Grupit Smartwings është transporti tregtar i pasagjerëve në linja të rregullta, duke u fokusuar kryesisht në lidhjet direkte midis Pragës dhe destinacioneve kryesore në Evropë. Megjithatë, Grupi Smartwings operon gjithashtu fluturime speciale charter.
10. Referuar deklaratës së palëve dhe marrëveshjes, në Grupin Smartwings përfshihen Smartwings, a.s., dhe filialet e tij Smartwings Hungary Korlátolt Felelősségű Társaság (Smartwings Hungary Kft.), Smartwings Poland Sp. Z.o.o., Smartwings Building, s.r.o. dhe Smartwings Slovakia, s.r.o.

11. Target nuk zotërojnë dhe nuk kontrollojnë asnjë shoqëri në Republikën e Shqipërisë, por realizojnë të ardhura nga ofrimi i shërbimeve të transportit ajror.

II. Përqendrimi

12. Më datë [_____], ndërmjet shoqërisë Pegasus Hava Taşımacılığı Anonim Şirketi (në cilësinë e blerësit), Prague City Air s.r.o. (në cilësinë e shitësit), UG Jet, s.r.o. (në cilësinë e Dorëzanësit të parë) dhe UNIMEX GROUP, a.s. (në cilësinë e Dorëzanësit të dytë) është nënshkruar “Marrëveshje Kuadër për Shitjen dhe Blerjen e Aksioneve të České aerolinie a.s.”.
13. Referuar kësaj marrëveshje shitësi do t’i shesë blerësit dhe blerësi do të blejë nga shitësi aksionet (që përfaqësojnë 70% të kapitalit themeltar të paguar plotësisht dhe të të drejtave të votës në shoqërinë České aerolinie a.s.) me të gjitha të drejtat dhe përfitimet që lidhen me to në mbyllje dhe të lira nga çdo barrë, për çmimin e blerjes dhe sipas kushteve të kësaj marrëveshje.
14. Si rezultat i transaksionit të propozuar, blerësi Pegasus Hava Taşımacılığı A.Ş. do të zotërojë 100% të aksioneve të shoqërisë České aerolinie a.s. dhe Grupit Smartwings, duke fituar kështu kontroll të vetëm mbi target.
15. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të shoqërisë České aerolinie a.s. dhe Grupit Smartwings nga shoqëria Pegasus Hava Taşımacılığı Anonim Şirketi, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

16. Në lidhje me shërbimet e transportit ajror të pasagjerëve, Komisioni Evropian, në praktikën e tij të mëparshme, vendimmarrëse ka përcaktuar tregjet përkatëse për shërbimet e rregullta të transportit ajror të pasagjerëve në bazën e dy qasjeve: i) qasja e origjinës/pikë destinacioni sipas çifteve të qyteteve (O&D), kur objekt i transaksionit është një transportues ajror aktiv dhe ii) qasja aeroport-më aeroport; kur objekti përfshin një portofol të rëndësishëm slotesh.
17. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe rasteve të trajtuara nga Komisioni Evropian në tregje të tilla, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shërbimeve të transportit ajror të pasagjerëve sipas një destinacioni të caktuar, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë
18. Shoqëria Pegasus është një linjë ajrore turke me kosto të ulët, e cila operon fluturime të rregullta vendase dhe ndërkombëtare, kryesisht nga qendra e saj kryesore në Aeroportin Ndërkombëtar Istambul Sabiha Gokçen. Pegasus ka adoptuar një model biznesi të tipit “low-

cost network carrier”, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve me çmime konkurruese, me performancë të lartë në respektimin e orareve të fluturimeve, duke përdorur një flotë të re me efikasitet të lartë në konsum karburanti.

19. Grupi Pegasus nuk zotëron dhe nuk kontrollon asnjë shoqëri në Republikën e Shqipërisë, por operon fluturime të rregullta në linjën Tiranë-Stamboll Sabiha Gokçen (SAW) dhe planifikon të hapë linjën Tiranë-Izmir (ADB) nga viti 2026.
20. Shoqëritë target: Ceske aerolinie a.s. (CSA) ka si objekt aktiviteti veprimtari hotelerie, prodhim, tregti me shumicë dhe pakicë, shërbime spedicionere dhe përfaqësim në procedura doganore, ofrim e softëve, këshillim në fushën e teknologjisë së informacionit, etj. Smartwings, a.s., bashkë me filialet e saj, kanë si objekt veprimtarie transportin ajror tregtar i rregullt dhe i parregullt, brenda shtetit dhe ndërmjet shteteve, i pasagjerëve, bagazheve të tyre, kafshëve, postës dhe mallrave (Cargo), etj.
21. Shoqëritë Target nuk zotërojnë dhe nuk kontrollojnë asnjë shoqëri në Republikën e Shqipërisë, por Smartwings operon shërbimet e transportit ajror të pasagjerëve me fluturime të rregullta në linjën Tiranë-Pragë (PRG). Përveç kësaj, Smartwings ka operuar fluturime charter drejt/nga Shqipëria gjatë periudhës 2022-2025 në një numër linjash.
22. Nga analiza u konstatua se nuk ekziston asnjë mbivendosje horizontale midis palëve në lidhje me shërbimet e transportit ajror të pasagjerëve në Shqipëri. Palët mund të kenë aktivitete të kufizuara në disa shërbime ndihmëse të lidhura me aviacionin, përfshirë dhënien me qira të avionëve me ekuipazh (wet lease) dhe pa ekuipazh, por pjesa e kombinuar e tregut është shumë e vogël pa ngritur shqetësime për konkurrencën në treg.
23. Nga sa më sipër, transaksioni i propozuar nuk krijon mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk sjell ndryshim dhe nuk ka ndikim në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit të shoqërisë Ceske aerolinie a.s. dhe Grupit Smartwings nga shoqëria Pegasus Hava Taşımacılığı Anonim Şirketi.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS
2026**
BULETINI ZYRTAR



2026